

EDUKATA QYTETARE

DORACAK PËR MËSIMDHËNËS

VI

Përmbajtja

Mesazhi i mësimdhënësve	3
Hyrja	
Arsimimi për demokraci dhe shoqëri qytetare.....	4
Arsimimi efektiv për demokraci dhe shoqëri qytetare	10
Pasqyra e shkurtër	
Objektivat dhe përmbajtjet	15
Përgatitja e klasës – sqarimi i nocioneve më të rëndësishme lidhur me lëndën	16
Pasqyra e udhëzimeve.....	24
Si t’u ndihmoni nxënësve tuaj për ta hartuar studimin e klasës	
Hapi i parë: Vërejtja e problemeve në bashkësinë tuaj.....	27
Hapi i dytë: Cilin problem ta përzgjidhni?	28
Hapi i tretë: Mbledhja e të dhënave mbi problemin	29
Hapi i katërt: Të menduarit mirë, Punimi dhe zhvillimi i studimit të klasës	32
Hapi i pestë: Prezantimi i studimit të klasës.....	35
Hapi i gjashtë: Vështrimi i të mësuarit	36
Shtojcat	
I. Kutet për punimin e studimit	39
II. Udhëzimet për grupet studimore	41
III. Kutet për përgatitjen e prezantimit gojor.....	50
IV. Procedimet dhe udhëzimet për mbajtjen e garave	51
V. Udhëzime për anëtarët e jurisë	53
VI. Pyetësorët për notimin e studimit dhe të prezantimit gojor	56
VII. Pyetësori për notimin e nxënësve	61
VIII. Pyetësorët e nxënësve	62
Shtojcat	
1. Zhvillimi i diskutimit.....	80
2. Hapi i dytë – propozimet për mënyrat e zgjedhjes së problemeve	86
3. Hapi i tretë – burimet e të dhënave dhe mënyra e komunikimit.....	88
4. Hapi i katërt – puna e grupeve studimore	89
5. Këshillat për hapin e pestë	91
6. Projektet dhe mësimi me anë të projekteve	92
7. Përcjellja dhe notimi	94

MESAZHI MËSIMDHËNËSVE

Mësimdhënës të respektuar,

Shpresojmë se ky doracak dhe t'ju frymëzojë e motivojë për të futur risi në punën tuaj, por edhe t'i fisnikëroni nxënësit me dijeni të reja. Nga kureshtja juaj dhe gëzimi i njohurive varet hareja, shpirti dhe fryma e atyre që po i mësoni dhe përgatisni për një jetë më të bukur..

Në edukimin e personaliteteve të lira dhe të qytetarëve të ardhshëm të moshës madhore, njësoj janë të rëndësishme si dija e themeltë edhe karakteri i mirë. Kjo do të thotë se tek të rinjtë duhet ngulitur dhe zhvilluar fuqia e dijes dhe fuqia e ndërgjegjes. Dija pa ndërgjegje mund të jetë e rrezikshme dhe e mbrapshtë.

Doracaku do t'ju nxisë, që me anë të lojës dhe mendimit, t'u ndihmoni nxënësve t'i vërejnë problemet dhe t'i zgjidhin ato që janë thelbësore, të rëndësishme dhe urgjente, si dhe të marrin vendime më të logjikshme dhe më racionale, të pranueshme dhe efikase për zgjidhjen e tyre. Në këtë mënyrë tek nxënësit do të krijoni themelet për formimin e qytetarëve të përgjegjshëm dhe të guximshëm. Atje ku janë të përgjegjshëm dhe të guximshëm qytetarët, është e përgjegjshme edhe shoqëria edhe shteti. Në shoqërinë e përgjegjshme çmohet misioni i shenjtë - misioni i mësimdhënësit. Ky është njëri nga rastet që në shoqërinë tonë të kthehet dinjiteti i misionit të mësimdhënësit.

Mësoni nxënësit se mbi idetë dhe vlerat e shenjta – të vërtetën, drejtësinë, të mirën, dashurinë e bukurinë – mbështetet jeta dhe pa to nuk ka jetë të mirë. Ndarja e vetme qenësore midis njerëzve është, sipas këtyre vlerave – në ata që mendojnë, flasin, veprojnë dhe sillen sipas të vërtetës, drejtësisë, mirësisë, dashurisë e bukurisë; dhe në ata që gënjejnë, bëjnë padrejtësi e të keqe, urrejnë dhe gjithçka e deformatojnë.

Misioni juaj është që me nxënësit të nisni në shoqërinë tonë formimin e formularit demokratik të mendimit, veprimt e të sjelljes. Mësoni ata se pa kritikë (të arsyeshme, të argumentuar dhe gjykim racional mbi problemin) dhe kontroll (veçmas të mekanizmave të zhvilluar të kontrollit) çdo pushtet mund të bëhet tiran.

Sa më shumë qytetarë të marrin pjesë aktive në jetën politike (nga bashkësia lokale deri në majat e shtetit), do të jetë më mirë për pushtetin dhe për gjithë ne. Ashtu krijohet shansi që njerëzit e këqij, respektivisht uzurpuesit, të pengohen që të vijnë në pushtet dhe të dominojnë jetën tonë.

Ju faleminderit paraprakisht për përfshirje në këtë mision të lartësuar për gjithë ne.

prof. dr Çedomir Çupiq,
Kryetar i Këshillit drejtues të Shkollës së Hapur të Beogradit

Hyrje

ARSIMIMI PËR DEMOKRACI DHE SHOQËRI QYTETARE

Nocioni i demokracisë dhe i shoqërisë qytetare

Gjatë jetës së vet njeriu jeton në bashkësi me grupe të ndryshme – prej familjes, nëpër shoqata të ndryshme, klube, organizata punuese, deri tek kombi e shteti. Në të gjitha bashkësitë e tilla prej më të voglave, tek më të mëdhatë, duhet të merren vendime në emër të tërë bashkësisë, e lidhur me objektivat e shtruara, rregullat që duhet respektuar dhe ndarjen e të drejtave e të përgjegjësive. Këto vendime mund të quhen kolektive, për dallim nga vendimet individuale, të cilat njerëzit i marrin vetëm në emër të vetin.

Demokracia është grumbull i rregullave procedurale për marrjen e vendimeve kolektive të cilat mundësojnë pjesëmarrjen më të gjerë të mundshme të të interesuarve, apo të atyre me të cilët kanë të bëjnë ato vendime (duke nënkuptuar edhe kontrollin e procesit të vendimmarrjes).

Përse e synojmë demokracinë?

Barazia e qytetarëve – qëllimi i demokracisë është që ndaj të gjithë njerëzve të sillen njësoj, pavarësisht nga arsimimi i tyre, përkatësia kombëtare, statusi ekonomik, sepse të gjithë njerëzit janë të aftë të sillen me përgjegjësi kur nga ata pritet ta bëjnë këtë. Nëse presim që të gjithë të rriturit të shfaqin kujdes për jetët e veta, atëherë janë të aftë edhe të marrin pjesë në vendimmarrje mbi jetën e shoqërisë cilës i takojnë.

Përmbushja e nevojave të përgjithshme – sa më shumë njerëz të kenë pjesëmarrje në përcaktimin e politikës, është më se e sigurt se ajo do t'i manifestojë brengat dhe synimet e tyre. Demokracia nënkupton qasjen informatave për të gjithë ata që të mund të ndikojnë në krijimin e politikës.

Pluralizmi dhe kompromisi – demokracia mbështetet në këmbimin e hapur të mendimeve nga më të ndryshmet, paraqitja e argumenteve dhe arritja e kompromisit. Këmbimi i mendimeve përfshinë në vetvete të drejtën që dallimet në mendime të shprehen dhe dëgjohen. Në këtë mënyrë arrihet barazia midis qytetarëve.

Garantimi i lirive themelore – demokracia garanton liritë themelore që përfshinë: të drejtën e mendimit dhe shprehjes së lirë, të bashkimit me tjerët, lëvizjes, sigurisë personale ... Demokracia i mbron këto të drejta, sepse sjellin vendime kolektive dhe nxisin zhvillimin personal të individit.

Ekzistimi i rregullave demokratike dhe procedurat që duhet të pasojnë me rastin e vendimmarrjes, si dhe ekzistimi i kontrollit të respektimit të tyre, paraqesin garanci që ata të cilët marrin vendime, nuk do të vendosin arbitrarisht.

Vendimmarrja demokratike

Që ndonjë vendimmarrje të konsiderohet demokratike është me rëndësi që vendimi të jetë marrë në mënyrë demokratike, domethënë me respektimin e rregullave të procedurës. Veçoria kryesore e demokracisë është që gjithnjë në mënyrë të barabartë ndajnë të drejtat për vendimmarrje, kurse vendimmarrja është mjet procedural për zgjidhjen e mospajtimeve kur janë shterur të gjitha metodat e tjera, sikurse janë debati, amendamentet, kompromisi.

Demokracinë e dallojmë nga autokracia ku vendimin e merr një njeri, apo pakica, në mënyrë autoritare, duke mos u bazuar në çfarëdo rregullash dhe arbitrarisht, sipas mendimit personal; pa mundësi të çfarëdo pjesëmarrjeje të atyre të cilëve u përkasin vendimet.

Kur flitet për grumbullin e rregullave **procedurale**, mendohet për grumbullin e rregullave **themelore** (primare) me të cilat konfirmohet se **kush është i autorizuar** të marrë vendime kolektive dhe në bazë të cilave **procedura**, domethënë sipas mënyrës së dispozitave të caktuara paraprakisht. Në ato procedura demokratike midis të tjerash, bëjnë pjesë:

- e drejta e përgjithshme e votës;
- zgjedhjet e lira e të përgjithshme;
- parimet e përfaqësimit (përfaqësim shumicë apo proporcional) sundimi i drejtësisë, kushtetutshmëria dhe ligjshmëria;
- garantimi dhe mbrojtja gjyqësore e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, etj.

Nocioni qytetar

Në kuptimin më të gjerë, qytetari është njeri me të drejta dhe detyrime të caktuara në kuadër të bashkësisë shoqërore – politike, me të cilën është i lidhur me përkatësi relativisht të përhershme. Tërësia e lirive, të drejtave dhe obligimeve që i gëzon individi në kuadër të bashkësisë politike, ia japin cilësinë e qytetarit.

Qytetari mund të jetojë në fshat, në qytezë, qytet, rreth, krahinë. Qytetarët janë të ndryshëm për nga nacionaliteti, feja, raca, profesioni, statusi social, arsimimi ... Megjithatë, pavarësisht dallimeve të shumta midis tyre, **të gjithë** ne kemi të drejta e obligime **të njëjta** - nuk mund të jesh më pak ose më shumë qytetar.

Qytetarët e zgjedhin pushtetin i cili miraton ligje dhe e administron bashkësinë. Dhe ata qytetarë të cilët dinë si të marrin pjesë në qeverisje, janë të aftë t'i mbrojnë të drejtat e tyre dhe ta kontrollojnë pushtetin duke shfaqur kujdes që pushteti të punojë në interesin më të mirë të mbarë popullit. Pa qytetarë të tillë **të përgjegjshëm** nuk ka as qeveri të përgjegjshme.

Qytetari duhet të:

- jetë **aktiv** dhe të angazhohet në përcaktimin e kushteve të jetës së përbashkët;
- fitojë dhe zhvillojë shprehitë e tolerancës, të ndjenjës për drejtësi, kujdesin për të mirën e përgjithshme dhe të jetë i gatshëm për bashkëpunim;
- respektojë **të drejtat e tjerëve** dhe t'i përmbush detyrimet ndaj bashkësisë;
- **respektojë ligjet** e bashkësisë dhe të kontribuojë në prosperitetin e saj.

Çfarë nënkupton krejt fjala qytetar

1. **banor i qytetit, qytetar**. – Unë jam qytetar i qytetit të njohur në Kaliki (nga Dhiata e Re, përkthim V. Karaxhiq). Qytetarët dhe të gjithë marinarët e anijeve tregtojnë dhe lëvizin (S. M. Ljubisha, 1875). Ne qytetarët sigurisht nuk jemi mësuar të vuajmë në ushqim si katundarët (V. Novak, 1911). Është bërë tepër pikëllues rrëfimi se si qytetarët tanë e kanë vështirë verës të mbërrijnë deri në Savë (S. Batushiq 3, 40)

b. historikisht: **banor i këshjellës, i qytetit** – Vrapon Gjorgje prej qyteti në qytet, / Dhe qytetarët gjithandej i thërret: / "A po dëgjoni ju qytetarë turq! / Në qytete hapni dyert " (*Kënga popullore serbe*, Vuk Karaxhiq) v. historikisht, krahinore: **myslimani banor i Nikshiqit**. – Në Mal të Zi të gjithë turqit e Nikshiqit quhen qytetarë: Dhe Slivlenin nga qytetarët ruaje (Fjalori serbisht, V. Karaxhiq).

2. **nënshtrues (vasal), shtetas, banor në përgjithësi (nganjëherë edhe me drejtim mirësjelljes me emrin)**. – Me anë të ligjit duan ta bëjë atë qytetar të mirë (L. Lazareviq, 1899). Të gjithë do të bëhemi qytetarë, të gjithë do të posedojnë pjesë të barabartë të tokës (A. Kovaçiq, 1910). Edukimi moral është detyrë që ta përgatitë fëmijën si njeri të mirë dhe qytetarë të mirë (Napredak, 1901). Para ligjit të gjithë qytetarët serbë janë të barabartë (S. Novakoviq, 1912). Nuk është i aftë ta përmbushë rolin e vet si qytetar në shoqëri (Revista mujore e shoqatës së juristëve, 1926). Çdo qytetar që është i aftë për punë juridike, në përgjithësi konsiderohet i aftë për zgjedhës (S. Jovanoviq, 1922).

3. krahinore: **thirrja me ledhatim me të cilin nusja i drejtohet mashkullit të ri në familjen e burrit apo fqinjësi**. – Nusët në Ribare më me ëndje i përvetësojnë ofiqet nga ledhatimi:

"qytetar" ose "qytetare" (S. Trojanoviq, 1902). Nuset ia ngjitin emrin kunatit: kunat, qatip, qytetar, zotërinj, vëllaçko (S.. Grbiq, 1909).

Shprehjet: *akademik (universitar) qytetar, dëgjues universiteti apo i ndonjë shkolle tjetër të lartë, student*. –Me këto do t'i dilej në ballë dëshirës që nëna-ushqyese serbe të bëhet e fuqishme me numrin e qytetarëve të vet akademik (*Porota, 1881*); qytetar i botës *ai i cili tërë botën e konsideron atdhe të vetin e të gjithë njerëzit bashkëqytetarë të vet, kozmopolit*. – Unë jam qytetar i botës (S. Matavul, 1904).

(përshtatur nga: FJALORI I GJUHËS LETRARE DHE POPULLORE
SERBOKROATE. Libri III. Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve,

Formimi i qytetarëve të ardhshëm

Shoqëria demokratike dëshiron që me arsimimin dhe edukimin e vet të:

- arsimojë nxënësit për mënyrën demokratike të të jetuarit;
- zhvillojë gatishmëri për angazhim shoqëror, respektim dhe zhvillimin e sistemit të vlerave të shoqërisë;
- kultivojë qëndrim kritik ndaj dukurive e problemeve shoqërore, vetëdije mbi nevojën e mirëkuptimit shoqëror, tolerancës dhe të drejtësisë sociale.

Shoqëria demokratike dëshiron të ndërtojë këta tipa të qytetarëve:

- **Qytetarë shembullorë** – të edukuar e të arsimuar sipas standardeve dhe kërkesave të shoqërisë demokratike;
- **Qytetar të lirë** – të cilët jetojnë e punojnë sipas principeve, parimeve, kërkesave, të drejtave dhe detyrimeve demokratike.
- **Qytetarët e përgjegjshëm të cilët:**
 - **janë të zot dhe munden** të jetojnë në bashkësi;
 - **janë të zot** dhe në mënyrë adekuate të ushtrojnë aktivitetet e tyre profesionale;
 - **do të jenë** tolerantë, kompetentë, moralisht dhe fizikisht të shëndoshë, humanë, dashamirës të së vërtetës, të përgjegjshëm, të ndershëm, kreativë, të pavarur;
 - **janë të zot dhe munden** të përfshihen dhe marrin pjesë në zhvillimin e shoqërisë demokratike.

Participimi qytetar

Participimi nënkupton çdo aktivitet në të cilin qytetari përfshihet aktivisht në procesin e marrjes së vendimeve publike dhe në këtë mënyrë ndikon në cilësinë e jetës së vet dhe të jetës së qytetarëve të vet. Participimi mbështetet në raportin prej partneri midis pushtetit e qytetarit.

Raporti prej partneri zhvillohet mbi baza të mirëbesimit reciprok i cili mund të realizohet me anë të:

- ✓ respektimit të rregullave të sjelljes politike të mbështetur mbi normat e caktuara etike;
- ✓ transparencës në punën e të gjithë organeve të pushtetit;
- ✓ përfshirjes aktive të qytetarëve në të gjitha format e jetës së bashkësisë.

Participimi dhe përfshirja aktive e qytetarëve realizohet në shkallë të ndryshme të pushtetit:

- ✓ lokal;
- ✓ krahinor;
- ✓ republikan dhe
- ✓ shkallë federale.

Funksionet themelore të pushtetit janë nxjerrja e ligjeve, zbatimi i tyre dhe zgjidhja e kontesteve në shoqëri. Këto tri funksione të pushtetit ndahen dhe u jepen në dorë organeve të ndryshme:

- ✓ pushteti legjislativ – i autorizuar për miratimin e ligjeve – parlamenti/kuvendi;
- ✓ pushteti ekzekutiv – qeveria i administron ligjet – qeveria;
- ✓ pushteti gjyqësor – zgjidhja e kontesteve – gjykatat.

Nivelet e pushtetit	Degët e pushtetit	LEGJISLATIV	EKZEKUTIV	GJYQËSOR
LOKAL		Kuvendi i komunës /qytetit	– kryetari i komunës (kryebashkiaku)	
KRAHINOR		Kuvendi i KA të Vojvodinës	– Këshilli Ekzekutiv	
REPUBLIKAN		Kuvendi Popullor	– Presidenti i Republikës – Qeveria	– Gjykata Komunale, Gjykata e Qarkut, Gjykata e Tregtisë, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese

Vërejtje: Rrethi nuk është nivel i pushtetit duke marrë parasysh faktin se nuk mund të krijojë politikën e vet, veç zbaton politikën dhe masat e organeve republikane të pushtetit (kjo është formë e dekoncentrimit të pushtetit, e jo e decentralizimit). Rrethet janë mënyrë e organizimit territorial të organeve qendrore (republikane) të administratës (pra të ministrive).

Pjesëmarrja më imediate e qytetarëve me qëllim të zgjidhjes së problemeve të individëve dhe të bashkësisë, realizohet në shkallë të bashkësisë lokale.

Çfarë arrihet veçanërisht me participimin e qytetarëve në nivelin lokal:

- ✓ përmirësimi i punës së vetëqeverisjes lokale;
- ✓ përmirësimi i jetës së bashkësisë;
- ✓ qasje informatave publike;
- ✓ mirëkuptimi dhe bashkëpunimi më i mirë midis qytetarëve dhe vetëqeverisjes lokale.

Me nxitjen e participimit në nivel lokal, autoritetet komunale i përgatisin qytetarët të përfshihen aktivisht edhe në procesin e marrjes së vendimeve në nivele më të larta, krahinore, republikane, dhe ashtu t'i kontribuojnë demokratizimit të përgjithshëm të shoqërisë..

ARSIMIMI EFEKTIV PËR DEMOKRACI DHE SHOQËRI QYTETARE

Të mësuarit interaktiv

Arsimimi efektiv për demokraci dhe shoqëri qytetare realizohet me anë të pjesëmarrjes aktive dhe fitimit të njohurive me anë të shumë kanaleve – nga mediat e ndryshme, nga ambienti i afërt dhe i largët i jetesës. Me këtë rast shfrytëzohen më shumë shqisa, angazhohen funksione të ndryshme psikike dhe fitohen rezultate më të mira dhe më të qëndrueshme. Të mësuarit interaktiv nënkupton pikërisht një proces të tillë të ndërlikuar i cili synon të imitojë procesin e njohurive, si po zhvillohet në rrethanat autentike të jetesës, dhe shpie në një përjetim të tërësishëm me përvojë, të përdorshëm dhe të qëndrueshëm. Në procesin interaktiv të mësuarit realizohet nga bashkëpunimi ndërmjet nxënësve, dhe kjo në formë të konstruksionit të përbashkët, ndërtimit të përbashkët të njohurive të reja, si dhe në formë të aktivitetit të mësimdhënësve e nxënësve që janë komplementar, pra që plotësohen.

Të mësuarit e tillë tek mënyra interaktive e punës arrihet me anë të kalimit të planifikuar, të drejtuar, të kondensuar dhe kohë të shkurtuar të fazave kyçe:

- nxënësit më parë futen në kontekst të temës me të cilën duam të merremi;
- krijohet situata e cila u mundëson të gjithëve që të marrin pjesë aktive në hulumtimin dhe gjetjen e zgjidhjeve për problemin e shtruar;
- me anë të diskutimit këmbehet, sqarohet, saktësohet dhe formësohet përvoja;
- silltet në lidhje me dijenitë ekzistuese dhe përgjithësohet.

Rrethanat e ndërlikuara në të cilat ky mësim zhvillohet dhe numri i madh i elementeve që duhen përgatitur dhe rrethanat, është njëra arsye për shkak të së cilës para mësimdhënësit shtrohen detyra të veçanta. Arsyeja e dytë del nga fakti që interaktiviteti nënkupton përfshirjen aktive të të gjithë pjesëmarrësve dhe të drejtën të komentojnë, t'i paraqesin qëndrimet e veta, të thellohen, sqarohen, rishikohen, kontestohen, kundërshtohen.

Së këndejmi është e nevojshme që mësimdhënësi të ketë dijeni, shkathtësi dhe siguri të mjaftueshme, të pajiset me gjithë atë e cila ia mundëson që e tërë rrjedha e të mësuarit interaktiv të mbahet me sukses.

Të mësuarit interaktiv kap shumë më tepër fenomene se kjo që mund të quhet grumbull i teknikave. Secili aktivitet mund të organizohet individualisht, në grupe, por tërë qasja në punë mbështetet në procesin e mësimin dhe krijimin e lidhjeve midis metodave, përmbajtjeve dhe moshave të fëmijëve.

Disa nga pikënisjet e të mësuarit interaktiv

TË MËSUARIT ËSHTË KONSTRUKSIONI AKTIV I DIJENISË	
Që të mësohet nevojitet:	
<ul style="list-style-type: none"> • aktiviteti personal • përvoja dhe veprimtari praktike • këmbimi me njerëz të tjerë 	
FËMIJËT MËSOJNË NË MËNYRA TË NDRYSHME	
Procesi i mësimit i duhet adaptuar:	
<ul style="list-style-type: none"> • tipave të ndryshëm të mësimit (inteligjenca e shumëfishtë – Gardner) • stileve të ndryshme të mësimit • tipave të ndryshme të personalitetit të nxënësit 	
MËSIMI ËSHTË:	
<ul style="list-style-type: none"> • Proces shumëdimensional: emocional, kognitiv, i vullnetshëm, social • Proces gradual: motivacioni, fitimi i informacioneve dhe dijenisë, ushtrimi, aplikimi • Proces integral: ndërlidhja me përvojën e mëparshme dhe të ardhshme • Proces kontekstual: zhvillohet me anë të interaksionit në kontekst. 	

Metoda e të mësuarit interaktiv me të cilën nxënësit mësojnë të drejtat dhe vlerat qytetare, si dhe shkathtësitë e dijenitë, me anë të përvojës mbi punën e shërbimeve publike është *mësim nga përvoja* (service learning).

Që mësimi nga përvoja të jetë i suksesshëm, është e nevojshme të realizohen këto kërkesa:

- njohja me nevojat e dalluara të bashkësisë;
- arritja e objektivave të plan-programit mësimor të lëndës së edukatës qytetare VI;
- vështrimi i përvojës së përfituar;
- zhvillimi i përgjegjësisë së nxënësve;
- vendosja e partneritetit në bashkësi;
- planifikimi i aktiviteteve në harmoni me kriteret të mësimit nga përvoja;
- fitimi i dijenisë dhe zhvillimi i shkathtësive të domosdoshme tek fëmijët.

Puna ekipore

- është angazhim i përbashkët i sinkronizuar i ekspertëve të profileve të ndryshme apo të njëjtë, ose të specialiteteve në detyrë të njëjtë
- mund të organizohet në cilëndo fushë të veprimtarive njerëzore
- nuk kërkon pajisje të veçanta
- nuk është e njëjtë me grupin e individëve, që punon diçka

Secili ekip posedon role specifike të përkufizuara me vizionin e përbashkët dhe me aftësitë e nevojshme për zgjidhjen e problemeve të caktuara. Dikush në ekip do të realizojë kontakte, dikush do të mbledhë informata, dikush do të shtypë vendimet dhe materialet e përbashkëta, dikush do të punojë në ruajtjen e energjisë dhe të entuziazmit, dikush do ta rregullojë hapësirën për takime ... Punët dhe aftësitë që nevojiten për udhëheqjen e punës ekipore janë të mëdha dhe për secilin ka vend. Ajo që është karakteristike për ekipin ka të bëjë me faktin se pavarësisht ndarjes së përgjegjësisë dhe të roleve, anëtarët e ekipit e ndihmojnë njëri-tjetrin dhe japin sugjerime për secilin segment të procesit të punës.

Në literaturën e cila merret me punën ekipore ekzistojnë disa lloje të ndarjes së roleve që ka në ekip. Disa autorë i analizojnë rolet globalisht, duke kundruar ekipin autonom nga masa dhe lloji i detyrës me të cilën merret. Kategorizimi i tillë i roleve që mund të gjenden në çdo ekip:

PJESËMARRËSI AKTIV është ai anëtar i cili është i orientuar në detyrë dhe i cili rolin e vet e sheh në gjetjen e informatave më të mira lidhur me problemin me të cilin merret.

Ai po ashtu merret me përkufizimin e objektivave dhe shfaq kujdes mbi cilësinë e përbushjes së detyrimeve. Mundohet që të gjithë bashkë të jenë sa më efektivë.

BASHKËPUNËTORI është ai anëtar i ekipit i cili është fleksibil dhe i gatshëm të ndihmojë kudo që nevojitet. Është i hapur për përvoja dhe ide të reja. Fut entuziazëm dhe përpos vetë detyrës, për të janë të rëndësishëm edhe anëtarët tjerë të ekipit dhe cilësia e marrëdhënieve ndër-njerëzore.

KOMUNIKUESI është anëtar i ekipit i cili e nxit bisedën dhe më së shumti merret me atmosferën e punës në ekip. Ai posaçërisht është i dobishëm në fazat e para të punës ekipore: i nxit të gjithë anëtarët në pjesëmarrje, është dëgjues i mirë, e krijon atmosferën e mirë, i lehtëson ujditë e përbashkëta.

PROVOKUESI është anëtar i ekipit i cili është kritik ndaj gjithë objektivave, metodave, zgjidhjeve dhe vendimeve të ekipit. Edhe pse nuk e ka përherë lehtë të rezistojë, ai është anëtar shumë i vlefshëm i ekipit sepse është i gatshëm për rrezik, kultivon sinqeritetin, i nxit tjerët të flasin mbi problemet e veta dhe mund të ndryshojë diçka në mënyrën e funksionimit të zakonshëm, nëse kjo i nevojitet ekipit.

Të katër profilet e përmendura është e dëshirueshme që t'i përmbajë secili ekip. Nuk do të vrente që ekipet kategorikisht të përbëhen nga *“bashkëpunëtorët”* dhe *“komunikuesit”* – kush do t'i kthente në detyrë? –nuk do të ishte mirë që ekipet të përbëhen nga *“pjesëmarrësit aktivë”* dhe *“provokuesit”*– kurrë nuk do të arrinin konsensus! Shkurt, ekipit i nevojiten funksione të ndryshme, sepse pikërisht ato mundësojnë që të gjitha proceset e punës ekipore të aktivizohen. Në qoftë se në ekip nuk ekziston ndonjëri nga funksionet e përmendura, ndoshta duhet thirrur ndonjë anëtar të ri.

Autorët e tjerë merren më shumë në mënyrë praktike me rolet dhe ekipin dhe lidhur me llojin e punës të cilën e ushtron ekipi. Këta autorë rolet i ndajnë në **“punuese”** (të lidhura më shumë me punën që ushtrohet) dhe **“shoqërore”** (më shumë të lidhur me interaksionin). Lista bazike e roleve sipas tyre duket kështu:

Rolet bazike në ekip:

Kontrollori	verifikon nëse e kuptojnë të gjithë rrjedhën e punës me të cilën merret ekipi
Vëzhguesi	kërkon sqarime plotësuese nga grupet dhe ekipet tjera
Rojtari	e kthen grupin në detyrë dhe e rikujton për kohën dhe afatet
Dëgjuesi	përsërit ose parafrazon çfarë u tha
Pyetësi	kërkon informata dhe mendime nga anëtarët tjerë
Përmbledhësi	i grupon konkluzionet ashtu që të mund të prezantohen
Inkurajuesi	i mbështet anëtarët e grupit dhe u jep entuziazëm
Sekretari	e ruan tërë materialin që i nevojitet ekipit për punë
Lexuesi	i gjen në ekip dhe i prezanton tekstet dhe materialet tjera
Rikujtuesi	ia rikujton grupit objektivat dhe detyrat
Mbikëqyrësi	i jep dhe i analizon pyetësorët që kanë të bëjnë me shkathtësitë sociale të nevojshme për interaksion

Pavarësisht nga qasja dhe mënyra e përkufizimit të roleve, ajo që është krejt e evidente është se rolet në ekip duhet të jenë komplementare; lypset t’i përgjigjen natyrës së punës të cilën e ushtron ekipi; rolet kohë pas kohe duhet të ripërkufizohen që të mund t’u përgjigjen ndryshimeve të krijuara të procesit ekipor. Rolet futen në interaksione të ndërvarura dhe kohë pas kohe rrotullohen në mënyrë që të gjithë anëtarët t’i zotërojnë proceset që po ndodhin në ekip. Ndarja e roleve në fillim të punës së ekipit lypset t’i përcjellë aftësitë natyrore dhe talentet të cilat anëtarët e ekipit veç i posedojnë. Më vonë pritjet që të gjithë anëtarët e ekipit të kalojnë edhe role tjera më komplekse.

DALLIMET MIDIS GRUPTI DHE EKIPIT

EKIPI	GRUPI	
Objektivat e përbashkëta të dakorduara	OBJEKTIVAT	Objektivat individuale e të pa-harmonizuara
Aksionet janë të ndërvarura e të harmonizuara	AKTIVITETI	Aksione të pavarura individuale apo grupore
Ndarja e qartë e roleve dhe e përgjegjësi	ROLET	Individët udhëheqin situatën dhe e marrin rolin varësisht nga zgjedhjet personale
Ekziston përgjegjësia individuale dhe e përbashkët	PËRGJEGJËSIA	Kryesisht ekziston përgjegjësia individuale
Suksesi dhe mossuksesi ndahet në pjesë të barabarta	SUKSESI	Individi mund të jetë i suksesshëm por jo edhe grupi
Ekipi ka rregullat e veta, mekanizmat dhe procedurat e vendimmarrjes	VENDOSJA	Rregullat dhe procedurat mundën, por nuk është thënë të ekzistojnë, merren nga situata në situatë
Secili mund të ketë idenë e vet por lypset gatishmëria që nga ajo të hiqet dorë kur zgjidhet zgjedhja më e mirë	PUNA E PËRBASHKËT	Individët mund të kenë ide dhe aksione të pavarura
Anëtari i ri i ekipit futet sipas procedurës së njëjtë, si edhe anëtarët ekzistues...	FORCA	Anëtarët e grupit mundën lirisht t'i bashkohen grupit ose ta lëshojnë

Pasqyra e shkurtër

A. OBJEKTIVAT DHE PËRMBAJTJET

Edukata qytetare VI duhet t'i njohë nxënësit e klasës së VI me të drejtat e tyre, mundësitë dhe mënyrat si të marrin pjesë në proceset demokratike. Programi i angazhon aktivisht nxënësit dhe i mëson ata si t'i përcjellin dhe të ndikojnë në vendimet e pushtetit dhe në atë mënyrë e nxit vetëdijen qytetare midis tyre, prindërve të tyre dhe anëtarëve të tjerë të bashkësisë.

OBJEKTIVAT DHE DETYRAT E PROGRAMIT

Objektivi kryesor është aftësimi i nxënësve për pjesëmarrje aktive në jetën e bashkësisë, zgjerimin e dijenisë mbi principet dhe vlerat demokratike.

Edukata qytetare VI i fut nxënësit në mënyrat dhe procedurat të cilat shfrytëzohen në proceset demokratike. Objektivi i këtij projekti është që tek nxënësit të nxisë zhvillimin e gatishmërisë për pjesëmarrje aktive qytetare në jetën shoqërore e politike

- duke ju dhënë dijeni dhe shkathtësi të domosdoshme për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore e politike;
- duke iu dhënë përvoja praktike me të cilat fitohet ndjenja e aftësisë dhe efektivitetit;
- duke zhvilluar tek ata vetëdijen mbi rëndësinë e pjesëmarrjes aktive në jetën shoqërore e politike.

Me anë të Edukatës qytetare VI nxënësit:

- fitojnë dijeni mbi funksionimin e niveleve të pushtetit;
- fitojnë dijeni mbi atë si krijohen masat e pushtetit (masat politike);
- fitojnë dijeni mbi kuptimin e masave të pushtetit (masat politike));
- fitojnë dijeni mbi rolin e qytetarit në krijimin e masave politike;
- fitojnë dijeni mbi teknikat e punës ekipore;
- zhvillojnë aftësi efektive dhe kreative të komunikimit;
- zhvillojnë shkathtësi të domosdoshme për bashkëpunim, shprehjen e mendimit dhe argumentimin e qëndrimeve;
- zhvillojnë aftësi të mendimit kritik dhe të vendimmarrjes e të veprimit të përgjegjshëm.

Besojmë se pjesëmarrja në këtë projekt do ta mbindërtojë dijeninë e nxënësve, do t'i zhvillojë shkathtësitë e tyre dhe do të thellojë mirëkuptimin në mënyrë që të gjithë bashkë, si qytetarë mund të ndikojmë në përmirësimin e bashkësive tona..

B. PËRGATITJA E KLASËS – SQARIMI I NOCIONEVE MË TË RËNDËSISHME LIDHUR ME EDUKATËN QYTETARE VI

Para se të filloni të mësoni dhe stërviteni bashkë me nxënësit t'uaj për punë në ekipe dhe në kërkimin e problemit në bashkësinë tuaj, është domosdoshme që nxënësit t'uaj të arrijnë njohuri të caktuara lidhur me termat e rinj si: qytetar efektiv, politika, pushteti, nivelet e pushtetit, organet e pushtetit, masat e pushtetit, bashkësia, Kushtetuta, ligji, dekreti ...

Nuk është keq që me anë të diskutimit dhe paraqitjes së mendimit të tij mbi secilin nocion veç e veç, me ndihmën tuaj do arrini përkufizimin më të mirë të mundshëm të cilin ata mund ta miratojnë, në përputhje me moshën e tyre, e që ato të jenë sa më adekuate për nocionin e dhënë. Pasi ky është hap tepër delikat por shumë i rëndësishëm drejt qëllimit të fundit të mbarë programit të Edukatës qytetare VI, duhet të keni mjaft durim, mençuri dhe ndjeshmëri për nxënësit tuaj.

Në tekstin e mëtejshëm kemi ofruar disa ushtrime interesante të cilat do t'ju ndihmojnë që me nxënësit t'i filloni t'i punoni nocionet themelore që do të ju fusin në punën e mëtejshme dhe në realizimin e këtij projekti. Në qoftë se konsideroni se atyre më mirë do t'ua shpjegoni në ndonjë mënyrë tjetër se si funksionin pushteti në vendin tonë, çfarë është roli i tyre në sistemin e pushtetit ... lirisht zgjidhni metodën tuaj.

Njohja

Që nxënësit të njihen pak më mirë ndërmjet tyre, para se të fillojnë me programin, mund ta bëni një ushtrim të shkurtër.

➔ Mendoni ndonjë mënyrë interesante se si do t'i ndani në 4 grupe (psh, mund të nxjerrin sheqerka të ngjyrosura në 4 ngjyra të ndryshme – secila ngjyrë e përfaqëson një grup). Jepuni një kohë të shkurtër që të njihen dhe të orvatën të gjejnë diçka që për të gjithë është e përbashkët, ndonjë karakteristikë të përbashkët të të gjithë anëtarëve të grupit. Pastaj lypset ta zgjedhin partnerin nga grupi i vet me të cilin do të këmbëjnë nga diçka, sipas të cilës çdo njëri nga ata është unikal, për çka dallohet nga të gjithë të tjerët. Pas kalimit të kohës së dhënë secili anëtar duhet të thotë cilit grup i takon – ta cekë karakteristikën e përbashkët të grupit dhe ta prezantojë çiftin e vet dhe të thotë për nga çka qifti i tij është unikal. Në këtë mënyrë klasa do të njihet/afrohet më mirë e njëkohësisht do të mësojë se si me anë të bisedës mund të mbledhin disa të dhëna themelore.

Shoqëria demokratike dhe qytetari

Qëllimi i këtij ushtrimi është që t'i fusni nxënësit në domethënien e nocioneve **shoqëria demokratike dhe qytetari**.

➔ Ndani nxënësit në dy grupe. Të parit jepni detyrë ta shkruaj në një letër të madhe asociacionet për nocionin **qytetari**, kurse grupit të dytë për nocionin **shoqëri demokratike**. Për këtë jepuni rreth 5–6 minuta.

Pas kësaj ndërrojuni letrat dhe jepuni detyrë që nga fjalët e shkruara ta formojnë fjalinë apo më shumë sosh të cilat i sqarojnë nocionet në fjalë.

Qytetari është ...

Shoqëria demokratike është ...

Me përfundimin e detyrës lypset që me nxënësit të diskutoni mbi këto nocione. Në pjesën hyrëse të këtij Doracaku i keni tekstet të cilat mund t'ju ndihmojnë për zhvillimin e këtyre bisedave.

Qytetari efektiv

Nocioni tjetër që duhet ta përpunoni është **qytetari efektiv**. Nisuni nga shembulli i thjeshtë që në fund të arrini tek nocioni kyç - qytetari efektiv. Kujtojeni ndonjë basketbollist të mirë dhe pyetni ata çka duhet të ketë një basketbollist për të qenë efektiv – i suksesshëm. Nxënësit le t'i përmendin vetitë kurse ju shkruani në tabelë. Pastaj ju thoni se sportisti i mirë lypset të ketë dije të caktuar, aftësi dhe bindje. Për shembull: që basketbollisti të jetë i suksesshëm, ai lypset të ketë dije të caktuar – si luhet basketbolli, cilat janë rregullat ..., lypset të mund të luajë basketboll, të ketë besim në vetvete dhe tek lojtarët tjerë, respektivisht të besojë në lojën e përbashkët.

➔ Ndani në tri grupe dhe secilit nga grupet jepuni ta përmendin nga një prej këtyre karakteristikave: grupit të parë jepni të përmendë dijen, tjetrit aftësinë, kurse grupit të tretë bindjen që duhet të ketë qytetari efektiv. Jepuni kohë të mjaftueshme të mendohen rreth këtyre çështjeve, e pastaj me anë të diskutimit klasor shfletoni aq dije, shkathtësi e bindje sa kanë qenë ata në gjendje t'i dallojnë dhe t'i mbrojnë me argumente. Rezultatet përfundimtare mund t'i shkruani në tabelë (tabela e njëjtë gjendet edhe në doracakët për nxënës).

	DIJA	AFTËSIA/ SHKATHTËSIA	QËNDRIMET/ BINDJET
QYTETARI EFEKTIV			

Shtrojuni nënpyetje të tilla:


Si e fitojmë/përcjellim dijeninë?

Si i fitojmë shkathtësi të ndryshme?

Pse kemi qëndrime (bindje) të ndryshme?

Më atë rast mund të shfrytëzoni edhe këtë ilustrim:

Profili i qytetarit *QYTETARI EFEKTIV DEMOKRATIK*



Disa nga dijet, aftësitë dhe qëndrimet që duhet ti posedojë qytetari efektiv:

DIJA	AFTËSIA/ SHKATHTËSIA	QËNDRIMET/ BINDJET
<ul style="list-style-type: none"> – funksioni i pushtetit – njohja e kompetencave të organeve shtetërore të pushtetit (qendrore e lokale) – struktura dhe ngarkimet e organeve shtetërore të pushtetit – njohja e Kushtetutës – njohja e të drejtave dhe përgjegjësive të qytetarëve – roli i qytetarit në shoqërinë demokratike – si merr pjesë qytetari në miratimin e endimeve shoqërore 	<ul style="list-style-type: none"> – aftësia e të menduarit kritik – grumbullimi dhe vlerësimi i informatave – sqarimi dhe caktimi i prioriteteve – identifikimi dhe vlerësimi i pasojave – vlerësimi (evaluimi) – vështrimi i të punuarit – shkathtësitë e komunikimit – mundësia e negocimit – bashkëpunimi – menaxhimi i konflikteve në mënyrë paqësore e të drejtë – arritja e konsensusit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Në planin personal <ul style="list-style-type: none"> – përgjegjësia morale – vetëdisiplina – respektimi i dinjitetit të individit dhe të lloj-llojshmërisë së qëndrimeve (empatia, mirëkuptimi i ndjenjave të të tjerëve) • Në planin publik <ul style="list-style-type: none"> – respektimi i ligjit – gatishmëria për të marrë pjesë në punët publike – pranimi i sundimit të shumicës me respektimin e të drejtave të pakicave – orientimi në ekuilibrin midis interesit personal dhe mirëqenies së të gjithëve – gatishmëria që të kërkohen ndryshime të ligjeve të përmendura në mënyrë të qetë e legale

Pushteti

Grupin tjetër të nocioneve do ta quajmë pushteti (pushteti, niveli i pushtetit, degët e pushtetit, organet e pushtetit). Kjo njëkohësisht do të jetë edhe më vështirë edhe më lehtë të sqarohet sepse të gjithë kanë dëgjuar për pushtetin, por “konfigurimin” e tij nuk e dinë edhe aq mirë. Paraprakisht përgatitsni mirë skemat dhe shembujt konkretë (për secilin nivel të pushtetit veç e veç). Këtu doemos do ta sqaroni edhe nocionin e *Kuvendit, Qeverisë, Ligjit, Kushtetutës...*

➡ Njëra nga mënyrat që nxënësit ta fusin në çështjet mbi pushtetin është që t’ju jepni detyrë ta paramendojnë të marrin pjesë në ndeshjen e basketbollit në të cilën nuk respektohen kurrfarë rregullash. Le t’i cekin problemet e mundshme të cilat do t’i shkruani në tabelë. Pyetni a do të donin të merrnin pjesë në një lojë të tillë? Orientoni bisedën në një situatë të tillë dhe në problemet që mund të lindin në mungesë të rregullave ose të autoritetit/pushtetit efektiv. Nxënësit mund të mendojnë mbi ato probleme dhe në çfarë mënyre pushteti mund të ndihmojë që ato probleme të zgjidhen. Të përfundohet se pushteti sjell vendime të atilla të cilat janë të detyrueshme për të gjithë pjesëtarët e bashkësisë, dhe se me ato vendime rregullohen raportet e ndërsjellta të qytetarëve.

Procesi i marrjes së vendimeve zhvillohet në institucione dhe sipas rregullave të përcaktuara paraprakisht.


Pushtetin legjislativ e ka Kuvendi (pavarësisht se në cilin nivel të pushtetit formohet) dhe ai nxjerr ligje.

Pushtetin ekzekutiv e ka Qeveria me në krye kryetarin e Qeverisë – kryeministrin, dhe kryetari (presidenti) i Republikës, e në nivel lokal kryetari i komunës

(krye-bashkiaku). Pushteti ekzekutiv miraton dekrete dhe i zbaton ligjet që i kanë miratuar organet legjislative.

Pushteti gjyqësor gjendet në duart e gjykatave të ndryshme të cilat kujdesen mbi respektimin e ligjit, dhe kontrollojnë nëse puna e organeve të shtetit po ushtrohet në harmoni me Kushtetutën¹. Të tri degët e pushtetit e kontrollojnë njëra - tjetrën dhe duhet të jenë të baraspeshuara që të mos vijë deri tek diktatura, respektivisht sundimi i një njeriu apo i një grupi të vogël njerëzish.

Mund t'ua shpjegoni punën e organeve të shtetit duke shfrytëzuar tabelën nga pjesa mbi participimin qytetar (faqe 8). Pastaj sqaroni ku gjenden ata si qytetarë në sistemin tonë shoqëror. Për këtë sqarim mund t'u shërbejë skema në vijim:



Kjo pasqyrë skematike do t'ua mundësojë juve që nxënësve t'ua sqaroni se ku gjenden ata si qytetarë në sistemin e pushtetit të vendit tonë, dhe si ata, si pjesë e sistemit ekzistues shoqëror, mund të ndikojnë në proceset e krijimit të jetës publike. Është me rëndësi që nxënësit ta kuptojnë rolin qendror të pushtetit (lokal, republikan, federal) në krijimin e masave politike.

Lypset të kuptojnë edhe atë se ky rol i pushtetit është vetëm një pjesë e tërë procesit, dhe të gjithë qytetarët në ndonjë bashkësi duhet të stimulohen të marrin pjesë. Vendimmarrja demokratike kërkon edhe pëlqimin e qytetarëve që ata të drejtohen (ose të qeverisën) dhe pjesëmarrja e tyre në procesin e qeverisjes (ose në procesin e ushtrimit të pushtetit).

Qytetarët mund të marrin pjesë në punët publike në dy mënyra – indirekt dhe direkt.

- Mënyra indirekte e pjesëmarrjes së qytetarëve në punët publike nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur - deputetëve apo këshilltarëve
- Ekzistojnë dy forma të mënyrës direkte të pjesëmarrjes së qytetarëve.

^{1/} Dispozitë më e lartë juridike e ndonjë shteti. Të gjitha dispozitat tjera (ligjet, dekretet, rregulloret...) duhet të jenë në harmoni me atë. Kornizë e tërësishme e sistemit politik të një shteti.

- Njëra nga ato forma është referendumi të cilin e shpallin organet e pushtetit e ku qytetarët deklarohen me anë të votimit.
- Forma tjetër është iniciativa qytetare të cilën e japin vetë qytetarët.

Është me rëndësi që nxënësit ta kuptojnë rolin e qytetarëve në krijimin e masave politike. Qytetarët mund të përfshihen në të gjitha shkallët e proceseve – me pjesëmarrje në takimet politike, me shkrime ose telefonata përfaqësuesve të vet në pushtet, me shkrime ose telefonata mjeteve të informimit publik, me shqyrtimin e propozimeve dhe kundërpropozimeve, me pjesëmarrje në demonstrata, me bindjen e bashkëqytetarëve, zbatimin e hulumtimeve, me paraqitjen e propozimeve edukative... Lista e cila nuk përfundon me këtë, tregon sa mundësi kanë qytetarët për pjesëmarrje me rastin e vendimmarrjes.

Masat e pushtetit

Pasi një nga objektivat kryesore të këtij projekti është që t'u ndihmojnë nxënësve të mësojnë si të marrin pjesë në pushtet, ata duhet t'i studiojnë problemet të cilat pushteti, qoftë edhe pjesërisht, i zgjidh apo lypset t'i zgjidhë. **Nxënësit do të duhet të shihnin se si, sa dhe në çfarë mënyre pushteti ndikon në jetët e tyre.** Mund t'u flisni për atë se çfarë keni bërë ndonjë prej ditëve të shkuara: ku keni shkuar, çfarë keni pasur të veshur, çfarë keni parë, ngrënë, thënë, mësuar apo punuar. Flisni për atë sa ndikon pushteti në secilën nga këto gjëra. Sqarojuni nxënësve se pushteti ndikon në jetën e përditshme të qytetarëve me marrjen e masave të caktuara.

Krijimi i masave të pushtetit fillon kur njerëzit në bashkësi kuptojnë se ekziston problemi. Të kuptuarit mbi ekzistimin e problemit mund të rrjedhë nga mediat, politikanët, shoqatat qytetare apo institucionet e pushtetit. Qytetarët pastaj i formulojnë idetë mbi atë si të zgjidhet më së miri problemi. Njerëzit të cilët posedojnë ide, përpiqen ta bindin pushtetin t'i miratojë këto ide dhe të realizojnë zgjidhje. Shpesh paraqiten edhe propozime të reja. E tërë procedura e përfshinë grumbullimin dhe shqyrtimin e të dhënave, vlerësimin e pasojave të veprimit të mundshëm dhe grumbullimin e mbështetjes për njërin apo tjetrin propozim. Kur njëherë të pajtohen rreth një veprimi të caktuar, duhet ta bindin pushtetin përkatës dhe organet e pushtetit që t'i miratojnë masat e propozuara. E kur masat miratohen pason zbatimi i tyre. Shprehja masat e pushtetit (masat politike) këtu shfrytëzohet në kuptimin e mënyrës së dakorduar të veprimit të pushtetit, në cilindo nivel, me të cilin ajo o kryen detyrat për të cilat është përgjegjëse, siç është mbrojtja e të drejtave personale apo puna në mirëqenien e përgjithshme të të gjithëve. Pushtetet legjislative (kuvendet) disa masa i fusin në ligj. Të tjerat i përmbajnë dekretet dhe dispozitat e tjera të degës ekzekutive të pushtetit (Qeverisë), që është përgjegjëse për zbatimin dhe aplikimin e ligjeve.

Që nxënësit t'i miratojnë më lehtë këto nocione, mund t'i bëni këto ushtrime:

➡ Ndani nxënësit në grupe (në secilin grup 4 – 6 nxënës). Secilit nga grupet ndajuni nga një kopje të gazetave ditore (mundësisht të ndryshme) dhe secila grup le ta gjejë dhe presë nga gazeta lajmin i cili mund të shënohet si masë e pushtetit (masë politike). Bashkë me këtë le të caktojë edhe nivelin e pushtetit që ka marrë atë vendim. Pas kësaj nga një përfaqësues i secilit grup duhet t'ia kumtojë atë lajm gjithë klasës dhe ta arsyetojë, përse grupi është përcaktuar për masën e cekur.

Në këtë mënyrë menjëherë do të mësoni se si i kanë kuptuar nxënësit nocionet paraprake, kurse ata direkt mund ta aplikojnë dijen që pikërisht e kanë fituar.

Jepuni mjaft kohë (ose megjithatë kohë të kufizuar) për këtë detyrë.

➔ Mund të verifikoni nëse nxënësit e kanë kuptuar nocionin masat e pushtetit (masat politike) ashtu që do t'ua jepni detyrën në vijim. Ndani nxënësit në grupe dhe u thoni se në bazë të shembullit të dhënë në tabelë ta plotësojnë pjesën e saj të mbetur. Në kolonën e majtë le ta shkruajnë shembullin e zgjidhjeve që nuk paraqesin masat e pushtetit, e në të djathtë shembullin që paraqet masat e pushtetit. Tabela gjendet edhe në *Doracakun për nxënës*.

NUK ËSHTË MASË E PUSHTETIT	TEMA	MASA E PUSHTETIT
Dashmirësit e kafshëve organizojnë ushqimin dhe përkujdesjen për qentë.	Qentë endacakë po bëhen problem i madh i qytetit.	Autoritetet lokale nxjerrin normën për vendosjen e qenve endacakë në azil të përkohshëm, me kontroll obligues të veterinarit, përzgjedhjen, evidentimin.
	Të miturit mund të blejnë alkool dhe cigare.	
	Vozitësit nuk e vënë rripin e sigurisë.	
	Pishina e qytetit është e lënë pas dore, e parregulluar dhe plot mbeturina.	
	Qytetarët dëshirojnë të ndërtojnë qendrën sportive.	

Nga ky shembull nxënësit mund të dalin në përfundimin se disa probleme nuk kërkojnë nga pushteti të nxjerrë masa, e disa nuk mund të zgjidhen pa pjesëmarrjen e pushtetit. Disa kritere që mund tu ndihmojnë për ta vërtetuar pyetjen /problemin i cili mund (dhe duhet) të zgjidhet me masat e pushtetit, janë këto:

Vëllimi Sa është e shtrirë pyetja/problemi i shtruar? (pyetje kuantitative)

Intensiteti Nëse shumë njerëz janë të interesuar për pyetjen/problemin, sa u ka ngelur tek zgjidhja e tij? (pyetje kuantitative)

Shkaku Cilët janë burimet e problemit për të cilin është fjala?

Zgjatja A është ky problem i cili ekziston në një periudhë të gjatë kohore?

Ndotja e ambientit Narkomania Të pastrehët.....

Vëllimi

Intensiteti

Shkaku

Zgjatja

Puna ekipore

Edhe një temë e rëndësishme e cila duhet të përpunohet para fillimit të punës në projekt, është puna ekipore. Nxënësit lypset të adresojnë karakteristikat e saj dhe rëndësinë në mënyrë që puna në projekt të jetë e suksesshme. Kjo mund të tregohet edhe me një ushtrim të thjeshtë.

➡ Ndani nxënësit në grupe (5 – 6 nxënës) dhe secilit jepni nga një qese me “smoki” dhe kuti me shkrepe. Secilit grup jepni detyrë që në afatin prej 5 minutash ta punojë shtëpinë prej materialit të dhënë, por ashtu që secili nga ata ta shfrytëzojë vetëm një dorë. Gjatë punës nuk duhet të flasin.

(Në secilin grup, për shkak të kohës së kufizuar, me siguri do të paraqitet “prijësi” i cili do të diktojë çfarë të punohet ose do të punojë vetë, kurse anëtarët e tjerë do t’i ndihmojnë ose vetëm do të shikojnë çfarë punohet, apo do të shkaktohet grindja pa rezultate. Nuk do të ketë ndarje të detyrave kështu që shumica nuk do ta kenë shtëpizën e ndërtuar.)

Nëse keni kushte, në vend të ushtrimit paraparak mund të bëni sa vijon më poshtë:

➡ Ndani nxënësit në grupe (5–6 nxënës) dhe secilit jepni nga tetë letra të mëdha, 4 gota plastike, shiritin për ngjitje. Secilit grup jepni detyrë që në afatin prej 15 minutash ta ndërtojë shtëpizën ashtu që ajo, nga njëra anë, të ketë hyrjen nëpër të cilën mund të hyjë një nxënës.

Pas këtij ushtrimi grupet lypset të pyeten, si është zhvilluar ndërtimi i shtëpizës, si janë ndierë gjatë punës, cilat kanë qenë vështirësitë, me çfarë kanë qenë të kënaqur e me çfarë jo gjatë punimit. Secili grup do t’i shfletojë vërejtjet pozitive dhe negative për rrjedhën e punës, dhe do të cekë se çfarë do të ndryshonte sikur ta punonte të njëjtën detyrë. Diskutoni me ta si është zhvilluar procesi i punimit, çfarë kanë qenë raportet në grup dhe çfarë kanë fituar si rezultat i kësaj. Me këtë ua keni sqaruar tri dimensione të secilës punë të përbashkët, sepse në qoftë se ekziston relacioni i qëndrimit dhe i këmbimit midis pjesëmarrësve dhe nëse procesi është dinamik dhe i balancuar, realizimi i detyrës duhet të jetë i suksesshëm.

Mund të diskutoni me nxënësit mbi atë se çfarë është puna ekipore dhe cilat janë karakteristikat e saj (tekstin e gjerë e keni në hyrjen e Doracakut). Bisedoni mbi dallimin midis punës grupore dhe ekipore. Në këtë mund t’u ndihmojë tabela nga pjesa mbi punën ekipore (faq. 14).

➡ Që ta dalloni ekipin nga grupin, jepni grupit tuaj nga një zarf me kartat në të cilat janë shkruar karakteristikat e grupit dhe ekipit, që janë të përziera. Jepuni detyrë që ta veçojnë një varg me karakteristikat e ekipit, kurse vargun tjetër me karakteristikat e grupit. Këtë lypset ta bëjnë për 7 – 8 minuta. Në fund njëri grup le ta prezantojë çfarë ka bërë, e ju shkruajeni këtë në tabelë.

Ose mund t'iu jepni grupeve detyrë që t'i shfletojnë faqet pozitive e negative të punës ekipore dhe t'i shkruajnë në tabelë.

PUNA EKIPORE	+/ FAQET POZITIVE	-/ FAQET NEGATIVE
RAPORTI		
PROCESI		
REZULTATI		

Kur ta përpunoni edhe këtë temë, jeni të gatshëm të kaloni në nivelin tjetër të Edukatës qytetare VI.

C. PASQYRA E UDHËZIMEVE

I Udhëzime për punimin e projektit

Nxënësve duhet shpjeguar shkurt si rrjedh procesi i punës në projekt. Thojuni se përbëhet nga gjashtë hapa, e këta janë:

1) Vërejtja e problemit. Nis me vërejtjen e atij problemi në bashkësinë vetjake të cilin e konsiderojnë të rëndësishme dhe me caktimin e organeve të pushtetit përgjegjës për zgjidhjen e këtij problemi.

2) Cili problem të përzgjidhet? Klasa do të vendosë se me cilin problem do të merret në kuadër të këtij projekti.

3) Mbledhja e të dhënave. Kur klasa vendos se cilin problem do ta shqyrtojë, do të nevojitet të mbledhë dhe shqyrtojë të dhënat nga burime të ndryshme mbi këtë problem.

4) Projektimi, zhvillimi dhe punimi i studimit të klasës. Lypset të zgjedhin të dhënat të cilat e përshkruajnë problemin dhe t'i shqyrtojnë masat e pushtetit që merren me atë problem. Gjithashtu do t'i shqyrtojnë masat të cilat i propozojnë tjerët. Do të hartojnë masat të cilat konsiderojnë se duhet t'i përqafojë pushteti. Do ta zhvillojnë planin e veprimit për të treguar se si mund të ndikojnë në atë që organet përkatëse të pushtetit t'i përqafojnë masat të cilat i propozojnë. Gjithë këtë do ta prezantojnë në studimin e klasës.


5) Prezantimi i studimit të klasës. Kur e ka përfunduar studimin e klasës, mund ta prezantojnë para publikut apo jurisë prej tre apo katër vetash, të cilët përfaqësojnë shkollën apo bashkësinë tuaj..

6) Çfarë t'i mësoni. Do të mendojnë mbi përvojat që kanë fituar me punimet të cilat i kanë përfunduar. Kjo mënyra e të mësuarit është e nevojshme që në të ardhmen të shmangen gabimet dhe të përmirësohen aftësitë.

Klasa juaj do t'i shfrytëzojë materialet të cilat i kanë mbledhur ose i kanë shkruar vetë për punimin e studimit të klasës. Kjo është përzgjedhje e organizuar e materialit i cili i përmban tekstet (artikujt e prerë nga shtypi, pjesët e fotokopjuara të librave e gazetave, punimet e veta të shkruara e të shtypura në letër ...), hartat, grafikonet, figurat dhe punëdoret e tyre të pavarura (vizatimet, kolazhet ...). Këto materiale do të organizohen në katër kaptina (pjesë):

- 1) në të parën do të jetë ajo që kanë mësuar mbi problemin e përzgjedhur;
- 2) në të dytën – ajo që kanë mësuar mbi masat të cilat do ta zgjidhin atë problem;
- 3) në të tretën – masat që i kanë përzgjedhur apo e kanë menduar mirë për zgjidhjen e problemit;
- 4) në të katërtën – plani i veprimit që e kanë menduar mirë për t'i përfituar autoritetet që t'i përqafojnë masat të cilat i propozojnë.

Studimi do të ketë dy pjesë – **dokumentuese dhe demonstruese (pllakat)**. Pjesa dokumentuese do të jetë në fashikulla të cilat do të përmbajnë materialin e mbledhur, kurse në pllakat do të jetë përzgjedhja e materialit i cili e tregon punën e klasës më të lartë më së miri. Pllakati me vija horizontale do të ndahet në katër fusha dhe secila do të përmbajë materialin përkatës nga katër kaptinat e cekura të studimit.



Nëse planifikohet mbajtja e garave ndoshta do të dëshironi të theksoni se, edhe krahas dëshirës së natyrshme që të fitohet, është më e rëndësishme që nxënësit të përqendrohen në atë që të mësojnë sa më shumë. Dija që e fitojnë do të zgjasë shumë më tepër sesa kënaqësia momentale që e sjellë fitorja e garës.

II Ndhimja vullnetare e të rriturve

Edhe pse kjo nuk është e domosdoshme, ju propozojmë t'i kërkonti të rriturit të cilët vullnetarisht do t'u ndihmonin nxënësve për t'i kryer detyrat. Ata mund të jenë prindërit, mësuesit, udhëheqës të aradhave vëzhguese apo qytetarë të tjerë. Ata mund t'i paraqesin përvojat e veta, të flasim mbi shembujt e mëhershëm të masave të ngjashme, të ndihmojnë gjatë hulumtimeve në terren, të vendosin lidhjen e përhershme me nxënësit të cilët me ta mund të kontaktohet me telefon apo personalisht, të përgjigjen në të gjitha pyetjet e mundshme që lindin gjatë punës ...

a. Propozimet e ndihmësve vullnetar

- ◆ **Studimi i detyrës dhe i procedimit.** Ndhimojuni nxënësve që të kuptojnë hapat që duhet t'i ndërmarrin gjatë punimit të studimit. Ndhimojuni që t'i kuptojnë *Masat për punimin e studimit*.
- ◆ **Mbledhja e të dhënave.** Ndhimojuni nxënësve që t'i dallojnë burimet e të dhënave. Sqarojuni si t'i mbledhin të dhënat. Për shembull nxënësve mund t'iu ndihmoni që:
 - të gjejnë të dhëna në bibliotekë;
 - t'i shfrytëzojnë adresarët në mënyrë që t'i gjejnë adresat e organeve të pushtetit, të institucioneve, shoqatave të qytetarëve të cilët mund të kenë të dhëna mbi problemin e shqyrtuar;
 - të shfrytëzojnë kompjuterët për hyrje në rrjetet elektronike të informacionit (për shembull në Internet) për sigurimin e të dhënave mbi problemin e shqyrtuar;

- të vënë kontakt me njerëzit nga bashkësia juaj, të cilët mund të jenë burim i dobishëm i të dhënave mbi problemin e shqyrtuar;
 - të shkruajnë letra me të cilat kërkojnë të dhënat;
 - të përgatiten për bisedë personale apo telefonike me personat të cilët kanë të dhëna mbi problemin e shqyrtuar;
 - të shkojnë deri në vendin ku mund të sigurojnë të dhëna.
- ◆ **Përgatitja e prezantimit të studimit të klasës.** Stërvitni nxënësit për prezantim gojor të studimit. Ndhimojuni të organizojnë prezantim gojor përpara anëtarëve të bashkësisë.
 - ◆ **Vështrimi i përvojës së fituar.** Ndhimojuni nxënësve që të përgatisin deklarata me shkrim mbi rrjedhën e mësuar të punës, ku janë ndeshur me problemet dhe çfarë do të bënin ndryshe për të punuar ndonjë studim të ri.

b. Kufizimet që duhet t'i respektojnë ndihmësit vullnetar

- ◆ **Mbledhja e të dhënave.** Të rriturit nuk duhet të mbledhin të dhënat për nxënësit, si:
 - të shkruajnë letra ose do të telefonojnë në vend të tyre;
 - të hulumtojnë në vend të tyre.
- ◆ **Punimi i studimit.** Të rriturit nuk duhet t'u ndihmojnë nxënësve:
 - me shkrimin e materialit i cili duhet futur në studim;
 - me punimin e vizatimeve apo të paraqitjeve të tjera figurative;
 - me përzgjedhjen e materialit për futje në studim.
- ◆ **Përgatitja e prezantimit gojor të studimit të klasës.** Të rriturit nuk duhet të përgatisin prezantimin e studimit në vend të nxënësve.

Si t'u ndihmoni nxënësve tuaj për ta hartuar studimin e klasës

Duke shfrytëzuar këto propozime, ndihmohuni nxënësve tuaj t'i kuptojnë hapat e domosdoshëm për punimin e studimit të klasës. Të jeni të lirë për t'i ndryshuar apo përshtatur sipas mënyrës që e konsideroni të dobishme.

Hapi i parë

Vërejtja e problemeve në bashkësinë tuaj

1. Bisedoni me nxënësit mbi qëllimin e këtij hapi. Ata lypset:

- ta kujtojnë atë që e dinë vetë mbi problemin e bashkësisë së vet;
- t'i diskutojnë ato probleme me prindërit, fqinjët apo banorët tjerë të bashkësisë që të zbulojnë çfarë dinë dhe mendojnë për ato probleme;
- të mbledhin mjaft të dhëna për përzgjedhjen e problemit të cilin shumica e nxënësve në klasë e konsideron qenësor.

Regjistri i problemeve të përbashkëta për shumë bashkësi është dhënë në Doracakun për nxënës, me qëllim të përqendrimit të vëmendjes së nxënësve në to.

Njoftoni nxënësit se nuk është e thënë të deklarohen për asnjërin nga problemet e përmendura. Mund ta përzgjedhin ndonjë problem tjetër të cilin e konsiderojnë të qenësishëm për bashkësinë e tyre. Mirëpo, është me rëndësi të vendosin për problemin për të cilin mund të propozojnë masa të arsyeshme e të ekzekutueshme.

Studimet nuk duhen vlerësuar në bazë të problemit të përzgjedhur. Vlerësimi duhet të mbështetet në faktin nëse klasa mbledh, vlerëson dhe i përpunon si duhet të dhënat mbi problemin, a po i hulumton mirë dhe a po i zhvillojnë masat që i propozojnë dhe planin e veprimit për përqafimin e atyre masave.

2. **Bisedë rreth asaj që nxënësit dinë mbi problemin në bashkësi.** Udhëhiqni nxënësit nëpër debatin fillestar në lidhje me atë çfarë dinë mbi problemin të cekur në Doracakun e tyre. Pastaj ndani ata në qifte apo treshe dhe thojuni që bashkë të përgjigjen në pyetjet nga Pyetëtori për vërejtjen dhe analizën e problemit (Shtojca faq. 62). Në fund, grupet le t'i raportojnë dhe debatojnë përgjigjet e veta, përpara tërë klasës.

3. Detyrë shtëpie. Jepuni nxënësve këto detyra:

- ta përzgjedhin njërin nga problemet e cekura apo ndonjë problem tjetër të përmendur gjatë debatit, dhe të bisedojnë mbi atë me anëtarët e familjes, shokët, fqinjët apo njerëz tjerë të cilët i njohin;
- të kërkojnë në gazeta apo burime tjera të shtypura prova mbi ekzistimin e problemit dhe masat për zgjidhjen e tij në bashkësinë tuaj;
- t'i dëgjojnë apo shikojnë lajmet dhe raportet në radio apo televizion, që kanë të bëjnë me problemin dhe masat përkatëse.

Mund ta ndani klasën në grupe të ngarkuara për një apo më shumë detyra, varësisht nga interesimi dhe aftësia. Të dhënat lypset t'i shkruani në Pyetëtorin për mbledhjen e të dhënave (Shtojca fq. 63–65). Verifikoni nëse nxënësit kanë mundësi ta shfrytëzojnë pyetëtorin.

Hapi dytë

Cilin problem ta përzgjidhni?

Nxënësit tuaj tani duhet të bisedojnë për atë se çfarë kanë mësuar mbi problemet e bashkësisë së vet para përzgjedhjes së problemit me të cilin do të merren. Përzgjedhja e drejtë e problemit është jashtëzakonisht e rëndësishme për punën e mëtejme në Edukatën qytetare VI, prandaj është e domosdoshme që t'i përkushtohet vëmendje shtesë. **Është me rëndësi që të gjithë nxënësit të ndjejnë se ai është problemi i tyre i përbashkët** dhe nevojitet të bashkëpunojnë në hulumtimin dhe punën e mëtejshme në projekt. Mësimdhënësi nuk guxon, në asnjë mënyrë, të ndikojë në marrjen e vendimit mbi përzgjedhjen e problemit, por mund t'u ndihmojë nxënësve për ta shikuar me kujdes çdo problem të vërejtur nga të gjitha anët dhe ata të lidhin me kompjuterët e instaluar.

Udhëhiqni nxënësit tuaj në debatin mbi atë që kanë mësuar duke punuar në mbledhjen e të dhënave mbi problemet në bashkësinë lokale (tekstin mbi zhvillimin e diskutimit e keni në shtojcën e Doracakut në faq. 80). Shqyrtoni pyetjet si këto:

- Çfarë keni mësuar mbi problemet e bashkësisë nga njerëzit me të cilët keni biseduar?
- Cilat probleme ju duket se kërkojnë zgjidhje më urgjente?
- A mund të zgjidhen ato me zhvillimin e masave të pushtetit (masave politike)?
- Cilat probleme ju duket se kërkojnë ndryshimin e masave të tashme?
- Cilat probleme të bashkësisë më së shumti iu interesojnë dhe brengosin?

Si rezultat i këtij debati do të fitoni listën e problemeve të cilat nxënësit i kanë dalluar. Nga gjithë ato probleme nevojitet që nxënësit të deklarohen për njërin, të cilin do ta hulumtojnë më tutje. Njëra nga mënyrat e ngushtimit të zgjedhjes dhe përzgjedhjes së një problemi është më sa vijon:

- mund t'i analizoni dhe bashkoni të dhënat e mbledhura me ndihmën e pyetësorit nga hapi i parë;
- mësimdhënësi duhet t'i shfletojë të gjitha idetë në tabelë;
- shfrytëzoni këto pyetje në mënyrë që ta analizoni çdo propozim veç e veç:
 - A është ky problem lokal?
 - A mund të zgjidhet problemi me masën e pushtetit (me masë politike)?
 - A është problemi tejet voluminoz (kriminalitet), dhe a mund të ngushtohet (psh. grafitët në shkolla ...)?
 - A është problemi i zgjidhshëm (psh. problemi i të pastrehëve në raport me ndërtimin e strehimores për të pastrehët)?
 - A mund të argumentohet rëndësia e problemit?
 - A besoni se mund të gjendet zgjidhje reale?
 - A mund të bëhet hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave për këtë problem?
- nxënësit votojnë për propozimin ashtu që do të shënojnë propozimin (ose propozimet) që ju duken më të pranueshëm (disa nga këshillat dhe propozimet e dobishme si mund ta kryeni votimin, gjenden në pjesën e *Doracakut* në faq. 86).

Në qoftë se ndodh që disa probleme kanë numër të njëjtë apo të përafërt të votave, kërkoni që nxënësit ta argumentojnë përse mendojnë se pikërisht ky është problemi me të cilin duhet të merren. Mund të ndodhë që disa nxënës ta ndryshojnë mendimin kur të dëgjojnë argumentet, prandaj mund ta organizoni edhe një rreth të votimit. Në qoftë se nxënësit nuk kanë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur se me cilin problem do të merren, ose nëse duan të njihen edhe me problemet tjera, vazhdoni hulumtimin më tutje. Mund t'i shfrytëzoni pyetësorët për mbledhjen dhe shënimin e të dhënave nga hapi i parë, ose u jepni kuptim pyetësorëve tuaj të cilët do t'ju ndihmojnë për të mbledhur të dhëna shtesë mbi problemet. Pas kësaj me nxënësit diskutoni sërish secilin propozim.

Hapi i tretë

Mbledhja e të dhënave mbi problemin

Kur klasa njëherë e zgjedh problemin, nxënësit lypset t'i mbledhin të dhënat shitesë, të cilat do t'i shfrytëzojnë në studimin e klasës. Që këtë të mund ta bëjnë nevojitet t'i caktojnë burimet e të dhënave.

Njohja me burimet e të dhënave

Udhëhiqni nxënësit me anë të bisedës mbi burimet e të dhënave për problemin me të cilin merreni. Cekni burimet e të dhënave nga bashkësia juaj. Derisa flisni mbi secilin nga burimet e mundshme, pyesni nxënësit në lidhje me atë që e dinë për to, si dhe për përvojat e tyre të mundshme të deritashme me ato. Nxënësit mund t'i pyesni edhe nëse e njohin ndonjë person të rritur të cilëve mund tu adresohen për të dhëna. Për shembull, a e njohin ndonjë avokat, shkencëtar, gazetar, mjek, personin që punon në ndonjë shërbim të pushtetit lokal apo veprimtarinë e ndonjë shoqate qytetare? Nëse e njohin, shënjeni të dhënat në mënyrë që t'i përdorni me rastin e punës në grupet studimore. Shembujt e burimit të të dhënave, që ata kanë në doracakët e tyre, janë këto:

- **BIBLIOTEKAT** – Bibliotekat shkollore, komunale, të qyteteve, universitare e tjera në bashkësinë tuaj kanë gazeta dhe publikime me të dhënat mbi problemet me të cilat merreni. Nëse bibliotekat kanë aparate për fotokopjim, materialët për studimin mund t'i shumëzoni menjëherë.
- **REDAKSITË** – Ndoshta do të dëshironit t'iu adresoheni redaksive të mediave në bashkësinë tuaj. Gazetarët i mbledhin të dhënat mbi problemet e bashkësisë së tyre dhe atë që bëjnë autoritetet lidhur me to. Redaksitë dhe gazetarët ndoshta do të mundën të japin përzgjedhjen e artikujve dhe të figurave mbi problemin me të cilin merreni.
- **PROFESORËT DHE HULUMTUESIT** – Në vendin tuaj ndoshta jetojnë edhe profesorët e fakultetit dhe të shkollave të larta dhe shkencëtarë të tjerë të cilët merren me problemin që u intereson edhe juve. Mund tu luteni atyre institucioneve për ndihmë për gjetjen e specialistëve të cilët mund t'ju ndihmojnë. Gjithashtu mund të vini kontakt me profesorët e shkollave të mesme të lëndëve të qenësishme për problemin me të cilin merreni– për shembull, Kushtetuta dhe të drejtat e qytetarëve ose biologjia e kimia (për problemet e ndotjes së ambientit).
- **AVOKATET DHE GJYQTARËT** – Shumica e avokatëve dhe gjyqtarëve u takojnë odave të avokatëve, shoqatave të gjyqtarëve dhe shoqatave tjera profesionale të cilat mund të ofrojnë ndonjë shërbim pa pagesë. Në adresarin telefonik gjeni adresat dhe numrat e telefonave të atyre shoqatave. Avokatët dhe gjyqtarët janë burim i shkëlqyeshëm i të dhënave mbi shumë probleme të bashkësisë. Pyetni drejtorin e shkollës a ka prej tyre midis prindërve të nxënësve.
- **SHOQATAT E QYTETARËVE** – Shumë grupe interesohen për problemet e bashkësive tona apo të vendit tonë. Ato quhen **shoqatat e qytetarëve**. Gjatë punës në detyrën parë shtëpiake ndoshta keni vërejtur disa shoqata të qytetarëve të cilat merren me problemet me të cilat po merreni edhe ju. Disa shoqata të qytetarëve ndoshta janë në bashkësinë tuaj apo në rajon. Mësimdhënësi ose personi tjetër i

rritur mund t'ju ndihmojë që t'i thërrisni ose t'i lusni me letër për të dhënat. Shfrytëzoni adresarin që të mund t'i gjeni adresat e tyre.

- **ORGANET LEGJISLATIVE** – Përfaqësuesit tuaj në degët e pushtetit legjislativ në nivele të ndryshme – këshilltarët komunalë dhe deputetët republikanë e federativë – janë përgjegjës për zbulimin e problemit dhe propozimin ose mbështetjen e masave që kanë të bëjnë me atë problem. Deputetët dhe këshilltarët duhet të jenë të kapshëm ose që në zyrat e veta të kenë nëpunës të ngarkuar që juve dhe gjithë qytetarëve t'u ndihmojnë në marrjen e të dhënave mbi problemet e bashkësisë, të republikës ose mbarë vendit.
- **ORGANET ADMINISTRATIVE** – Njerëzit e punësuar në organet administrative të pushtetit komunal, republikan ose federativ ndoshta po merren me problemet që i ka zgjedhur klasa juaj për t'i studiuar. Shërbimet informative të organeve administrative mund tu ofrojnë të dhëna mbi problemin dhe masat që po ndërmarrin autoritetet lidhur me të. Për shembull, komuna juaj mund të ketë sekretariatën për shëndetësi ose për ndërtimtari. Shfrytëzoni adresarin për t'i gjetur adresat e tyre ose adresat e organeve të tjera përkatëse.
- **RRJETET ELEKTRONIKE TË INFORMATIKËS** – Disa nga burimet e përmendura, por edhe shumë të tjerë, janë të qasshëm nëpërmjet internetit. Nëse shkolla juaj nuk ka kompjuter me qasje në internet, kërkoni ato në internet-kafetë, biblioteka, fakultete, shkolla të larta e gjetkë.

Pas bisedës mbi burimet e të dhënave kërkoni nga nxënësit të caktojnë nëse ato burime të të dhënave janë relevante dhe të qasshme për problemin me të cilin merren (mund të punojnë individualisht ose në grupe). Për këtë mund ta shfrytëzoni tabelën në vijim:

BURIMI I TË DHËNAVE	A ËSHTË AI BURIMI I TË DHËNAVE RELEVANT PËR PROBLEMIN TONË / + - /	A ËSHTË AI BURIM I TË DHËNAVE I QASSHEM
REVISTAT, GAZETAT DHE MATERIALET E SHTYPUR		
PROFESORËT DHE HULUMTUESIT (specialistët për fushën relevante)		
AVOKATËT DHE GJYQTARËT		
ORGANËT LEGJISLATIVE DHE ADMINISTRATIVE		
INTERNETI/ MEDIAT ELEKTRONIKE		
...		

Pasqyra e rekomandimeve për mbledhjen dhe dokumentimin e të dhënave

Para se nga nxënësit të kërkoni të vënë kontakt me burimet e të dhënave, është shumë me rëndësi t'i përpunoni udhëzimet për marrjen dhe dokumentimin e të dhënave. Do të ishte mirë që me nxënësit të ushtroni mënyra të ndryshme të adresimit të burimeve të të dhënave – personalisht, me telefon, me letër ... (propozimet e ushtrimeve i keni në kaptinën, në faqe 88). Keni kujdes që të mos ndodhë që më shumë nxënës të vënë kontakt me një person apo shërbim, në mënyrë që të mos i ngarkojnë. Shumica e njerëzve të cilët punojnë në vendet ku mund të merren të dhënat, janë shumë të zënë.

Është me rëndësi t'i ndiqni propozimet e cekura më poshtë në mënyrë që të mos i ngarkoni shërbimet dhe personat të cilëve do t'iu adresoheni për të dhënat.

- 1. Vizita në biblioteka apo vende të tjera ku mund të gjenden të dhënat.** Nxënësit mundën individualisht, apo në grupe të vogla t'i vizitojnë bibliotekat apo lokalet e institucioneve dhe grupeve të ndryshme, të cilat kanë të dhënat mbi problemin me të cilin po merremi. (Të dhënat i shkruajnë në *Pyetësin e dokumentacionit për të dhënat nga burimet e shtypura*).
- 2. Telefonata burimit.** Vetëm një nxënës duhet të ngarkohet për marrjen telefonike të të dhënave për ta mbajtur evidencën mbi thirrjet dhe të dhënat e marra ashtu. (Të dhënat i shkruajnë në *Pyetësin e dokumentacionit për të dhënat nga letrat apo biseda*).
- 3. Caktimi i takimeve dhe bisedat.** Një nxënës lypset të caktojë takimet me telefon. Një grup i vogël mund ta vizitojë institucionin apo personin dhe ta zhvillojë bisedën. (Të dhënat i shkruajnë në *Pyetësin e dokumentacionit për të dhënat nga letrat apo bisedat*).
- 4. Shkrimi i kërkesës për të dhënat.** Një apo më shumë nxënës mund ta shkruajnë kërkesën për marrjen e të dhënave nga çdo shërbim apo person nga të cilët kërkohet. (Të dhënat i shkruajnë në *Pyetësin e dokumentacionit për të dhënat nga letrat ose bisedat*).

Mbledhja e të dhënave

Bashkë me nxënësit përzgjidhni burimet e të dhënave të cilat do t'i shfrytëzoni. Pastaj ndajeni klasën në grupe hulumtuese dhe secilit ndajini nga një burim. Nxënësit kanë detyrë shtëpiake që të mbledhin të dhëna nga burimet e dakorduara të të dhënave. Në doracakët e tyre kanë udhëzime dhe pyetësorë për mbledhjen dhe dokumentimin e të dhënave, të ashtuquajtur pyetësorë të dokumentacionit. Shikoni ato me nxënësit që të bindeni se i kuptojnë. Mund të kërkoni edhe ndihmë vullnetare të një apo më shumë personave të rritur të cilët do të punojnë me secilin grup hulumtues. Të rriturit lypset t'u ndihmojnë nxënësve e jo të punojnë në vend të tyre (shikojeni Udhëzimin për ndihmësit vullnetarë në faq. 25).

Hapi i katërt

Të menduarit mirë, Punimi dhe zhvillimi i studimit të klasës

Deri më tani klasa lypset të ketë mjaft të dhëna të mbledhura për fillimin e punimit të studimit të klasës.

1. **Ndajeni klasën në grupe studimore.** Ndajeni klasën në katër grupe dhe secilit caktoni punimin e një kaptine të studimit.
2. **Rikujtoni nxënësve detyrat specifike që secili grup i ka me rastin e punimit të studimit.** Tregoni kujdes që nxënësit në secilin grup, të kuptojnë se çfarë pritet nga ata. Udhëhiqni secilin grup hap pas hapi duke lexuar dhe diskutuar mbi detyrat e tij.
3. **Shfrytëzoni të dhënat që i kanë mbledhur grupet studimore.** Të dhënat që i ka mbledhur një grup studimor shpesh mundën dhe duhet t'i shfrytëzojnë edhe tjerët. Në këtë pjesë nganjëherë lindin problemet. Në fakt, pas mbledhjes së të dhënave nxënësit ndahen në katër grupe dhe secili e kryen pjesën e vet të prezantimit. Këto pjesë ndërmjet tyre janë të ndërlidhura dhe varen nga njëri-tjetri, dhe mund të ndodhë që grupi i dytë lypset ta presë grupin e parë që ta kryej pjesën e vet, grupi i tretë të dytin, kurse i katërti grupin e tretë. Në mënyrë që të evitohet që anëtarët e grupeve të tjera të rrinë dhe të presin grupet e mëparshme që ta përfundojnë punën, ja një propozim se si secili grup studimor të arrijë deri tek të dhënat e nevojshme (edhe disa propozime si t'i tejkalojnë këto probleme mund t'i gjeni në *Pjesën në faq. 89*):
 - Secili grup studimor le ta zë vendin pranë katedrës përpara gjithë klasës. Pastaj secili grup duhet t'ia lexojë klasës pyetjet dhe sqarimet nga vëllimi i vet i detyrave për klasën të pjesës demonstruese të studimit (pantartën).
 - Sapo të lexohet secila pyetje, kërkoni nga nxënësit të cilët dëgjojnë se atij grupi po i japin detyra që i kanë mbledhur e që janë të ndërlidhura me atë pyetje. Të dhënat me shkrim apo të shtypura të dobishme për disa grupe duhet të shumëzohen dhe t'i jepen secilit grup.
 - Secili grup studimor lypset të ketë në dispozicion të gjitha të dhënat në mënyrë që t'i kryejë detyrat e veta.
- 4 **Punimi i studimit.** Jepni secilit grup ta punojë pjesën e vet të studimit të klasës. Është e mundshme që ndonjë grup të mos i ketë të gjitha të dhënat të nevojshme për përgjigje në pyetjet nga udhëzimi. Nëse kjo ndodh, mësuesdhënësit, nxënësit e tjerë dhe ndihmësit vullnetarë duhet ta ndihmojnë atë grup që të vijë deri tek të dhëna më të shumta..

Detyrat e grupeve studimore

Secili grup studimor duhet që, nga materialet e mbledhura, t'i zgjedhë ato të cilat do t'i ndihmojnë për t'i përmbushur detyrat që pasojnë.

Grupi i parë studimor: Sqarimi i problemit. Ky grup është përgjegjës për sqarimin e problemit të cilin klasa e ka zgjedhur. Ky grup gjithashtu lypset të sqarojë përse problemi është i rëndësishëm dhe përse shërbimet e caktuara duhet të merren me atë.

Grupi i dytë studimor: Vlerësimi i masave të ndryshme të propozuara për zgjidhjen e problemit. Ky grup është përgjegjës për sqarimin e masave të ndryshme të tashme apo të ardhshme me të cilat merren me problemin e zgjedhur.

Grupi i tretë studimor: Zhvillimi i masave që do t'i propozojë klasa. Ky grup është përgjegjës për zhvillimin dhe arsyetimin e masave, propozimin e të cilave e ka miratuar shumica e nxënësve në klasë..

Grupi i katërt studimor: Zhvillimi i planit të veprimit për nxitjen e autoriteteve që t'i përqafojnë masat që i propozon klasa. Ky grup është përgjegjës për zhvillimin e planit të veprimit i cili do të tregojë se si qytetarët mund të ndikojnë në autoritetet për t'i përqaftuar masat të cilat i ka propozuar klasa.

Kutet për punimin e studimit

Kutet për punimin e studimit (Shtojca faq. 39) do tu ndihmojë nxënësve që ta punojnë një studim sa më të mirë. Le t'i shfrytëzojnë si ciceron gjatë punës. Është e nevojshme të vlerësojnë secilën kaptinë dhe efektin e përgjithshëm të studimit të vet. Nxënësit duhet të jenë të kujdesshëm me rastin e zgjedhjes së të dhënave të cilat i prezantojnë. Të dhënat lypset të jenë të peshuara mirë dhe të ndërlidhura. Studimi duhet të tregojë zgjidhje kreative dhe personale. Në qoftë se studimi garon me studimet e klasave të tjera, juria do t'i vlerësojë duke shfrytëzuar kutet për punimin e studimit. Do ta vlerësojë çdo kaptinë të studimit dhe tërë studimin.

Udhëzime për grupet studimore

Edhe pse secili grup studimor ka detyra të veçanta (Shtojca faq. 41–49), është me rëndësi që grupet t'i ndajnë idetë dhe të dhënat. Secili grup lypset ta njoftojë të gjithë klasën mbi përparimin dhe të bashkëpunojë me grupet e tjera në mënyrë që klasa ta punojë studimin sa më të mirë. Grupet duhet të bashkëpunojnë kur të vendosin se cilat pyetje specifike lypset të përfshihen në pjesën demonstruese dhe dokumentare të studimit. Ky bashkëpunim shërben për tu shmangur përsëritja e të dhënave dhe që studimi të përmbajë vetëm të dhënat më të rëndësishme.

Vërejtja mbi studimin e klasës

Studimi është punë shkencore ose profesionale i cili e elaboron ndonjë problem. Në rastin e Edukatës qytetare VI, **studimin e klasës** e përbejnë punimet e nxënësve të përzgjedhur sipas kuteve dhe udhëzimeve të veçanta. Secili studim i klasës përmban zgjedhjen përfshirëse nga puna ekipore e nxënësve, të cilët u propozojnë bashkë masa autoriteteve (masat politike destinuar për zgjidhjen e ndonjë problemi të bashkësisë. As pjesa demonstruese as dokumentare e studimit nuk duhet të përmbajnë krejt atë që mund të sigurojnë nxënësit lidhur me temën e vet. Studimi i klasës më parë duhet të përmbajë materialet më të mira të cilat grupet e caktuara i kanë siguruar gjatë zgjedhjes së detyrave të shtruara, si dhe materialet që janë më të rëndësishme ndaj vlerësimit të harmonizuar të nxënësve.

Forma dhe struktura e studimit të klasës

Puna e katër grupeve studimore është prezantuar me studimin e klasës. Ajo ka dy pjesë: demonstrues (pankarta) dhe dokumentar.

Pjesa demonstruese (pankarta). Pjesa demonstruese duhet të përbëhet nga katër kaptina (pjesë) me dimensione jo më të mëdha se 100x82 cm. Puna e secilit grup studiuës ekspozohet në një kaptinë (pjesë) të pankartës.

Materialet e ekspozuara mund të jenë tekstet, regjistrat e burimeve, hartat, grafikonët, figurat, vizatimet, punëdoret e nxënësve, pjesët e prera nga gazetatat. Secila pjesë e pankartës duhet të përmbajë :

- paraqitjen me shkrim apo përmbledhjen e detyrës së grupit studimor
- paraqitjen figurative të punës së grupit studimor
- emërimin e burimit të të dhënave

Pjesa dokumentare. Secila nga katër grupet studimore lypset që nga materiali i mbledhur t'i përzgjedh ato të cilët më së miri dokumentojnë ose argumentojnë hulumtimin e tyre. Ato materiale lypset të vendosen në regjistrator të zyrës jo më të trashë se 5 cm. Midis materialeve që u takojnë pjesëve të ndryshme duhen futur ndërmjet letra me ngjyra apo kartonë të cilët do t'i ndajnë. Në fillim lypset të qëndrojnë përmbajtja e pjesës dokumentuese të studimit, kurse në fillim të pjesëve (kaptinave) përmbajtjet e tyre. Kreu i pestë i pjesës dokumentuese lypset të përmbajë materiale të propozuara në kaptinën Hapi i gjashtë: Vështrimi i të mësuarit nga *Doracaku për nxënës*. Dhe ai duhet të veçohet me letër të ngjyrosur ose me kartonë.

Vërejtje: Këto forma dhe struktura të tilla të studimit të klasës vlejné për gara. Nëse nuk keni ndërmend të garoni mund të punoni udhëzimet tuaja.

Hapi i pestë

Prezantimi i studimit të klasës

Rekomandojmë që çdo klasë ta prezantojë gojarisht studimin e klasës përpara klasës apo grupit tjetër, si tregues të realizimit të suksesshëm të projektit.

Prezantimi gojor i studimit të klasës ka formën e ekspozimit publik, ku të katër grupet studimore i paraqesin para jurisë pjesët e veta të studimit të klasës, dhe japin përgjigje në pyetje. Kjo u jep mundësi nxënësve ta mësojnë edhe një mënyrë të pjesëmarrjes në pushtet dhe për ndikim në të. Do të mësohen me paraqitje publike dhe si t'i mbrojnë me argumente qëndrimet, që është shumë qenësore për zhvillimin e tyre të mëtejshëm. Prezantimi gojor publik është vetëm një mënyrë e prezantimit të projektit (diç më shumë mbi projektet dhe mënyrat e prezantimit të tyre mund të lexoni në pjesën në faq. 92).

Në qoftë se klasa vendos të garojë, prezantimin i tyre gojor do ta vlerësojë juria.

Paraqitni si vijon:

- Secili grup studimor ka katër minuta për hyrje gjatë së cilës prezanton gojarisht të dhënat më të rëndësishme nga pjesa e vet e studimit.
 1. Hyrja duhet të mbështetet në pjesën demonstruese dhe dokumentare të studimit, pra nuk duhet të jetë lexim formal nga pankarta.
 2. Nxënësit mund të shfrytëzojnë paraqitje me figura nga studimi me rastin e sqarimit apo theksimit të pohimit.
 3. Vetëm materialet që janë pjesë përbërëse e studimit mund të shfrytëzohen gjatë prezantimit gojor. Nxënësit nuk guxojnë të shtojnë materiale të reja si video-shirita, filma, prezantime kompjuterike etj.
- Gjashtë minutat vijuese, pas ekspozimit të grupit studimor, i takojnë jurisë të cilat i shfrytëzon për të shtruar pyetje. Ata mund t'i pyesin që:
 1. të sqarojnë në hollësi pohimet e veta;
 2. të japin shembuj;
 3. të mbrojnë disa qëndrime;
 4. t'u përgjigjen pyetjeve mbi atë se çfarë kanë kuptuar e mësuar gjatë punimit të studimit. Cilat probleme i kanë pasur dhe çfarë përvoja kanë fituar.

Në qoftë se i shfrytëzojnë katër minutat e vet për ekspozim, koha e pashfrytëzuar do të shtohet për pyetje e përgjigje. Secili grup studimor ka gjithsej dhjetë minuta përpara jurisë.

Gjatë prezantimit nxënësit mund të shfrytëzojnë vetëm materialet nga pjesa e studimit të cilin e ka punuar grupi i tyre studimor.

Prezantimi i studimit të klasës është vend kyç për vlerësimin e suksesit të projektit. Në mënyrë që nxënësit t'i përgatisni sa më mirë për prezantim, mund t'i shfrytëzoni Kutet për përgatitjet e prezantimit gojor (Shtojca faqe 50) dhe Pyetëtori për vlerësimin e studimit (Shtojca faqe 56–60). Në pjesën e Doracakut në faqen 91 keni këshilla të dobishme lidhur me përgatitjen e prezantimit gojor.

Juria mund ta shfrytëzojë Shtojcën V: *Udhëzime për anëtarët e jurisë* (Shtojca – faqe 53).

Hapi i gjashtë

Vështrimi i të mësuarit

Kur klasa e përfundon punimin e studimit, pjesën mbi vështrimin ose vlerësimin duhet shtuar kaptinë dokumentare. Kjo kaptinë duhet të përmbajë përgjigjet e nxënësve në pyetje të tilla si:

- Ç' keni mësuar ti, shokët dhe shoqet tua të shkollës?
- Si e keni mësuar këtë?
- Çfarë do të bëni ndryshe, sikur të punoni sërish ndonjë studim tjetër?

Vështrimi i të mësuarës duhet të jetë rezultat e përpjekjes së përbashkët të tërë klasës, ngjashëm me punën e përbashkët gjatë punimit të studimit. Nxënësve iu duhet kërkuar të të shënojnë përshtypjet e tyre mbi punën individuale dhe të përbashkët. Për klasën mund të jetë ndihmesë që studimi të prezantohet publikisht para se ta përfundojë punën në kaptinë e fundit. Pyetjet dhe reagimet e dëgjuesve mund tu ndihmojnë nxënësve të mendojnë mbi përvojën që kanë fituar gjatë punimit të studimit.

Mund t'i shfrytëzoni këto propozime që nxënësve t'u ndihmoni në punimin kësaj kaptine:

1. Nxënësit mund ta plotësojnë Pyetësoarin për vlerësimin e nxënësve (Shtojca – faqe. 62) dhe të përgjigjen në këto pyetje:
 - Çfarë kam mësuar unë personalisht në punë me shoqet dhe shokët i mi mbi masat (politike) dhe zgjidhjet?
 - Cilat shkathtësi i kam fituar apo përmirësuar duke punuar studimin?
 - Cilat janë përparësitë e punës ekipore?
 - Cilat janë mangësitë e punës ekipore?
 - Çfarë kam mësuar mirë unë si pjesë e ekipit?
 - Me çfarë i kam kontribuar unë suksesit të punimit të projektit?
 - Çfarë kemi bërë të mirë ne si ekip?
 - Si mund t'i përmirësojë aftësitë e mia për zgjedhjen e problemit?
 - Çfarë do të bënim ndryshe sikur të punonim studimin e klasës tjetër mbi ndonjë problem tjetër të bashkësisë?
2. Zhvilloni biseda në klasë mbi përgjigjet e nxënësve. Mundohuni të arrini deri tek përgjithësimi. Shkruani ato në tabelë.
3. Ndajeni klasën në grupe dhe secilit ndaji një përgjithësim. Secili grup duhet të punojë një tekst të shkurtër dhe ta argumentojë.

Ky hap mund të shfrytëzohet edhe për të fituar një pasqyrë për atë çfarë kanë mësuar nxënësit gjatë punës në projekt (teksti mbi përcjelljen dhe vlerësimin e nxënësve e keni në Kaptinë në faqe 92). Ato përgjigje mund t'i shfrytëzoni edhe si bazë për planifikimin e mësimin për vitin tjetër shkollor.

Shtojcat

- I Kutet për punimin e studimit**
- II Udhëzimet për grupet studimore**
- III Kutet për përgatitjen e prezantimeve gojore**
- IV Procedimet dhe udhëzimet për mbajtjen e garave**
- V Udhëzimet për anëtarët e jurisë**
- VI Pyetësi për vlerësimin e studimit dhe të prezantimit gojor**
- VII Pyetësi për vlerësimin e mësimdhënësve**
- VIII Pyetësi për vlerësimin e nxënësve**
- IX Pyetësorët e nxënësve**

I. KUTET PËR PUNIMIN E STUDIMIT

Kutet për *secilën kaptinë të studimit*:

Plotësia

A përmban çdo kaptinë materiale të përshkruara në Udhëzimet për grupet studimore?

A keni futur më shumë sesa ju duhet?

Opinion

A është organizuar mirë studimi?

A është shkruar qartë dhe saktë studimi?

A janë të kuptueshme lehtë pikat kryesore dhe sqarimet e tyre?

Të dhënat

A janë të sakta të dhënat?

A i përfshijnë të dhënat faktet më të rëndësishme?

A janë të dhënat që i keni futur të rëndësishme për ta kuptuar temën?

Arsyetimi

A keni dhënë shembuj të cilat e sqarojnë ose konfirmojnë pohimet tuaja kryesore?

A keni sqarime domethënëse të pikave kryesore?

Paraqitja figurative

A kanë të bëjnë paraqitjet figurative me përmbajtjen e kaptinës tuaj?

A japin të dhëna paraqitjet figurative? A ka secili nga ato titull apo sqarim?

A e ndihmojnë kuptimin e kaptinës demonstruese?

Dokumentacioni

A i keni dokumentar kapitujt kryesor të kaptinës tuaj të studimit?

A i keni shfrytëzuar burimet e sigurta, të besueshme e të ndryshme?

Nëse i keni cekur apo ritreguar pohimet e huaja, ai keni cekur këto çdo kund qartë?

A ka të bëjë qartë pjesa dokumentare me atë demonstruese?

A i keni përzgjedhur vetëm burimet më të mira e më të rëndësishme të të dhënave?

Kushtetutshmëria

A e keni shqyrtuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e masave të propozuara?

A keni sqaruar përse masat politike që i propozoni nuk e shkelin Kushtetutën?

Kutet për tërë studimin:

Bindja

A tregon qartë studimi se problemi i zgjedhur është i rëndësishëm?

A kanë të bëjnë direkt me problemin masat e propozuara?

A e sqaron studimi si mund ta fitoni mbështetjen e përgjithshme të masave të propozuara ?

Realizimi

A janë masat e propozuara vërtetë të realizueshme?

A është i realizueshëm plani për fitimin e mbështetjes ndaj masave të propozuara?

Harmonizimi

A janë kaptinat e studimit të harmonizuara mes-veti?

A përmbajnë përsëritje?

A i përmban pjesa dokumentuese të dhënat e treguara në pjesën demonstruese?

Vështrimi

A tregon pjesa ku vështroni punimin e studimit se keni menduar me kujdes mbi përvojën e fituar?

A tregon se çfarë keni mësuar gjatë punës në studim?

II. UDHËZIME PËR GRUPET STUDIMORE

GRUPI I PARË STUDIMOR

Sqarimi i problemit

Grupi juaj studimor është përgjegjës për sqarimin e problemit në kaptinën e parë të treguar në pjesën dokumentuese të studimit të klasës.

I. Pjesa demonstruese e studimit: Kaptina a parë

Kjo kaptinë duhet të përmbajë si vijon:

1. **Përmbledhjen me shkrim të problemit.** Shikoni materialet që i kanë mbledhur ekipet hulumtuese. Shkruani sqarimin e problemit më së shumti në dy faqe të shtypura me radhor të dyfishtë. Aty përmbliidhni ngjeshur atë që keni mësuar duke marrë parasysh këto pyetje:
 - a. Sa serioz është ai problem i bashkësisë suaj?
 - b. Sa i përhapur është ai problem në mbarë vendin?
 - c. Përse lypset të merren autoritetet me atë problem?
 - d. Çfarë e konsideroni të qartë nga kjo që pason?
 - Nuk ka dispozita apo masa që merren me atë problem.
 - Dispozitat lidhur me këtë problem nuk janë adekuate.
 - Dispozitat lidhur me problemin janë adekuate por nuk zbatohen mirë.
 - e. Cilat janë mospajtimet, nëse ka, në bashkësinë tuaj lidhur me atë problem?
 - ë. Kush janë individët, grupet ose organizatat kryesore të cilat marrin qëndrim mbi këtë problem?
 - Për çfarë janë të interesuar?
 - Cilat qëndrime i marrin?
 - Çfarë janë përparësitë dhe mangësitë e qëndrimeve të tyre?
 - Si përpiqen t'i nxisin autoritetet që t'i përqafojnë pikëpamjet e tyre?
 - f. Cilat janë nivelet e pushtetit apo të shërbimit përgjegjës për marrjen me këto probleme?
2. **Prezantimi figurative i problemit.** Në prezantimin e problemit mund të shërbehëni edhe me grafikun, figura, karikatura, me tekste të gazetave, tabela statistikore dhe ilustrime tjera. Ilustrimet mund t'i merrni prej ndonjërit nga burimet ose t'i bëni vetë. Secili ilustrim lypset të ketë titullin apo sqarimin.
3. **Emërtimi i burimit të të dhënave.** Në një apo më shumë fletë të shtypura, emërtoni burimet e të dhënave që i ka shfrytëzuar klasa.

II. Pjesa dokumentare e studimit: Kaptina e parë

Në kaptinën e parë të pjesë dokumentare të studimit të klasës, futni të dhënat më të mira e më të rëndësishme të cilat i ka mbledhur klasa juaj dhe i ka shfrytëzuar në studimin dhe vlerësimin e masave ekzistuese e të mundshme. Për shembull, mund t'i fusni të përzgjedhurat:

- pjesë të prera nga gazetatat;
- raportet e shkruara apo bisedat me njerëzit në bashkësi;
- raportet e shkruara mbi përcjelljen e problemit të zgjedhur në radio dhe televizion;
- ekstrakte nga letërkëmbimi me grupet e interesit;
- ekstrakte nga publikimet të cilat i kanë botuar organet e pushtetit.

Dokumentet dhe raportet më të gjata duhet të prezantohen me kopjet e faqeve të para edhe të përmbajtjeve edhe të përmbledhjeve – qofshin të jenë marrë nga vetë dokumenti apo i keni përpiluar vet. Mos harroni ta përgatisni përmbajtjen e kësaj kaptine.

GRUPI I DYTË STUDIMOR

Vlerësimi i masave të ndryshme për zgjidhjen e problemit

Grupi juaj studiues është përgjegjëse për sqarim të qartë dhe vlerësimin e masave të ndryshme të tashme e të mundshme të parashikuara për zgjidhjen e problemit të cilin e keni përzgjedhur. Analizat tuaja do të prezantohen në kaptinën e dytë të pjesës demonstruese e dokumentuese të studimit të klasës.

I. Pjesa demonstruese e studimit: Kaptina e dytë

Kjo kaptinë duhet të përmbajë me sa vijon:

- 1. Përmbledhjen të masave të ndryshme.** Përcaktohuni për dy deri në tri masa, apo paketë të masave të cilat i propozojnë individë apo grupe të ndryshme. (Mund t'i inkuadroni edhe masat ekzistuese.) Për secilën masë apo paketë të masave jepni përmbledhjen *në më së shumti dy faqe të shtypura të radhorit të dyfishtë*, i cili përmban më shumë përgjigje në dy pyetje:
 - a. Cilat masa i propozojnë individët apo grupet e përzgjedhura?
 - b. Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e atyre masave?
- 2. Paraqitja figurative e masave të ndryshme.** Në prezantimin e masave mund të shërbeheni edhe me grafikone, figura, karikatura, tituj të gazetave, tabelat statistikore dhe me ilustrime të tjera. Ilustrimet mund t'i rimerrni prej ndonjërit nga burimet ose t'i punoni vetë. Secili ilustrim lypset të ketë titullin apo sqarimin.
- 3. Emërtimi i burimeve të të dhënave.** Në një apo më shumë faqe të shtypura emërtoni burimet e të dhënave të cilat i ka shfrytëzuar klasa.

II. Pjesa dokumentare e studimit: Kaptina e dytë

Në kaptinën e dytë të pjesës dokumentare të studimit të klasës, fusni të dhënat më të mira e më të rëndësishme të cilat klasa juaj i ka mbledhur dhe shfrytëzuar në studimin dhe vlerësimin e masave ekzistuese e të mundshme. Për shembull, mund t'i fusni të përzgjedhurat:

- pjesë të prera nga shtypi;
- raporte të shkruara apo biseda me njerëzit në bashkësi;
- raporte të shkruara mbi përcjelljen e problemit të zgjedhur në radio dhe televizion;
- ekstrakt nga letërkëmbimi me grupet e interesit;
- ekstrakt nga publikimet të cilat i kanë botuar organet e pushtetit.

Dokumentet dhe raportet më të gjata duhen prezantuar me kopjet e faqeve të para dhe përmbajtjeve e përmbledhjeve të ngjeshura – qofshin të marra nga vetë dokumenti ose që i keni përpiluar vetë. Mos harroni të përgatisni përmbajtjen e kësaj kaptine.

GRUPI I TRETË STUDIMOR

Propozimi masave për zgjidhjen e problemit

Grupi juaj studimor është përgjegjës për propozimin e masave për problemin e përzgjedhur. Masat për të cilat merr vendimin grupi juaj lypset t'i përqafojë shumica e nxënësve në klasë. Gjithashtu ato duhet të jenë në harmoni me Kushtetutën dhe ligjet. Shfrytëzoni pyetësin Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e masave të propozuara nga dy faqet vijuese në mënyrë që edhe ju dhe gjithë klasa të bindeni se masat që i propozoni nuk e cenojnë Kushtetutën dhe ligjin. Kur të merrni vendimin mbi këto klasa ka tri mundësi:

- ta mbështesë një masë të cilën e ka emërtuar grupi dytë studiues;
- që deri diku ta ndryshojë atë masë ose
- të propozojë dhe punojë masat e veta.

I. Pjesa demonstruese e studimit: Kaptina e tretë

Kjo kaptinë duhet të përmbajë me sa vijon:

- 1. Sqarimi dhe arsyetimi i masave që i propozoni.** Duhet t'i sqaroni masat që i propozon klasa juaj dhe t'i jepni arsyet për këtë. *Në më së shumti dy faqe të shtypura me radhor të dyfishtë* sqaroni:
 - a. Masat që i propozon klasa juaj do të ndikojnë më me efektivitet në zgjidhjen e problemit.
 - b. Përparësitë dhe mangësitë e tyre.
 - c. Përse, sipas mendimit të nxënësve të klasës tuaj, masat që i propozoni nuk e cenojnë Kushtetutën dhe ligjin. Shfrytëzoni pyetësin Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e masave të propozuara nga dy faqet vijuese, në mënyrë që të përgjigjeni në këtë pyetje. Plotësojeni dhe futeni në pjesën dokumentuese të studimit të klasës. Grupi juaj studimor lypset të shqyrtojë:
 - cili organ dhe nivel i pushtetit është përgjegjës për zbatimin e masave që i propozoni dhe për çfarë.
- 2. Paraqitja figurative e masave të ndryshme.** Në prezantimin e masave mund të shërbehëni edhe me grafikone, figura, karikatura, tituj të gazetave, tabela statistikore dhe me ilustrime tjera. Ilustrimet mund ti rimerrni prej ndonjërit nga burimet ose ti punoni vet. Secili ilustrim lypset të ketë titullin ose sqarimin.
- 3. Emërtimi i burimeve të të dhënave.** Në një apo më shumë faqe të shtypura emërtoni burimet e të dhënave të cilat i ka shfrytëzuar klasa.

II. Pjesa dokumentare e studimit: Kaptina e tretë

Në kaptinën e tretë të pjesës dokumentare të studimit të klasës futni të dhënat më të mira e më të rëndësishme të cilat i ka mbledhur dhe i ka shfrytëzuar klasa juaj në studimin dhe vlerësimin e masave. Për shembull mund t'i fusni të përzgjedhurat:

- pjesë të prera nga shtypi;
- raporte të shkruara ose biseda me njerëzit në bashkësi;
- raporte të shkruara mbi përcjelljen e problemit të zgjedhur në radio dhe televizion;
- ekstrakte nga letërkëmbimi me grupet e interesit;
- ekstrakte nga publikimet të cilat i kanë botuar organet e pushtetit.

Dokumentet dhe raportet më të gjata lypset të prezantohen me kopjen e faqeve të para e të përmbajtjes dhe me përmbledhje të ngjeshura – qofshin të marra nga vetë dokumentet ose t'i keni hartuar vetë. Mos harroni të përgatisni përmbajtjen e kësaj kaptine.

Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e masave të propozuara

Që t'i mbrojtë të drejtat e qytetarëve Kushtetuta e kufizon pushtetin.

Sa here që propozojmë miratimin e ndonjë mase apo dispozite për marrjen me ndonjë problem, është me rëndësi që të mos kërkojmë asgjë kundër-kushtetuese. Secili qytetar ka të drejtë dhe lypset të marrë përgjegjësi si dhe të ketë kujdes që masat e dispozitat e tashme e të propozuara ndoshta nuk i cenojnë kufizimet kushtetuese të pushtetit.

Ky pyetësor përmban disa nga kufizimet më të rëndësishme të cilat i imponon Kushtetuta me qëllim të mbrojtjes së të drejtave tona. Shfrytëzoni derisa punoni në masat të cilat do t'i propozoni. Duhet të jeni të sigurt se masat e propozuara nuk e cenojnë Kushtetutën. Këtë pyetësor lypset ta shqyrtojë e gjithë klasa. Epilogu i këtij shqyrtimi duhet të futet në kaptinën e tretë të pjesës demonstruese e dokumentare të studimit.

1. Autoriteteve nuk u lejohej të përzihen në lirinë personale dhe bindjet e qytetarëve.

Masat që i propozoni e cenojnë/se cenojnë këtë kufizim të pushtetit. Sqarojeni përse.

2. Autoriteteve nuk u lejohej të vendosin kufizime të pakuptueshme dhe të padrejta në lirinë e shprehjes me gojë, me shkrim apo të ndonjë shprehje tjetër.

Masat që i propozoni e cenojnë/se cenojnë këtë kufizim të pushtetit. Sqaroni përse?

3. Autoriteteve nuk u është e lejuar që qytetarëve t’ua marrin jetën, lirinë apo pasurinë pa gjykim të drejtë para gjykatave.

Masat që i propozoni e cenojnë/ se cenojnë këtë kufizim të pushtetit. Sqaroni përse?

4. Autoriteteve e nuk u është e lejuar që ta prishin privatësinë e shtëpisë së qytetarit pa shkak dhe të arsyetuar.

Masat që i propozoni e cenojnë/se cenojnë këtë kufizim të pushtetit. Sqaroni përse?

5. Autoriteteve nuk u është e lejuar të hartojnë dispozita të cilat i diskriminojnë njerëzit sipas nacionalitetit, besimit fetar, gjuhës amtare, racës, gjinisë apo moshës në mënyrë të paarsyeshme dhe të palejueshme

Masat që i propozoni e cenojnë/ se cenojnë këtë kufizim të pushtetit. Sqaroni përse?

Përmbledhja

Shkruani përmbledhjen ku do të sqaroni dhe konfirmoni se masat dhe zgjidhjet që i ka propozuar klasa juaj, nuk e cenojnë Kushtetutën.

GRUPI I KATËRT STUDIUES

Punimi i planit të veprimit

Grupi juaj është përgjegjës për punimin e planit të veprimit. Plani lypset t'i përmbajë hapat që do të mund t'i merrni në mënyrë që autoritetet t'i përqafojnë dhe zbatojnë masat të cilat i propozoni. Gjithë klasa duhet të kyçet në punimin e planit por grupi juaj do ta sqarojë në kaptinë e katërt të pjesës demonstruese dhe dokumentare të studimit të klasës.

I. Pjesa demonstruese e studimit: Kaptina e katërt

Kjo kaptinë duhet të përmbajë si vijon:

- 1. Sqarimin se si klasa juaj mund të fitojë mbështetjen e individëve apo grupeve në bashkësi. për masat që propozon.** Në një faqe të shtypur me radhorë të dyfishtë, sqaroni pikat kryesore të planit tuaj.
 - a. Emërtoni individët dhe grupet me ndikim në bashkësinë tuaj të cilët do të kishin vullnet t'i mbështesin masat që i propozon klasa juaj. Përshkruani shkurt si do t'i nxisni ta bëjnë këtë.
 - b. Emërtoni grupet në bashkësinë tuaj të cilat do të mund t'i kundërshtonin masat tuaja. Përshkruani shkurt si do të mund t'i bindni për t'i mbështetur masat tuaja.
- 2. Sqarim se si klasa juaj do të mund ta fitojë mbështetjen e pushtetit për masat që i propozon.** Në një faqe të shtypur me radhorë të dyfishtë sqaroni pikat kryesore të planit tuaj.
 - a. Emërtoni zyrtarët dhe organet me ndikim të pushtetit në bashkësinë tuaj të cilët mund të kenë vullnet t'i mbështesin masat që i propozon klasa juaj. Përshkruani shkurt si do t'i nxisni ta bëjnë këtë.
 - b. Emërtoni zyrtarët në pushtet të cilët do të mund t'i kundërshtonin masat tuaja. Përshkruani shkurt si do të mund t'i bindni që t'i mbështesin ato.
- 3. Paraqitja figurative e planit të veprimit.** Në prezantimin e planit të veprimit mund të shërbehëni edhe me grafikone, figura, karikatura, tituj të gazetave, tabela statistikore dhe me ilustrime të tjera. Ilustrimet mund t'i merrni prej ndonjërit nga burimet apo t'i punoni vetë. Secili ilustrim lypset të ketë titullin dhe sqarimin.
- 4. Emërtimi i burimit të të dhënave.** Në një apo më shumë fletë të shtypura emërtoni burimet që i ka shfrytëzuar klasa juaj.

II. Pjesa dokumentare e studimit: Kaptina e katërt

Në kaptinën e katërt të pjesës dokumentare të studimit të klasës fusni të dhënat më të mira e më të rëndësishme të cilat klasa juaj i ka mbledhur dhe shfrytëzuar në studimin dhe vlerësimin se cilët janë ata individ dhe grupe nga bashkësia dhe pushteti të cilët mund t'i mbështesin apo t'i kundërshtojnë masat të cilat i propozoni. Për shembull, mund t'i fusni të përzgjedhurat:

- pjesë të prera nga shtypi;
- raporte të shkruara ose biseda me njerëzit në bashkësi;
- raporte të shkruara mbi përcjelljen e problemit të zgjedhur në radio e televizion;
- ekstrakte nga letërkëmbimi me grupet e interesit;
- ekstrakte nga publikimet të cilat i kanë botuar organet e pushtetit.

Dokumentet dhe raportet më të gjata duhet t'i prezantoni me kopje të faqeve e përmbajtjeve dhe përmbledhjeve – qofshin të marra nga vetë dokumenti, apo t'i keni punuar vetë. Mos harroni ta përgatisni përmbajtjen e kësaj kaptine.

III. KUTET PËR PËRGATITJEN E PREZANTIMIT GOJOR

Kutet pasuese mund të shfrytëzohen në përgatitjen e prezantimit gojor të studimit të klasës.

Kutet për përgatitjen e prezantimit gojor të *disa* grupeve

1. **Qenësia.** Nxënësit duhet t'i veçojnë të dhënat më të qenësishme të pjesës së studimit të cilin e prezantojnë.
2. **Kuptimi.** Nxënësit duhet ta kuptojnë natyrën dhe vëllimin e problemit, masat e ndryshme (zgjidhjet) që i kanë shqyrtuar, masat e veta (zgjidhjet) dhe planin e veprimit.
3. **Arsyetimi.** Grupi lypset që në mënyrë adekuate t'i prezantojë pikëpamjet e veta. Nxënësit lypset t'i mbrojnë mirë ato gjatë përgjigjeve në pyetjet e shtruara.
4. **Përgjigjet.** Përgjigjet e nxënësve duhet të bëjnë me pyetjet e shtruara.
5. **Bashkëpunimi i grupeve dhe bashkëpunimi brenda grupeve.** Shumica e nxënësve lypset të marrin pjesë në prezantim. Ndarja e punës duhet të jetë e evidente. Nxënësit lypset të tregojnë respektimin e mendimit të tjerëve.

Kutet për përgatitjen e prezantimit të *tërësishëm* gojor

1. **Bindja.** Prezantimi si tërësi duhet të jetë bindës.
2. **Praktika.** Masat e propozuara (zgjidhjet) dhe qasja e fitimit të mbështetjet duhet të jenë të realizueshme. Duhet të merren parasysh pengesat që ekzistojnë në realitet.
3. **Ndërlidhja.** Raportet midis prezantimit të katër grupeve studimore duhet të jenë të qarta. Secili prezantim ka të bëjë me të mëparshmin.
4. **Vështrimi.** Prezantimi i nxënësve lypset të tregojë se si ata me kujdes e kanë provuar përvojën e fituar dhe çfarë janë njoftuar e kanë mësuar gjatë punimit të studimit.

IV. PROCEDIMET DHE UDHËZIMET PËR MBAJTJEN E GARAVE

Për përfundimin e studimeve të klasave gjykohet pa prezencën e nxënësve. Mirëpo, klasa mund ta prezantojë studimit gojarisht dhe t'u përgjigjet pyetjeve të anëtarëve të jurisë.

1. **Studimi i klasës.** Studimi i klasës përbëhet prej dy pjesëve – demonstruese dhe dokumentare.

- **Pjesa dokumentuese** përbëhet nga:
 - Pankarta katërpjesëshe. Secila prej katër grupeve studimore e paraqet punimin në një pjesë të pankartës.
 - Dimensionet e pjesëve (kaptinave) të pankartës nuk duhet të jenë më të mëdha se 100×82 cm. Secila pjesë e pankartës lypset të përmbajë:
 - a) përmbledhjen e detyrës së grupit studiues;
 - b) paraqitjen figurative të punës së grupit studiues;
 - c) emërtimin e burimeve të të dhënave.
- **Pjesa dokumentare** përbëhet prej:
 - pesë kaptinave të vendosura në një regjistrator të zyrës, jo më të trash se 5 cm, kaptinat janë të ndara me letër ose me karton me ngjyra;
 - përmbajtja e tërë pjesës dokumentare të studimit të klasës dhe të përmbajtjeve të veçanta të kaptinave të tij;
 - kopja e të dhënave më të rëndësishme që e ka mbledhur secili grup studiues për kaptinën e vet, që më së miri dokumenton ose argumenton hulumtimin e tyre;
 - kaptinën e pestë e cila përmban vështrimin dhe vlerësimin e klasës mbi punën e vet.

2. **Prezantimi gojor.** Prezantimi me gojë nxënësve u ofron përvojë të çmueshme në paraqitjen e qëndrimeve dhe ideve. Në kapitullin *Hapi i pestë: Prezantimi i studimit të klasës* sqarohet procedimi.

Duhet shfaqur kujdes mbi kalimin e kohës dhe të caktohet personi jashtë jurisë i cili do të kujdeset mbi këtë. Secili grup studimor ka katër minuta për ta prezantuar kapitullin e vet të studimit të klasës dhe gjashtë minuta për t'iu përgjigjur pyetjeve. Anëtarët e jurisë mund ta zgjasin kohën nëse e gjejnë të arsyeshme (për shembull në rast se anëtari i jurisë shtron pyetje ose jep komente).

3. **Zgjedhja e anëtarëve të jurisë.** Të dhënat vijuese mund të jenë të dobishme me rastin e zgjedhjes së anëtarëve të jurisë.

- Për çdo pesë studime zgjidhet juria prej tre anëtarëve.
- Në juri lypset të jenë personat që kanë dije mbi proceset politike, problemet aktuale publike dhe masat politike për zgjidhjen e tyre, si dhe lidhjen me pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset politike.
- Anëtarët e jurisë duhet të jenë anëtar të shquar të bashkësisë: mësimdhënësit e lëndëve shoqërore, profesorët e universitetit, zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar, gazetarët, avokatët, gjyqtarët Ata mund të jenë në punë aktive ose pensionist.

4. **Materialet.** Mësimdhënësit do t'i sigurojnë secilit anëtar të jurisë kopje të këtyre materialeve:
- Doracak për nxënës
 - Kutet për përgatitjen e prezantimeve gojore (Shtojca III)
 - Udhëzime për anëtarët e jurisë (Shtojca V)
 - Pyetësorët për vlerësimin e studimeve (Shtojca VI)
5. **Gjykimi.** Mbani një takim të shkurtër përgatitor me anëtarët e jurisë. Kaloni të gjitha materialet e cekura. Veçmas përmendni veçoritë e moshës dhe nivelin e dijes së nxënësve të cilët do t'i notojnë. Gjithashtu theksoni se është e nevojshme që nxënësit të inkurajohen me pyetjet dhe propozimet për përmirësimin e studimeve dhe të prezantimeve.
- Ruani të gjithë pyetësorët me notat e anëtarëve të jurisë.
- Kur ta verifikoni saktësinë e të dhënave:
- shënjoni dhe mblidhni notat
 - fiton studimi me notën e përgjithshme më të madhe
6. **Pas gjykimit.** Njoftoni të gjithë nxënësit mbi garën e tyre. Nëse është e mundshme organizoni shpalljen solemne dhe ndarjen e shpërblimeve.

V.UDHËZIME PËR ANËTARËT E JURISË

Forma e garave

Gara mund të jetë përfundim i procesit mësimor. Nxënësit kanë vërejtur, mësuar dhe propozuar masat për zgjidhjen e problemeve të rëndësishme në bashkësinë e vet.

Pasi që problemi në bashkësi është vërejtur, klasa ndahet në ekipe hulumtuese për mbledhjen e të dhënave nga bibliotekat dhe mediat, nga profesorët e shkencëtarët, avokatët e gjyqtarët, shoqatat e qytetarëve, institucionet dhe organet e pushtetit. Pas mbledhjes së të dhënave mbi problemin, klasa e ka hartuar studimin e klasës të cilin lypset ta prezantojë gojarisht.

Detyra e anëtarëve të jurisë është të vlerësojnë studimin e klasës dhe ekspozimin gojor sipas kuteve të dhëna për notimin e studimit të klasës.

Pjesa demonstruese dhe dokumentare e studimit

Studimi i klasës

Nxënësit, në bazë të hulumtimit, e kanë hartuar studimin e klasës. Janë ndarë në katër grupe studimore të përgjegjshme për punimin e nga një kaptinë të studimit. Detyrat e grupeve:

1. Sqarimi i problemit të cilin klasa e përzgjedh për ta studiuar – përse problemi është i rëndësishëm dhe përse me të duhet të merren autoritetet.
2. Vlerësimi i masave të ndryshme, të aplikuara ose propozuara, për marrjen me problemin e përzgjedhur.
3. Punimi dhe arsyetimi i masave që i propozon klasa për zgjidhjen e problemit.
4. Punimi i planit të veprimit për nxitjen e pushtetit për t'i përqafuar masat e propozuara.

Studimi ka dy pjesë –demonstrues dhe dokumentar. Secili grup studimor i punon të dy pjesët të kaptinës së vet të studimit. Me rastin e notimit peshë të njëjtë kanë të dy pjesët-jepen nota prej 1 deri 5.

Pjesa demonstruese (pankarta)

Pjesa demonstruese e studimit të klasës duhet të përbëhet nga katër kaptina të barabarta (të cilët nuk duhet t'i kalojnë dimensionet 100×82 cm). Puna e secilit grup vendoset në një kaptinë.

Pjesa dokumentare

Kjo pjesë përmban materialin e mbledhur i cili më së miri e dokumenton hulumtimin e zbatuar. Materiali i të katër grupeve vendoset në regjistratorët e zyrës jo më të trashë se 5 cm. Kapitulli i pestë përmban vështrimin e nxënësve në punën e tyre dhe përvojën e fituar. Për punimin e këtij kapitulli është e ngarkuar tërë klasa.

Përshkrimin e hollësishëm të kapitullit të secilit grup studimor shikoni në faqet 41–49, të *Doracakut për mësimdhënës.*

Kutet për vlerësimin e studimit të klasës

Çdo kapitull i studimit

Me rastin e vlerësimit të kapitujve të caktuar të studimit duhet shfaqur kujdes mbi kutet pasuese:

- Tërësia
- Kushtetutshmëria (aplikohet në grupin e tretë studimor me kutin “Tërësia”)
- Opinioni
- Të dhënat
- Arsyetimi
- Paraqitja figurative
- Dokumentacioni

Për tërë studimin

Përshtypja e përgjithshme mbi studimin duhet të mbështetet mbi këto kute:

- Bindja
- Praktika
- Ndërlidhja
- Vështrimi

Me rastin e notimit të secilit kapitulli veç e veç, çdo anëtar i jurisë do t’i notojë katër paragrafët – pjesën demonstruese, pjesën dokumentare, ekspozimin dhe përgjigjet në pyetje. Secili paragraf është i barabartë dhe notohet me notën prej 1 deri 5, ashtu që secili grup studimor mund të ketë më së shumti 20 pikë. Notat e katër grupeve studimore mblidhen dhe përbëjnë notën e përgjithshme të klasës/grupit. Notat e paragrafëve veç e veç mundën pas notimit t’i përshtatën përshtypjes së përgjithshme mbi studimin. Është e mundur të shikohen e adaptohen notat tani më të dhëna pas notimit të të gjitha studimeve. Anëtarët e jurisë mund të konsultohen mes-veti rreth notave, por nuk është e domosdoshme të harmonizohen.

Prezantimi gojor

Qëllimi i prezantimit gojor të studimit të klasës është ë nxënësit të mësojnë prezantimin dhe mbrojtjen e mendimeve të arsyetuara lidhur me ndikimin në marrjen e masave politike. Secila klasë ndahet në katër grupe studimore. Secili grup ka katër minuta që kapitullin e vet të studimit t’ia prezantojë jurisë. Gjatë minuta do tu përgjigjen pyetjeve të anëtarëve të jurisë. Secili grup studimor ka gjithsej dhjetë minuta për prezantim gojor të studimit të klasës.

Hapja e prezantimit gojor

Para prezantimit gojor anëtarët e jurisë duhet t’i kontrollojnë studimet e klasës, të njihen me lëndën e hulumtimit dhe t’i hartojnë pyetjet. Vlefshmërinë e studimit nuk duhet marrë parasysh me rastin e notimit të prezantimit të tij. Para fillimit të prezantimit gojor anëtarët e jurisë lypset ta zgjedhin kryesuesin. Pastaj do ta prezantojnë klasën dhe do t’i thërrasin anëtarët e grupit të parë të dalin dhe të prezantohen vet. Anëtarët e jurisë do të kërkojnë nga grupi që prezantimin e studimit ta fillojë me sqarimin e problemeve të cilat i kanë hulumtuar. Kjo nënkupton fillimin e prezantimit katër minutash të grupit të parë studimor.

Anëtarët e jurisë pastaj do të kërkojnë edhe nga grupi i dytë, tretë e katërt që ta prezantojnë pjesën e vet të studimit.

Nxënësit janë njoftuar me atë se prezantimi katër-minutash duhet të përqendrohet në më qenësoret nga kapitulli i tyre të pjesës demonstruese të studimit, por nuk duhet vetëm të lexojnë se çka shkruan në të. U është propozuar që t'i shfrytëzojnë paraqitjet figurative në pankartë, të shprehin apo theksojnë pikëpamjet e veta. Vet materialët nga pankarta mund të shfrytëzohen gjatë prezantimit, por jo edhe shënime tjera.

Pyetjet përcjellëse

Pasi e kanë dëgjuar prezantimin të cilin e ka përgatitur anëtarët e jurisë shtrojnë pyetje. Pyetjet e përgjigjet zgjasin gjashtë minuta. Kjo u jep mundësi nxënësve ta sqarojnë, shtrijnë dhe mbrojnë qëndrimet e veta. Kjo është detyra më sfiduese e anëtarëve të jurisë. Pyetjet lypset të jenë të shkurta e të qarta. Nxënësit nuk shfrytëzojnë shënime me rastin e përgjigjeve.

Propozimet për shtrimin e pyetjeve:

1. Kërkoni nga nxënësit që t'i sqarojnë në hollësi qëndrimet e cekura me rastin e prezantimit.
2. Kërkoni shembuj.
3. Nxënësit le t'i mbrojnë qëndrimet e veta.
4. Pyetni çfarë kanë mësuar duke punuar në projekt. Cilat probleme i kanë pritur? Çfarë është më e rëndësishme që kanë mësuar gjatë punimit të studimit?
5. Shumicën e pyetjeve shtrojani gjithë grupit.

Kutet për notim

Tek prezantimet gojore anëtarët e jurisë do ta notojnë secilin grup në bazë të qenësisë, kuptimit, arsytimit, përgjigjeve dhe bashkëpunimit midis dhe brenda grupeve. Anëtarët e jurisë do ta notojnë tërë prezantimin e klasës në bazë të bindjes, praktikës, ndërlidhjes dhe vështrimit. Anëtarët e jurisë lypset të shikojnë mirë që notimin ta mbështesin në këto kute, e jo në pajtimin ose mospajtimin personal me qëndrimet e nxënësve. Rrobat dhe shfaqja e nxënësve nuk duhet të ndikojë tek nota. Nga anëtarët e jurisë do të kërkohet që të ketë edhe prezantime. Ekspozimi katër-minutash dhe përgjigja në lidhje me pyetjet kanë peshë të njëjtë (notohet prej 1 deri 5). Anëtarët e jurisë mund të konsultohet mes tyre mbi notat, por nuk është e thënë të harmonizohen.

Informatat kthyes

Me përfundimin e prezantimit të studimit, anëtarët e jurisë iu japin nxënësve komentet e përmbledhura në mënyrë të ngjeshur. Kjo për nxënësit është tepër e çmueshme. Komentet duhet të bëjnë me anët e mira të punës së grupit dhe të përmbajë propozimin për përmirësimin e punës. Për nxënësit kjo është mënyrë e shkëlqyer të mësojnë, t'i shmangin gabimet në të ardhmen dhe ta përmirësojnë aftësinë, që si qytetarë të rritur dhe të barabartë të marrin pjesë në jetën shoqërore e politike.

VI. PYETËSORËT PËR NOTIMIN E STUDIMIT DHE TË PREZANTIMIT GOJOR

Kaptina e pare

Për secilin kut kjo kaptinë e studimit notohet me notën prej 1 deri 5.

STUDIMI I KLASËS	NOTA
<p>PJESA DEMONSTRUESE – PANKARTA</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sa është serioz dhe i shtrirë problemi në bashkësinë tuaj ose në mbarë vendin (është dëftuar rëndësia e problemit)? ▪ Kush duhet të jetë përgjegjës për marrjen me problemin? ▪ Mospajtime, nëse ka, në bashkësi me rastin e problemit? ▪ Individët ose grupet kryesore që marrin qëndrime mbi problemin. 	
<p>PJESA DOKUMENTARE</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përkatëse ▪ E besueshme ▪ E ndërlidhur me pjesën demonstruese ▪ Përmban materiale të përzgjedhura mirë 	
PREZANTIMI GOJOR	NOTA
<p>PARASHTRIMI</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sa serioz dhe i përhapur, në bashkësinë tuaj apo mbarë vendin, është problemi (vlera demonstruese e problemit)? ▪ Kush duhet të ishte përgjegjës për t’u marrë me problemin? ▪ Mospajtimet, nëse ka, në bashkësi lidhur me problemin. ▪ Individët apo grupet kryesore të cilat marrin qëndrime mbi problemin. 	
<p>PËRGJIGJET NË PYETJET</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sa e kanë zgjedhur mirë nxënësit pikëpamjen e tyre gjatë përgjigjeve në pyetjet e shtruara? ▪ Në ç’ masë kanë të bëjnë me pyetjet e shtruara përgjigjet e nxënësve? ▪ Sa e kanë treguar nxënësit kuptimin e natyrës dhe të vëllimit të problemit? 	
NOTA E PËRGJITHSHME	

Kaptina e dytë

Për secilin kut kjo kaptinë e studimit notohet me notën 1-5.

STUDIMI I KLASËS	NOTA
<p>PJESA DEMONSTRUESE – PANKARTA</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sa i përgjigjen masat e tashme, nëse ekzistojnë, zgjidhjes së problemit? ▪ A zbatohen masat? ▪ A ekziston ndonjë masë që e propozojnë individët apo grupet? ▪ Qëndrimet që merren. 	
<p>PJESA DOKUMENTUESE</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përkatëse ▪ E besueshme ▪ E ndërlidhur me pjesën demonstruese ▪ Përmban materiale të zgjedhura mirë 	
PREZANTIMI GOJOR	NOTA
<p>PARASHRTIMI</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sa i përgjigjen masat e tashme, nëse ekzistojnë, zgjidhjes së problemit? ▪ A po zbatohen masat? ▪ A ekziston ndonjë masë të cilat i propozojnë individët apo grupet? ▪ Qëndrimet që merren. 	
<p>PËRGJIGJET NË PYETJE</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sa i kanë zgjedhur mirë nxënësit pikëpamjen e vet gjatë përgjigjeve në pyetjet e shtruara? ▪ Në ç’ masë përgjigjet e nxënësve kanë të bëjnë me pyetjet e shtruara? ▪ Sa e kanë treguar nxënësit kuptimin e natyrës dhe të vëllimit të problemit? 	
NOTA E PËRGJITHSHME	

Kaptina e tretë

Për secilin kut kjo kaptinë e studimit notohet me notën 1–5.

STUDIMI I KLASËS	NOTA
<p>PJESA DEMONSTRUESE – PANKARTA</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kut i sqaruar që e ka përzgjedhur klasa dhe arsyet për këtë. ▪ Përparësitë dhe mangësitë e cekura të atij kuti. ▪ Është sqaruar përse kutet që propozohen nuk e cenojnë Kushtetutën. ▪ Cili organ dhe nivel i pushtetit është përgjegjës për zbatimin e kutit të propozuar? Përse? 	
<p>PJESA DOKUMENTARE</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përkatëse ▪ E besueshme ▪ E ndërlidhur me pjesën demonstruese ▪ Përmban materiale të zgjedhura mirë 	
PREZANTIMI GOJOR	NOTA
<p>PARASHRTIMI</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kut i sqaruar që e ka përzgjedhur klasa dhe arsyet për këtë. ▪ Përparësitë dhe mangësitë e cekura të këtij kuti. ▪ Është sqaruar nëse kutet e propozuar janë në harmoni me Kushtetutën e ligjin. ▪ Cili organ dhe nivel i pushtetit është përgjegjës për zbatimin e kutit të propozuar? Përse? 	
<p>PËRGJIGJET NË PYETJE</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sa e kanë mbrojtur mirë nxënësit pikëpamjen e vet gjatë përgjigjeve në pyetjet e shtruara? ▪ Në ç’ masë përgjigjet e nxënësve kanë të bëjnë me pyetjet e shtruara? ▪ Sa e kanë treguar nxënësit kuptimin e natyrës dhe të vëllimit të problemit? 	
NOTA E PËRGJITHSHME	

Kaptina e katërt

Për secilin kut kjo kaptinë e studimit notohet me notën 1–5.

STUDIMI I KLASËS	NOTA
<p>PJESA DEMONSTRUESE</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Janë emërtuar individë, grupe, zyrtarë e organe të pushtetit me ndikim në bashkësi, të cilët mund t’i mbështesin masat që i propozon klasa. ▪ Janë emërtuar grupet, zyrtarët dhe organet e pushtetit në bashkësi, të cilët mund t’u kundërvihen kuteve. ▪ Janë emërtuar burimet e të dhënave. 	
<p>PJESA DOKUMENTARE</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përkatëse ▪ E besueshme ▪ E ndërlidhur me pjesën demonstruese ▪ Përmban materiale të zgjedhura mirë 	
PREZANTIMI GOJOR	NOTA
<p>PARASHRTIMI</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Janë emërtuar individët, grupet, zyrtarët e organet e pushtetit me ndikim në bashkësi të cilët mund t’i mbështesin kutet që i ka propozuar klasa. ▪ Janë emërtuar grupet, zyrtarë dhe organe të pushtetit në bashkësi, të cilët do të mund t’i kundërshtonin kutet. ▪ Janë emërtuar burimet e të dhënave. 	
<p>PËRGJIGJET NË PYETJE</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sa i kanë mbrojtur mirë nxënësit pikëpamjet e veta gjatë përgjigjeve në pyetjet e shtruara? ▪ Në ç’ masë përgjigjet e nxënësve kanë të bëjnë me pyetjet e shtruara? ▪ Sa e kanë treguar nxënësit kuptimin e natyrës dhe të vëllimit të problemit? 	
NOTA E PËRGJITHSHME	

**Pyetësoni për notimin e studimit e të prezantimit gojor:
Nota e përgjithshme**

Mësimdhënësi _____

Klasa _____

Shkolla _____

Emri i studimit të klasës _____

STUDIMI I KLASËS DHE PREZANTIMI GOJOR	NOTA	VËREJTJE
KAPTINA E PARË		
KAPTINA E DYTË		
KAPTINA E TRETË		
KAPTINA E KATËRT		
NOTA E PËRGJITHSHME		

Nota e tërë studimit është shuma e të katër kaptinave (numri më i madh i mundshëm i pikave është 80)

ANËTARI I JURISË _____ MË DATË _____

VII. PYETËSORI PËR NOTIMIN E NXËNËSVE

Mendimi yt do të na ndihmojë për ta avancuar mësimin.

Ju lutemi përmendni se në ç' masë pajtohesh me pohimet vijuese. Shfrytëzoje shkallën:

1 – nuk pajtohem fare

2 – nuk pajtohem

3 – pajtohem

4 – pajtohem plotësisht

1. Më mirë i kuptoj çfarë janë masat. _____
2. Më shumë di mbi problemin e bashkësisë time. _____
3. Kam mësuar të bashkëpunoj me tjerët
me rastin e zgjidhjes së problemeve. _____
4. Më janë avancuar aftësitë hulumtuese. _____
5. Kam zbuluar se mund të ndikoj në bashkësinë time. _____
6. E kuptoj më mirë funksionimin e pushtetit. _____
7. Kam mësuar se si njerëzit mund të marrin pjesë
në krijimin e masave politike. _____
8. Jam më i vetëdijshëm/e vetëdijshme për ekzistimin e grupeve
nga bashkësia që merren me problemet e saj. _____
9. E kuptoj nevojën e studimit si mjet i komunikimit dhe argumentimit. _____

Çfarë të ka pëlqyer më së tepërmi gjatë punës në këtë lëndë?

Cilat ndryshime do t'i kishe bërë?

Shkolla: _____

Emri (nuk është e obligueshme): _____

VIII. PYETËSORËT E NXËNËSVE

Pyetësor për vrojtimin dhe analizën e problemit

Emri i anëtarët të grupit _____

Më datë _____

Problemi _____

1. A është ky problem të cilin ju dhe anëtarët tjerë të bashkësisë së juaj e konsideroni të rëndësishëm? Përse?

2. Kush është përgjegjës në pushtet (personalisht apo zyrtarisht) për t'u marrë me këtë problem?

3. Cilat masa dhe zgjidhje, nëse ekzistojnë, zbatohen tani lidhur me këtë problem?

Nëse masa dhe zgjidhje të tilla ekzistojnë, përgjigjuni në pyetjet vijuese:

- Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e këtyre masave dhe zgjidhjeve?

- A nevojitet që këto masa dhe zgjidhje të zëvendësohen me ndonjë tjetër? Përse?

- Çfarë mospajtimesh, nëse ka, ekzistojnë në bashkësinë tuaj lidhur me këto masa e zgjidhje?

4. Ku mund të gjeni më shumë të dhëna mbi problemin dhe mendime që kanë për atë individët dhe grupet e ndryshme?

5. A ka probleme të tjera në bashkësinë tuaj për të cilët konsideroni se do të ishte e dobishme të studiohen në klasë? Cilat janë ato probleme?

Pyetësi për bisedat

Emri _____

Më datë _____

Problemi _____

1. Emri i personit me të cilin bisedohet _____
Profesioni i personit me të cilin bisedohet _____
(për shembull, ndërmarrës, nëpunës, pensionist, nxënës, student...) Vërejtje: nëse personi nuk dëshiron të emërtohet, respektojini këtë dhe shënjoni vetëm profesionin e tij.
2. I thoni personit me të cilin flisni se cilin problem po e studioni, e pastaj shtroni këto pyetje, kurse përgjigjet shënjoni.
 - a. A e konsideroni të rëndësishëm këtë problem? Përse?

b. A e konsiderojnë atë të rëndësishëm edhe anëtarët e tjerë të bashkësisë suaj?

c. Cilat masa dhe zgjidhje, nëse ekzistojnë, tani po zbatohen lidhur me këtë problem?

Nëse ekzistojnë masa të tilla, përgjigjuni në pyetjet në vijim:

▪ Cilat janë përparësitë e atyre masave dhe zgjidhjeve?

▪ Cilat janë mangësitë e atyre masave dhe zgjidhjeve?

▪ Si mund të përmirësohen?

▪ A nevojitet që ato të zëvendësohen? Përse?

▪ Cilat janë mospajtimet, nëse ka, në bashkësinë tuaj lidhur me këto masa?

ç. Ku mund t'i marrin të dhënat tuaja mbi këtë problem dhe mendimet e ndryshme lidhur me atë?

Pyetësi për burimet e shtypura

Emri _____

Më datë _____

Problemi _____

Titulli dhe data e publikimit _____

Titulli i tekstit _____

1. Mendimi mbi problemin i paraqitur në tekst

2. Informatat kyçe mbi problemin e paraqitur në tekst

3. Sipas burimit, cilat masa dhe zgjidhje, nëse ekzistojnë, zbatohen tani lidhur me këtë problem?

Nëse ka, a i cekin:

▪ Cilat janë përparësitë e atyre masave dhe zgjidhjeve?

▪ Cilat janë mangësitë e atyre masave dhe zgjidhjeve?

▪ Si mund të përmirësohen?

▪ A nevojitet të zëvendësohen ato? Përse?

▪ Si paraqiten mospajtimet, nëse ekzistojnë, në tekst lidhur me këto masa dhe zgjidhje?

Pyetësi për të dhënat nga radioja dhe televizioni

Emri _____

Më datë _____

Koha _____

Problemi _____

1. Burimi i të dhënave. (Këto mund të jenë lajmet në radio apo televizion, filmat dokumentar, intervistat apo ndonjë emision tjetër mbi problemin e bashkësisë të cilin e ka zgjedhur klasa juaj.)

Shqyrtoni pyetjet në vijim derisa jeni duke e përcjellë emisionin.

2. A është ky problem që konsiderohet i rëndësishëm? Përse?

3. Cilat masa dhe zgjidhje, nëse ekzistojnë, zbatohen tani me rastin e këtij problemi?

Nëse ka, përgjigjuni në pyetjet në vijim:

▪ Cilat janë përparësitë e atyre masave dhe zgjidhjeve?

▪ Cilat janë mangësitë e atyre masave dhe zgjidhjeve?

▪ Si mund të përmirësohen?

▪ A nevojitet që ato të zëvendësohen? Përse?

▪ Cilat janë mospajtimet në bashkësi, nëse ekzistojnë, me rastin e këtyre masave dhe zgjidhjeve?

Pyetësi dokumentar për të dhënat nga letrat apo bisedat

Emri i hulumtuesit _____

Më datë _____

Problemi _____

1. **Burimi.** (Shënjoni emrin e personit i cili jep të dhënat. Nëse është e mundshme, shënjoni profesionin e tij dhe grupin apo organizatën.)

Emri _____

Profesioni _____

Adresa _____

Telefoni _____

2. Kërkoni njoftime mbi problemin. Pas prezantimit me shkrim apo telefon (siç është propozuar në Doracakun për nxënës), kërkoni përgjigje në pyetjet vijuese:

a) Sa është serioz ky problem në bashkësinë tonë?

b) Sqaroni përse mendoni ashtu?

c) Sa është i përhapur ky problem në vendin tonë (kërkoni t'iu japin përgjigje të sakta nëse i dinë të dhënat)?

ç) Përse duhet të merren autoritetet me to?

d) Cili nivel dhe shërbime të pushtetit janë përgjegjëse për marrje me këtë problem?

dh) Çfarë bëjnë me rastin e tij?

e) Cili ligj merret me këtë problematikë?

ë) A duhet të marrë edhe dikush tjetër (dhe kush) përgjegjësi për zgjidhjen e problemit?

Përse? _____

f) A ka mendime të ndryshme mbi masat ekzistuese apo mënyrën e zbatimit të tyre?

PO / JO

Nëse përgjigja është PO, shtroni pyetje shtuese:

- Ku dallojnë ato mendime?

- Kush janë individët kryesorë, grupet apo organizatat të cilat paraqesin mendime të ndryshme mbi problemin?

- Përse janë të interesuara për problemin?

- Çfarë propozojnë ata?

- Si përipiqen ato të ndikojnë në autoritetet që t'i përqafojnë zgjidhjen e tyre të këtij problemi?

- Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e masave që i propozojnë ata?

- A mund të na ndihmoni që të sigurojmë të dhënat mbi përbërjet e tyre lidhur me problemin?

- A keni ndonjë propozim se si mund të ndikojmë ne në autoritetet për t'i përqaftuar masat që do të zhvillojë klasa jonë?

- Kujt mund t'i adresohemi që të mund të sigurojmë sa më shumë informata mbi këtë problem? (Na nevojitet emri i personit/organizatës, adresa nëse është e mundshme dhe telefoni për kontakt.)

Vërejtje: Ky është vetëm “skelet” i pyetësorit tuaj për bisedë apo letër. Do të ishte më mirë që në mënyrë të pavarur ta sajoni pyetësorin të përshtatur problemit të cilin e studioni, duke shfaqur kujdes mbi atë se çfarë dëshironi të mësoni për problemin konkret me ndihmën e atij pyetësorit. Personat me të cilët bisedoni nuk mund t’ju japin përgjigje në të gjitha pyetjet tuaja (diç nuk është në fushëveprimin e punës dhe dijes së tyre). Vlejnë edhe ato këshilla të dhëna në pyetësorin për të dhënat nga Interneti.

Pyetësi dokumentar për të dhënat nga radioja dhe televizioni

Emri i hulumtuesit _____

Më datë _____

Problemi _____

Burimi i të dhënave. (Këto mund të jenë lajmet në radio apo televizion, filmi dokumentar, intervista apo ndonjë program tjetër mbi problemin e bashkësisë që e ka përgjedhur klasa juaj.)

Titulli i emisionit/kronikës

Emri i autorit të emisionit

Nëse në emision i është emetuar intervista, shkruani emrin e personit me të cilin është bërë:

Data dhe koha e emetimit _____

Shkruani shkurt çfarë keni mësuar nga emisioni/kronika në fjalë mbi problemin që po e hulumtoni (vini mendjen se sa serioz është problemi dhe i përhapur si në bashkësinë lokale ashtu edhe në mbarë vendin, dhe a ekziston gjatë si problem i madh.) Mundohuni ta përshkruani sa më mirë:

a) A përmenden masat që i kanë ndërmarrë tani autoritetet me qëllim të zgjidhjes së PO/JO (Rrumbullakoni përgjigjen).

Nëse përgjigja është PO, përgjigjuni në pyetjet në vijim:

- Cilat janë ato masa që po i ndërmarrin autoritetet?

- Cilat janë përparësitë e atyre masave?

- Çfarë janë mangësitë e atyre masave?

- Në çfarë mënyre mund të përmirësohen masat? A duhet të zëvendësohen? Sqaroje sa më hollësisht.

- Cili ligj merret me këtë problematikë?

b) Kush (përpos pushtetit) merret me këtë problematikë?

- Në çfarë mënyre? (Nëse është kjo ndonjë organizatë apo shoqatë qytetare, përkthyeri sa më shkurtër e sa më hollësisht.)

- Cilat janë anët e mira të masave të tyre?

- Cilat janë anët e këqija të masave të tyre?

- A jeni orvatur të vini kontakt me ata? PO/JO (rrumbullakoni)

Përse? _____

Si? _____

c) Çfarë keni mësuar akoma mbi problemin që e keni hulumtuar?

ç) Ku mund të merren akoma të dhëna mbi këtë problem?

Këshillë: Nëse vendosni të bëni kontakt me autorin e emisionit/kronikë ose me ndonjërin nga pjesëmarrësit, me ata që do të mund të paraqesin qëndrimin e vet mbi problemin me të cilin merreni, përgatituni mirë duke përgatitur paraprakisht të gjitha pyetjet në të cilat dëshironi të merrni përgjigje. Në qoftë se u adresoheni njerëzve nga radioja apo televizioni, pyesni ata nëse edhe më herët kanë bërë emisione mbi këtë problem. Lutni ata, nëse kanë mundësi, tua lëshojnë t'i dëgjoni apo shikoni emisionet/ kronikat mbi atë dhe tu thonë se deri tek çfarë informatash ata kanë arritur atëherë.

Ju më pas, në bazë të shënimeve tuaja shkruani një raport të shkurtër mbi krejt atë që keni mësuar nga ato biseda e kanë të bëjnë me problemin në të cilin po punoni. Nëse emisioni i radios/TV ka qenë shkas të zhvilloni biseda mbi problemin të cilin e hulumtoni me njerëzit që kanë qenë në të, shkruani këtë. Çka dhe për çfarë ju ka nxitur të kërkonte sqarim prej dikujt që ka marrë pjesë në kështu apo ashtu në atë emision/kronikë? Në çfarë mënyrë mund t'iu ndihmojë ai person, organizatë, shoqatë në zgjidhjen e problemit?

Pyetësi dokumentar për burimet e shtypura

Emri i hulumtuesit _____

Më datë _____

Problemi _____

Emri i gazetave/librit

Titulli i tekstit

Emri i autorit

Nëse është botuar intervista, shkruani ermin e personit me të cilin është bërë:

Data e botimit _____

Shkruani shkurt se çfarë keni mësuar nga teksti në fjalë mbi problemin ciline hulumtoni (tregoni kujdes në lidhje me faktin se sa serioz është problemi dhe sa i përhapur si në bashkësinë lokale dhe në mbarë vendin, dhe a kanë ekzistuar për një kohë të gjatë si problem i madh.)

Mundohuni ta përshkruani sa më mirë:

- a) A iëpmendni masat që tani i marrin autoritetet me qëllim të zgjidhjes së këtij problemi?
PO/ JO (rrumbullakoni përgjigjen).

Nëse përgjigja është PO, përgjigjuni në pyetjet vijuese:

- Cili nivel i pushtetit është përgjegjës për tu marrë me këtë problem?

- Cilat janë ato masa që po i marrin autoritetet?

- Cilat janë përparësitë e atyre masave?

- Cilat janë mangësitë e atyre masave?

- Në çfarë mënyre mund të përmirësohen masat? A duhet të zëvendësohen? Sqaroni sa më hollësisht.

b) Kush (përpos autoriteteve) merret me këtë problem?

- Në çfarë mënyre? (Nëse kjo është ndonjë shoqatë e qytetarëve, përshkruani sa më shkurt e më hollësisht.)

- Cilat janë anët e mira të atyre masave?

- Cilat janë anët e këqija të atyre masave?

- A jeni përpjekur të vini kontakt me ata? Po/Jo (rrumbullakoni)

Përse? _____

Si? _____

c) Ku mund të merren akoma të dhëna mbi këtë problem?

Nëse konsideroni se është e nevojshme dhe që të merrni informata shtesë mbi problemin cilin po e hulumtoni, ndoshta ekziston mundësia që ju dhe klasa juaj të vini kontakt me autorin e tekstit apo me ndonjërin nga njerëzit që përmenden në të. Vetëm përgatituni mirë që të mundeni sa më shumë të mësoni mbi atë që ju intereson. Prandaj është më mirë që paraprakisht t'i punoni të gjitha pyetjet në të cilat dëshironi të merrni përgjigje, e nuk është në këtë tekst. Shënimin t'uaj shkruajeni këtu:

Pyetësi dokumentar për të dhënat nga Interneti

Emri i hulumtuesit _____

Më datë _____

Problemi _____

Adresa e Internetit www. _____

Titulli i tekstit _____

Nëse është intervistë, shkruani emrin e personit me cilin është bërë: _____

Data (nëse ekziston) e botimit të Internet _____

Shkruani shkurt çfarë keni mësuar nga teksti i dhënë mbi problemin të cilin e hulumtoni (bëni kujdes për atë se sa serioz dhe i përhapur është problemi si në bashkësinë lokale ashtu edhe në mbarë vendin dhe a ekziston prej kohësh si problem.) Mundohuni ta përshkruani sa më mirë:

a) A përmenden masat që tash po i marrin autoritetet me qëllim të zgjidhjes së këtij problemi? PO/JO (rrumbullakoni përgjigjen).

Nëse përgjigja është PO, përgjigju në pyetjet vijuese:

- Cili nivel i pushtetit është përgjegjës për marrje me këtë problem?

- Cilat janë ato masa që po i marrin autoritetet?

- Cilat janë përparësitë e atyre masave?

- Cilat janë mangësitë e atyre masave?

- Në çfarë mënyre mund të përmirësohet masat? A duhet të zëvendësohen? Sqaroni sa më hollësisht.

- Cili ligj merret me këtë problematikë?

b) Kush (përpos pushtetit) merret me këtë problem?

- Në çfarë mënyre? (Nëse kjo është ndonjë shoqatë e qytetarëve, përshkruani sa më shkurt e sa më hollësisht.)

- Cilat janë anët e mira të atyre masave?

- Cilat janë anët e këqija të atyre masave?

- A jeni orvatur të vini kontakt me ata? Po/Jo (rrumbullakoni)

Përse? _____

Si? _____

c) Ku mund të merren akoma të dhëna mbi këtë problem?

Si separat për këtë pyetësor mund ta shtypni faqen që e keni hulumtuar në Internet, dhe mund t'ju shërbejë me rastin e punimit të studimit të klasës. Nëse në këtë mënyrë (me ndihmën/apo në gjurmë të kësaj adrese në Internet) ia keni dalë të vini kontakt me ndonjë person, shoqatë, organizatë e ngjashëm, shkruani atë si vërejtje në fund të këtij pyetësori dhe jepni atë që më vonë e keni mësuar mbi problemin me cilin po merreni.

VËREJTJE: Lirisht shkruani letra dhe mesazhe elektronike, por patjetër mbani evidencë kur dhe kujt ia keni dërguar, që të mos e ngarkoni me letrën e njëjtë, secili nga ju veç e veç për atë person të njëjtë, e që njerëzit t'ju kuptojnë gabim. Është më mirë që për komunikim me anë të letrës apo postës elektronike të ngarkohet një grup i nxënësve cilit do t'i drejtoheshin të gjithë të tjerët për ndihmë gjatë hulumtimit.

Shtojcat

- 1. Zhvillimi i diskutimit**
- 2. Hapi i dytë – propozimet për mënyrën e zgjedhjes së problemit**
- 3. Hapi i tretë – burimet e të dhënave dhe mënyrat e komunikimit**
- 4. Hapi i katërt – puna e grupeve studimore**
- 5. Këshillat për hapin e pestë**
- 6. Projektet dhe mësimi me anë të projekteve**
- 7. Përcjellja dhe notimi**

Zhvillimi i diskutimit

Roli i mësimit dhe të mësimit

Në këtë metodë mësimore dhe të mësimit, mësimit dhe ka rolin dominues:

- mësimit dhe i di përmbajtjen dhe objektivat,
- mësimit dhe bën nxitje të caktuara në fillim dhe gjatë procesit të mësimit,
- mësimit dhe siguron që të nxirret përfundimi i qartë i formuar mbi temën e re.

Mësimit dhe është përgjegjës për aplikimin didaktik të diskutimit. Kjo përfshin edhe studimin me kujdes të strukturës tematike, drejtimin e nxënësve në paralele dhe paraqitjen e qartë e rezultateve.

Mësimit dhe e nxit kureshtjen e natyrshme të nxënësve dhe mbështetet në dijen e tyre.

Ai/ajo merr parasysh aftësinë e tyre për të nxjerrë konkluzion dhe me nxitje të shkathët i inkurajon në të menduarit mirë.

Mësimit dhe toleron edhe zgjidhje e gabime më pak të vlefshme, sepse edhe ato mund të shërbejnë për zgjidhjen e problemit me anë të diskutimit.

Objektivat e diskutimit të zhvilluar

Çdo komunikim gojor midis mësimit dhe nxënësve dhe tejkalon temën specifike; ai ka për objektiv edhe ndërtimin e zhvillimin e bashkëjetesës në paralele. Nxënësve lypset të mësojnë edhe gjëra të tilla qenësore sikurse janë: aftësia e dialogut, komunikimi dhe zgjidhjet e konflikteve, e që përfshijnë aftësi dhe shkathësi të shumta, p.sh. dëgjimin, tolerancën, empatinë, fokusimin në argumente etj..

Mundësia e aplikimit

Do të cekim vetëm disa fusha në të cilat mund të aplikohet diskutimi i zhvilluar:

- sqarimi i nocioneve,
- zgjidhja e problemeve në bashkëpunim,
- procesi i kuptimit të domethënies,
- zhvillimi i kategorive dhe aspektet e klasifikimit.

Qëllimi i pyetjeve dhe i nxitjeve

Kritikët e kundërshtojnë ashpër metodën e mësimit me anë të shtrimit të pyetjeve – ai që shtron pyetje veç i di përgjigjet, e përgjigjen ata të cilët në të vërtetë lypset të shtrojnë pyetje. Nxënësve gjatë orës duhet të përgjigjen edhe në pyetjet të cilat kurrë nuk do t'i shtronin vetë. Ky shtrembërim i procesit natyror, thonë kritikët, gradualisht e paralizon dëshirën e nxënësve që të shtrojnë pyetje dhe i stërvit të presin nxitje në të cilën duhet të reagojnë. Nxënësve lypset edukuar ashtu që të mendojnë e të sillen si të pavarur. Në mësimit duhen shmangur pyetjet dhe më mirë t'u krijohen nxitje të hapura, p.sh.. detyrë apo problem.

Të tjerët insistojnë në atë se mësimit dhe, me shtrimin e pyetjeve, realizojnë një funksion të rëndësishëm didaktik. Mësimit dhe nuk kërkojnë nga nxënësve të japin informata mbi atë që nuk e njohin, por ta kundërojnë temën nga pikëpamja e caktuar (p.sh. shkakun, qëllimin, epilogun, vendin, kohën), duke u mundësuar atyre të fitojnë pasqyra dhe kuptime të reja.

Nëse dëshirojmë ta tejkalojmë këtë diskutim bukur joproduktiv mbi vlerat apo rreziqet e formës së tillë elementare të mësimit, duhet të instalojmë vlerën e diskutimit të zhvilluar – e kjo ka të bëjë edhe me cilëndo metodë tjetër të mësimit – në bazë të ndikimit dhe efektit që ka në procesin e mësimit tek nxënësit. Nëse mësimitdhënësi i cili e shfrytëzon metodën e diskutimit të zhvilluar i mbështetet nxënësit në ndërtimin dhe zhvillimin e strukturave të reja të kuptimit, metoda ka vlera të qarta. Duhet cekur se edhe shumë diskutime në paralele kanë pak vlerë didaktike, p.sh. për shkak se janë rreptësisht të orientuara drejt qëllimit që mësimitdhënësi e ka shtruar paraprakisht. Nxënësit vetëm duhet të zbulojnë çfarë po dëshiron mësimitdhënësi të dëgjojë nga ata. Është e evidente se një tip i tillë i mësimit nuk i zhvillon aftësitë e nxënësit për të nxjerrë konkluzione dhe për të zgjidhur problemin. Shtrembërimi i diskutimit të zhvilluar është “mësim me marrjen në pyetje,” monoton, steril me një varg pyetjesh (“Çfarë dini?,” “Çfarë ju kujtohet?...”)

Besojmë se diskutimi i zhvilluar ofron mundësi që të arrihen objektiva të rëndësishme të mësimit. Së këndejmi mësimitdhënësit duhet të stërviten për këtë metodë dhe ta kenë në repertoarin e tyre. Mirëpo, kjo metodë është e orientuar rreptësisht për mësimitdhënësin dhe nëse shfrytëzohet në kombinim me metodat tjera të orientuara për mësimitdhënësin, mund të krijojë monokulturën metodike në të gjitha lëndët dhe llojet e shkollave.

Njëra nga përparësitë e kësaj metode qëndron në faktin që mundëson përmirësimin e komunikimit në paralele. Hulumtimet tek nxënësit kanë treguar sa mësimitdhënësit presin gjatë, që nxënësit të përgjigjen në pyetje dhe sa u duhet të reagojnë në përgjigjen e nxënësit.

Sipas rregullit, mësimitdhënësit u japin nxënësve një sekondë, ose më pak të përgjigjen në pyetjen e tyre, ashtu që nxënësit nuk kanë kohë të mendohen. Mirëpo nëse mësimitdhënësi pret vetëm tre sekonda, efekti është mjaft i habitshëm:

- Cilësia e pjesëmarrjes së nxënësve po shtohet:
 - përgjithësisht, përgjigjet e nxënësve janë më të gjata,
 - nxënësit e zhvillojnë logjikën e tyre të argumenteve dhe po tregojnë
 - nivel më të lartë të kreativitetit e të mendimit të pavarur,
 - nxënësit po shtrojnë më shumë pyetje,
 - nxënësit më shpesh po komunikojnë mes tyre,
 - nxënësit po japin përgjigje të sakta,
 - po zvogëlohet problemi i disiplinës në paralele,
 - nxënësit me arritje më të dobët po ndihen të trimëruar për të marrë pjesë në komunikim në paralele,
 - nxënësit po zhvillojnë vetësiguri.
- Cilësia e kontributit dhe i kontributit të mësimitdhënësit gjithashtu po rritet
 - bëjnë më pak gabime,
 - shtrojnë më pak pyetje,
 - më shumë po u shtrojnë nxënësve nënpyetje dhe shpesh reagojnë në kontributin e tyre,
 - pyetjet e mësimitdhënësave po bëhen më të ndërlikuara dhe më periferike,
 - mësimitdhënësit presin nivel më të lartë të arritjes në paralele, e veçmas të nxënësve të dobët,
 - mësimitdhënësit janë të kënaqur.

Mënyra e nxitjes së diskutimit të zhvilluar

Nxitjet janë formular specifik të interaksionit social në mikronivelin e procesit mësimor. Është e dobishme që ato të klasifikohen me emrin formal sepse kjo tregon se mund të shfrytëzohen si mjete në kontekste të ndryshme që t’i japin përgjigje qartë nevojave të

përkufizuara. Pra dialogjet në paralele mund të inicohen dhe zhvillohen në mënyra të ndryshme.

Mënyra e nxitjes së diskutimit të zhvilluar

Pyetjet	Shembujt
Kërkimi i fakteve	Çfarë ka ndodhur në këtë eksperiment?
Kërkimi i mendimit	Çfarë mendoni ju për sjelljen e babait?
Kërkimi i shkaqeve	Pse fluturon avioni?
Pyetjet kyçe	Cila ka qenë detyra jonë?
Nxitjet	
Udhëzim	Ju lutem përmbajuni detyrës.
Kërkesë	Të lutem sqaroje..., krahasoje, përshkruaje, gjeje, verifikoje
Koment	Sandra pikërisht tha diçka të rëndësishme që do të na ndihmojë
Mimikat, gjestet	Dhënia e shenjës me kokë, tundja, shprehja e përfytyruar
Qetësia	
Aksioni	Mësimdhënësi e regjistron pyetëtorin pranë deklaratës apo vizatimit

Ajo që kanë të përbashkët këto pyetje e nxitje është karakteri i tyre i hapur lidhur me përgjigjet e mundshme dhe reagimet e nxënësve. Nxënësit lypset t'i përmbahen kontestit dhe duhet të përgjigjen me fjalë të plota. U ofrojnë rastin nxënësve që ta shprehin mendimin e vet plotësisht dhe në hollësi. Së këndejmi lypset të shmangen nxitjet dhe pyetjet të cilat kërkojnë përgjigje me një fjalë, sepse mund të shndërrohen në pyetje e përgjigje pingpongu; në këtë rast rolin dominues do ta ketë mësimdhënësi e jo tema. Mësimdhënësi lypset vazhdimisht të sajojë pyetje të reja dhe do të marrë nivele gjithnjë e më të dobët të informative kthyes.

Për këtë shkak mësimdhënësi duhet tu shmangët pyetjeve në të cilat mund të jepet përgjigje me PO ose JO, e sidomos:

pyetjet që kërkojnë vendim apo zgjedhjen p.sh. A të pëlqen figura?
 pyetje sugjестive p.sh. A mendon ti se...?

Po ashtu mësimdhënësi duhet t'i shmangët shtrimin të shumë pyetjeve menjëherë, të ashtuquajtura pyetje zinxhir (Kush duhet ta bëjë, çfarë, ku, kur dhe si?), sepse nxënësit nuk do të dinë me cilën pyetje ta fillojnë. Zakonisht pyetje të tilla shtrohen nëse nxënësit nuk përgjigjen menjëherë, kurse mësimdhënësi është tepër i padurueshëm për të pritur.

Pjesëmarrja e nxënësve në diskutimin e zhvilluar

Nga pikëpamja mësimdhënësit, deklarata e nxënësit në paralele nuk është asgjë më shumë nga reagimi direkt në nxitjen e tij. Nga pikëpamja e nxënësit çështja është më e ndërlikuar. Për ata kjo është si të ecurit nëpër tel, me mbajtjen e katër gjërave vijuese në baraspeshim:

- *Interesi personal* – nxënësit janë të interesuar për temën dhe kanë dijeni të cilën dëshirojnë ta tregojnë dhe ndajnë në paralele.
- *Arritja dhe vlerësimi* –nxënësit e dinë se krejt çka deklarojnë në orë vlerësohet sie arritur e tyre verbale. Prandaj deklaratat e tyre duhet t'i kënaqin standardet e caktuara minimale.

- *Pozita shoqërore në paralele* – duke kontribuar me idetë e veta, nxënësit ekspozohen duke e zbuluar personalitetin e vet. Nëse çdo gjë kalon mirë, reputacioni i tyre në paralele shtohet, por edhe i ekspozohet rrezikut të përqeshet.
- *Mbrojtja e identitetit personal dhe e vetë-respektimit* – nxënësit dëshirojnë të vendosin kur duan të thonë diçka. Prandaj mund të reagojnë me kokëfortësi kur mësimdhënësi i thërret me emër e mbiemër. Madje edhe kur e dinë saktë çfarë është ajo që dëshiron ta dëgjojë mësimdhënësi, mund të japin përgjigje të papritura apo më me ëndje do të heshtin.

Edhe me pak përvojë shkollore, nxënësit bëhen ekspertë në kundërimin e rolit të vet si nxënës dhe zhvillojnë intuitën e fuqishme për të kuptuar se çfarë po ndodh në paralele. Është vërejtur se mësimdhënësit në punën e përditshme shpesh e sqarojnë lëndën e mësimit me katër-pesë nxënës të cilët tregojnë interesim, me falënderim dhe për momentin duke përqafuar çdo mendim që e paraqet një nxënës i tillë, të kënaqur që kanë marrë përgjigje adekuate e cila ndihmon që mësimi të vazhdohet ashtu siç e ka planifikuar mësimdhënësi. Në ato kushte shumica e nxënësve ndihet e lënë pas dore apo vëmendja veç u ka fluturuar. Mësimdhënësit me përvojë rekomandojnë këto masa në mënyrë që të inkurajojnë sa më shumë nxënës të marrin pjesë edhe pse asnjëri nga ata nuk është rezistues në moses:

- Pasi të jepni nxitje, pritni që nxënësit të mendohen. Gjithashtu mund të ndihmojë nëse nxënësi kanë kohë t'i shënojnë idetë e veta.
- Lejojuni nxënësve që në qift ta përpunojnë, në mënyrë mentale, problemin ose pyetjen, ose jepuni kohë që në atë mënyrë të punojnë në ndonjë fazë të mëvonshme.
- Drejtoheni nxënësve arritjet e të cilëve janë në nivel më të ulët, dhe inkurajoni që përvojën dhe idetë e veta t'i ndajnë me paralelen.
- “Kthejani” paraleles idetë dhe propozimet që i kanë dhënë nxënësit, duke i inkurajuar që t'i verifikojnë dhe komentojnë;
- Nëse nxënësi e paralajmëron idenë e re shpreheni atë në tërësi dhe pyesni nxënësin a është kjo ajo që ka menduar (dëgjimi aktiv).

Problemet dhe vështirësitë që mund të lajmërohen

a) Si të reagohet në deklaratat e papritura të nxënësve

Idetë e mira që i ekspozojnë nxënësit, e për të cilat mësimdhënësi konsideron se “e kanë lëshuar rrugën”, shpesh kalojnë në heshtje, nuk përfillen ose kualifikohen si të gabueshme, në qoftë se nuk përputhen në modelin që e ka shtruar mësimdhënësi. Është e dukshme se kjo i irriton dhe inkurajon nxënësit në zhvillimin e ideve kreative dhe pjesëmarrje në paralele, dhe i nxit nxënësit të lëshohen në lojën e të qëlluarit, por jo doemos edhe të kuptimit dhe përqafimit të asaj që mësimdhënësi dëshiron ta dëgjojë. Që kjo të evitohet, rekomandohen modelet vijuese të sjelljes së mësimdhënësit:

- ushtroni aftësinë tuaj për të prituri që nxënësit e tjerë të reagojnë në vendin tuaj,
- në qoftë se nuk e kuptoni çfarë ka thënë nxënësi ose nuk i kuptoni implikimet-pyesni,
- lejojani nxënësit të sqarojë çfarë ka dashur të thotë,
- mendohuni mirë cila do të ishte pyetja juaj e cila do t'i përgjigjej kësaj përgjigje.

b) Ehoja e mësimdhënësit (nxënësit “si papagaj” përsëritin çdo kontribut)

Problemi tjetër që ndodh shpesh është ehoja e mësimdhënësit, domethënë mësimdhënësi e komenton menjëherë çdo lajmërim të nxënësve. Mësimdhënësi e përsërit çdo përgjigje të nxënësve, duke e vërtetuar ose komentuar („Po”, saktë. “). Efektet e këtij modelit të sjelljes së mësimdhënësit janë:

- diskutimi i zhvilluar shndërrohet në këmbim të bezdisshëm të pyetjeve dhe përgjigjeve;
- pas vërtetimit imediat të deklaratës së nxënësit nga mësimitdhënësi, nxënësit e tjerë më nuk do të marrin pjesë, sepse besojnë se përgjigjen e kanë të gabuar;
- nxënësit do të pushojnë të mendojnë;
- nxënësit nuk do të mbështeten më në atë që e kanë thënë nxënësit e tjerë;
- për një kohë të shkurtër, pjesëmarrja e nxënësve do të bjerë shpejt.

Arsyeja, për shkak të së cilës mësimitdhënësit zhvillojnë shprehin e përsëritjes së secilës deklaratë të nxënësve, është ajo që ju duhet kohë të mendohen, p.sh. të shtrojnë pyetje të reja, të mendohen mbi përgjigjen e nxënësit, ta krahasojnë me standardet e veta ose t'i kalojnë pauzat në komunikim.

Masat vijuese parandaluese mund të merren kundër “sindromit papagaj”:

- pa komente të mëtejme të shkruhet deklarata e nxënësit në tabelë;
- lejojuni të gjithë nxënësve që lajmërohen, të thonë më përpara se sa e jepni deklaratën tjetër;
- bëni një përpjekje të vetëdijshme ta duroni heshtjen një kohë, që të mund tu jepni nxënësve mundësi të mendohen.

c) Disa probleme të tjera

Shumë nga problemet e përshkruara në vijim, mund të sillen në lidhje me faktin se shumica e diskutimit të zhvilluar shtron përpara mësimitdhënëseve një detyrë të ndërlikuar, e cila kërkon nivel të lartë të përqendrimit. Mësimitdhënësi lypset:

- ta ketë në mend idenë e qartë mbi atë, dhe strukturën e saj;
- të mbajë diskutimin në paralele duke dhënë nxitje përkatëse, dhe nuk guxon ta humbë para sysh thelbin dhe epilogun;
- të reagojë adekuat në të gjitha deklaratat dhe idetë që i ekspozojnë nxënësit dhe lypset t'i ketë parasysh;
- në sekondë të vendosë si do ta vazhdojë orën e mësimit, duke zgjedhur midis zgjidhjeve të ndryshme;
- t'i përcjellë të gjithë nxënësit dhe të përballët me çfarëdo pengese dhe ndërprerje;
- të përcjellë kohën.

Nëse mësimitdhënësi nuk ia del në këtë, mund të ndodhin këto probleme:

- Mësimitdhënësi nuk e ka idenë e qartë mbi epilogun. Nga njëra anë, mësimitdhënësi ndoshta nuk e ka studiuar me themel temën, dhe nuk ka menduar sa duhet mirë mbi pasojat që sjellin pengesat e paplanifikuara të gjykimit të arsyeshëm. Nga ana tjetër, pasi diskutimi nuk e ka qëllimin e qartë, do të reduktohet në bisedë të zakonshme. Nuk do të ketë të ruajtura rezultate, diagrame apo shënime, dhe për këtë shkak së shpejti do të harrohen. Biseda të tilla nxënësit në paralele nuk do t'i kuptojnë seriozisht.
- Debati i zhvilluar merr shumë kohë, ndoshta edhe tërë një orë.
- Mësimitdhënësi insiston në mësimin e dialogut, duke injoruar mungesën e dijes së nxënësve e cila ua merr mundësinë për pjesëmarrje.
- Pyetjet janë tepër të ngushta, pra tepër të caktuara dhe mund të jepet përgjigje me një fjalë.
- Kërkesat dhe detyrat e mësimitdhënësit janë të paqarta dhe nuk kërkojnë përgjigje të angazhuar të nxënësve, p.sh.. “A mundeni ndoshta ...,” “Ndoshta do të doni ...,” “.....vetëm shpejtë ,” “.....pak. “ , „.....nëse dëshironi. “ , „.....disi...“ , „.....s’ka lidhje. “”.

- Nxënësit do të jenë të kufizuar apo të penguar të mendojnë me kokën e vet në qoftë se mësimdhënësi nuk jep kohë të mjaftueshme të mendohen, po veç i grumbullon pyetje pas pyetje nëse nuk merr përgjigje momentale në të parën.
- Klasa e mobiluar në mënyrë klasike (rend pas rendi) nuk është e përshtatshme për çfarëdo lloji të diskutimit.

Përfundim

Mund t'i rezymojmë pikat kryesore të cilat mund ta mbështesin diskutimin e zhvilluar dhe ta bëjnë të kuptueshëm.

Mësimdhënësi:

- e ka zgjedhur temën e përshtatshme dhe i ka shtruar objektivat përkatëse;
- i ka zhvendosur karriget sipas mënyrës e cila i mbështet nxënësit në komunikimin e ndërsjellë (p.sh, rreth, katror ...);
- ka ide të qartë mbi përmbajtjen e temës të cilën duhet ta mësojnë nxënësit;
- u ndihmon nxënësve të krijojnë lidhje dhe pasqyra të reja;
- shtron probleme dhe i nxit nxënësit të mendojnë me kokën e vet dhe t'i ndajnë idetë e veta;
- siguron që nxitjet të jenë të qarta e të kuptueshme;
- u jep nxënësve kohë të mjaftueshme për të menduar dhe mund të presë;
- e përfshinë, nëse është e nevojshme, fazën fillestare që nxënësit të mund të "mendojnë me kokë" dhe të sajojnë shënime apo të debatojnë në çift mbi idetë e tyre;
- nuk i ndërpret nxënësit në aktivitetet e veta të mendimit, përpunimit, debatit apo të shkrimit;
- nuk i ndërpret nxënësit derisa japin përgjigje;
- pret të bashkohen disa nxënës para se të bëjë nxitje të re;
- jep vetëm disa përgjigje apo komente;
- mbështetet në nivelin e dijes paraprake dhe të kuptimit të nxënësve;
- i shënon rezultatet graduale në tabelë, grafoskop apo letër më të madhe,
- i vizualizon dhe ilustron idetë dhe shqyrtimet e ndryshme.

Hapi i dytë – propozimet për mënyrat e zgjedhjes së problemeve

Hapi tjetër i qenësishëm është zgjedhja e një problemi të cilin klasa do ta hulumtojë më tutje. Është me rëndësi të respektohet procedura demokratike e zgjedhjes, përkatësisht që nxënësit pas diskutimit dhe paraqitjes së argumenteve për secilin propozim të problemit, t'i harmonizojnë qëndrimet në mënyrë demokratike mbi atë se për cilin problem do të përcaktohen. Nëse nxënësit nuk ia dalin të bien në ujdi, mund të organizoni votim (si një nga mënyrat e vendosjes demokratike). Ne ua prezantojmë dy mënyra të votimit kurse ju përzgjidhni atë i cili ju përgjigjet më së shumti, ose mendoni mirë ndonjë tjetër.

↳ Lejojuni nxënësve të votojnë për tri propozime, ashtu që me shkumës do t'i shkruajnë yllkën apo lulëzën pranë propozimeve që u pëlqejnë (secili nxënës voton për tri propozime).

Thoni nxënësve t'i vlerësojnë tri propozime me më shumë vota me ndihmën e kriterëve të shtruar.

Vëllimi Sa është i përhapur është problemi në fjalë?

Intensiteti Sa shumë njerëz janë të interesuar për çështjen/problemin, sa u intereson zgjidhja e tij?

Burimet Cilët janë burimet e problemeve?

Zgjatja A është problemi i arsyeshëm? A është ky problem që ekziston për një periudhë të gjatë kohore?

Pas eliminimit të problemeve të cilët nuk kënaqin kriteret e dhëna, bëni rivotimin dhe përzgjidhni problemin.

Vërejtje: pas përzgjedhjes së tre problemeve me më shumë vota, shikoni nëse ata kanë ngjashmëri, a kanë diçka të përbashkët. Ndoshta mund të bashkohen në një problem të përbashkët.

Mundohuni që gjatë votimit, nëse është e mundshme, të siguroni konsensus ashtu që do të organizonin më shumë rrethe të votimit dhe me atë rast bëni eliminimin e propozimit me më pak vota (për këtë mund të kërkonin pëlqimin e propozuesit).

↳ Shfletoni me nxënësit të gjitha problemet e tyre të propozuara dhe shkruani ato në tabelë, kurse ata le t'i shënojnë në tabelë në doracakët e vet.

Numri rendor	Emri i problemit	Numri rendor	Emri i problemit
1.		8.	
2.		9.	
3.		10.	
4.		11.	
5.		12.	
6.		13.	
7.		...	

Tregojuni atyre keni shfletuar shumë probleme, por para tyre është detyra që ta zgjedhin vetëm një me të cilin do të merren në periudhën e ardhshme. Ndani ata në pesë grupe. Lutni që secili për vete të përzgjedh 5 probleme që për të janë më të rëndësishëm. Jepuni 5 minuta të mendohen. Kur këtë ta bëjnë në nivel të grupit le t'i shikojnë të gjitha problemet të cilët më përpara i kanë përzgjedhur veç e veç, le të diskutojnë dhe me negociata t'i zgjedhin 5 të cilët për grupin e tyre janë më të rëndësishëm. Me rastin e përzgjedhjes le t'i shfrytëzojnë kriteret e cekura më lartë. Për punë kanë 10 minuta.

Kur ta kryejnë, përfaqësuesit e grupeve le të prezantojnë problemet e përzgjedhura, e ju shënjoni / shkruani në tabelë, kurse nxënësit le t'i shkruajnë në tabelën që e kanë në *Doracakun* e vet.

Numri rendor	Emri i problemit
1.	
2.	
3.	
4.	
5.	

Veçoni ato 5 probleme të cilët kanë fituar më shumë vota dhe ndajuni secilit grup nga një. Tash secili grup ka detyrë që ta përgatisë prezantimin më mirë të argumentuar përse është e nevojshme të merremi pikërisht me këtë problem, e jo me ndonjë tjetër. Në doracakët e vet kanë hapësirë ku mund të shkruajnë emrin e problemit të cilin e mbrojnë dhe argumentet përse mendojnë se duhet të merren pikërisht me këtë. Për punë kanë 15 minuta, kurse për paraqitjen e argumenteve 5 minuta.

Kur grupet ta kryejnë punën, përfaqësuesi i secilit grup le t'i paraqesë argumentet për atë problem. Pasi i kanë dëgjuar qëndrimet e të gjitha 5 grupeve, le të votojnë sërish veç e veç, por kësaj here vetëm për një problem. Ai problemi i cili ka numër më të madh të votave është problemi i përzgjedhur i tërë klasës dhe me atë do të merret klasa në periudhën e ardhshme. Nxënësit lypset që në *Doracakët* e vet të shkruajnë emrin e problemit të përzgjedhur.

Hapi i tretë – burimet e të dhënave dhe mënyrat e komunikimit

Rekomandimet për mbledhjen dhe dokumentimin e të dhënave.

➔ Që të vini deri tek burimi i të dhënave dhe i informatave të cilat mund t'ua japin ato, është e qartë se lypset t'i stërvitni nxënësit si të vënë kontakt me njerëzit që punojnë në institucionet, në të cilat do të shkojnë. Cilindo burim ta shfrytëzojnë, janë të detyruar të kontaktojnë personat që mund t'u japin informata ose t'u mundësojnë të arrijnë deri tek ato. Qoftë t'u adresohen personalisht, me telefon, letër, duhet patjetër të caktojnë takim. Duke shfrytëzuar shkathtësitë e tyre të komunikimit dhe përvojat, mund ta bëni një ushtrim të shkurtër. Le t'i tërheqin kartonët e vegjël të ngjyrosur në dy ngjyra të ndryshme, në të cilat me vizatime përkatëse janë prezantuar mënyrat e komunikimit – kontakti personal, me telefon, letër me ngjyrë (në atë mënyrë do t'i ndani në grupe sipas mënyrave të komunikimit). Do të fitoni gjashtë grupe që do ta kryejnë aktivitetin vijues. Detyra për grupet: Ngjyra e parë – p.sh. e kaltër, do të ketë detyrë që duke shfrytëzuar dijen e vet dhe përvojën në vënien e kontakteve me njerëz tjerë, ta nxit mënyrën e komunikimit të mirë – si do të duhej të bisedohej në kontaktin personal, të shkruhet letra ose të telefonohet. Ngjyra e dytë – p.sh. e kuqe, do të ketë detyrë të simulojë mënyrën e komunikimit të keq – që do të duhej të evitohej në kontaktin personal, me rastin e shkrimit të letrës apo telefonimit.

Për këtë aktivitet jepuni 5 minuta kohë, e pastaj ndonjëri nga grupi le të lexojë si duhet të vihet kontakti me njerëzit dhe si nuk duhet të vihet kontakti me njerëzit.

Vërejtje: Ju thoni nxënësve që me rastin e mbledhjes së të dhënave mbi problemin nuk është e domosdoshme që në tërësi tu përmbahen pyetësorëve të dhënë. Mund të shtojnë edhe ndonjë pyetje të veten e madje edhe të hartojnë pyetësorin e vet. Si burim të informative krahas pyetësorit të plotësuar, nxënësit mund të mbledhin edhe të dhëna tjera të (pjesë të prera nga gazetatat, librat, interneti, broshurat, pllakatet, etiketat, kontratat, vërtetimet...) Qenësore është që për problemin e zgjedhur të mbledhin sa më shumë të dhëna, që pastaj do t'i sistemojnë dhe përzgjedhin më autentikët..

➔ Në klasë mund të keni 1–2 kopje të adresarit afarist në të cilin nxënësit mund të gjejnë emrat, adresat, telefonat ... e personaliteteve, institucioneve, enteve, organizatave të cilat mund të jenë burim i të dhënave.

➔ Të gjitha të dhënat e mbledhura nxënësit duhet t'i ndajnë mes vete. Secili grup duhet të ketë pasqyrë për atë se çfarë të dhëna ka arritur ndonjë grup tjetër. Mos harroni se secili grup në klasën tuaj, nuk duhet të funksionojë si i pavarur, sepse të gjitha grupet e përbëjnë ekipin dhe të gjitha njohuritë që i kanë fituar duhet t'i ndajnë mes vete.

➔ Me rastin e ndarjes në ekipe hulumtuese verifikoni me nxënësit nëse e njohin dikë në institucione apo organizata në të cilat do të shkojnë. Ai nxënës le të jetë në grupin e ngarkuar për mbledhjen e të dhënave nga ai burim – të rriturit janë të gatshëm të bashkëpunojnë me dikë që e njohin.

Hapi i katërt – puna e grupeve studimore

Në këtë pjesë ndonjëherë mund të lindin probleme. Domethënë pas mbledhjes së të dhënave nxënësit ndahen në katër grupe dhe secila e bënë pjesën e vet të prezantimit. Këto pjesë mes veti janë të ndërlidhur dhe varën nga njëri tjetri, dhe mund të ndodhë që grupi i dytë lypset ta presë të parin që ta kryejë pjesën e vet, grupi i tretë të dytin dhe i katërti të tretin. Për t'u evituar që anëtarët e grupeve të tjera të rrinë dhe presin paraardhësit e tyre të përfundojnë, ne ju propozojmë disa nga procedimet vijuese, e ju përzgjidhni atë që ju konvenon më së shumti:

- Pas ndarjes në grupe, mundësojani grupit të tretë ta përcjellë punën e grupit të parë, e grupit të katërt punën e grupit të dytë.
- Mund ta ndani klasën në dy grupe të mëdha. Grupi i parë do të punojë në pjesën e parë dhe të dytë të studimit të klasës, kurse grupi i dytë në dy pjesët tjera.
- Të gjithë punojnë nga pak nga secila pjesë e studimit dhe ashtu janë të njohur me secilën pjesë të saj.
- Edhe një mënyrë që ua prezantojmë gjerësisht është si vijon:

➡ Kur njëherë e keni sajuar listën e problemeve potenciale, dhe atë e keni reduktuar në një problem për punimin e studimit, atëherë diskutojmë bashkë mbi atë problem duke shfrytëzuar udhëzimet për punën e grupit të parë studimor. I shkruajmë përgjigjet tona në tabelë apo letër të madhe. Për momentin akoma nuk punojmë asgjë në pjesën demonstruese të studimit. Pastaj i shfletojmë dy-tri masa alternative. Tani e ndajmë klasën në aq grupe sa ka masa alternative. Grupet i analizojnë masat duke u përgjigjur në pyetjet nga udhëzimi për punën e grupit të dytë studimor. Ende nuk punojmë në pjesën demonstruese. Kur hulumtimi ka përfunduar dhe është shkruar nga një faqe me sqarimet, grupet i marrin rezultatet e tërë klasës. Secila nga masat alternative diskutohet dhe pastaj votohet për atë të cilën e zgjedh klasa për masë të vetën apo, nëse dëshirojnë, të zgjedhin masën e re për studimin. Kur është zgjedhur masa (mundet edhe pakoja e masave) e klasës, skiconi një apo dy faqe të sqarimit dhe të arsytimit të masave për parashtrim (ose mund ta ndani klasën në dy grupe për ta skicuar atë secili për vete, e pastaj bashkohen dhe harmonizohen qëndrimet). Kërkon nga ata të diskutojnë mbi përparësitë dhe mangësitë e masave të cekura dhe mbi kushtetutshmërinë e ligjshmërinë e masës së propozuar. Gjithashtu, duhet të konstatohet se cilat degë dhe nivele të pushtetit duhet të jenë përgjegjëse për përqafimin e masës së propozuar për zgjidhjen e këtij problemi. Më në fund, tërë klasa lypset të diskutojë mbi zbatimin e propozimeve të veta. Nevojitet të gjejnë persona apo grupe me ndikim në bashkësi, të cilat mund të jenë të disponuar për ta mbështetur klasën në qëllimin e vet, dhe ta përshkruajnë si do ta fitojnë mbështetjen e tyre. Gjatë këtij diskutimi një apo dy nxënës mundën të marrin shënime në letër. Pastaj, gjithashtu lypset të diskutojnë për grupet apo individët në bashkësi të cilët mund t'i kundërshtojnë masat e klasës dhe si të përfitohen që megjithatë të ofrojnë mbështetje projektit. Edhe kjo duhet të shënohet në letër. Pas kësaj do të duhej të identifikohen njerëzit me ndikim në pushtet dhe në institucione të rëndësishëm për zgjidhjen e problemit të cilit do t'i jepnin ndihmë klasës dhe atyre që këtë nuk duan ta bëjnë, pra të cilët do ta kundërshtojnë, dhe të diskutohet për këtë si të binden që t'i japin mbështetje klasës. Në këtë diskutim gjithçka duhet të shënohet. Serish mos u kujdeseni për pjesën demonstruese të studimit, por përqendrohuni në faktin që të gjithë nxënësit të mësohen me problemin dhe të kalojnë nëpër katër hapat e këtij procesi, ashtu që të mund të diskutojnë me logjikë për cilin do nga ata.

Tash është koha që klasa të ndahet në katër grupe. Në kuadër të secilit grup ndonjëri nga nxënësit do të ngarkohet për punimin e sqarimit me shkrim të problemit dhe të rezymimit, disa do të kërkojnë ose vizatojnë ilustrime për pjesën demonstruese të studimit, e disa do të ngarkohen për rregullimin e materialit të mbledhur për pjesën dokumentare.

Ideja është e mirë që grupet të takohen periodikisht dhe të raportojnë mbi pjesët për të cilat ata janë të ngarkuar. Kështu të gjithë do të jenë të njohur me punimin komplet të studimit.

↳ Nxënësit mundem mes veti ta zgjedhin ekipin e vogël të ngarkuar për redaktimin e punës dhe përgatitjen e projektit për futje në pjesën dokumentare të studimit të klasës (grupin redaktues). Rezultatet e punës së secilit grup i duhen dhënë grupit redaktues. Gjithë klasa lypset të shqyrtojë projektin të cilin ka hartuar grupi redaktues dhe të jap propozime për përmirësimin e tij. Ekipi redaktues lypset të përfundojë projektin dhe ta shndërrojë në studim, pastaj secili grup studimor punon në punimin e kaptinës së vet të studimit, kurse ekipi redaktues shfaq kujdes që pjesët e studimit të jenë të ndërlidhura.

Këshillat për hapin e pestë

- ↳ Kur studimi është gati, grupi duhet të nisë përgatitjen e prezantimit gojor (në kohëzgjatje prej 4 minutash për secilin grup). Është me rëndësi që grupet këtë ta punojnë bashkë që të mos ndodhë përsëritja dhe që të mbahet vazhdimësia e prezantimit. Grupet do të duhej të ushtrojnë prezantimin përpara klasës për shkak të përmbajtjes dhe respektimit të kohës sipas propozicioneve. Mësimdhënësit mundën të shtrojnë pyetje plotësuese grupeve në mënyrë që tu ndihmojnë nxënësve që të përgatiten për pyetjet e jurisë, të parashikuara me propozicionet e garës në kohëzgjatje prej 6 minutash për secilin grup.
- ↳ Mund t'i lusni prindërit apo anëtarët e tjerë të rritur të bashkësisë, me përvojë në paraqitjet publike, që ta stërvin grupin tuaj. Njerëzit e inkuadruar në vetëqeverisjen lokale apo në shoqatat e qytetarëve mund të jenë një ndihmesë e madhe.
- ↳ Ushtroni gojarisht prezantimin para parashtrimit përpara gjyqtarëve. Le të provojnë përpara shoqeve e shokëve nga klasa.
- ↳ Në prezantimin dhe përgjigjen në pyetje lypset të marrin pjesë sa më shumë anëtarë të secilit grup studimor që është e mundshme. Me prezantimin gojor nuk duhet të dominojnë një apo dy nxënës. Ai lypset të tregojë bashkëpunimin në punë i cili ka ekzistuar gjatë përgatitjes së studimit.
- ↳ Iu thoni që materialet demonstruese të mos i lexojnë përpara anëtarëve të jurisë. Le t'i përzgjedhin të dhënat e pohimet më të rëndësishme dhe t'i prezantojnë ato në bisedë relaksuese. Gjatë pjesës hyrëse të parashtrimit mund t'i shfrytëzojnë shënimet, por jo edhe gjatë përgjigjeve në pyetje.
- ↳ Nëse nuk i shfrytëzoni katër minutat tuaj për parashtrim, koha e pashfrytëzuar do t'i shtohet kohës për pyetje e përgjigje. Secili grup studimor ka gjithsej dhjetë minuta përpara jurisë.

Projektet dhe mësimi me anë të projekteve

Objektivat e projektit janë që të inicojnë ndryshime, të promovojnë risi. Karakteristikat kryesore të projektit janë:

- Kanë objektiva të përkufizuara qartë dhe japin rezultate qartë të përkufizuara. Qëllimi i tyre është që të zgjidhin problemin e caktuar.
- Projektet duhet të përmbajnë plan të qartë të ndryshimeve që dëshirojnë t'i arrijnë. Në bazën e secilit projekt ekziston vizioni, kurse projekti lypset të prodhojë disa ndryshime të matura të cilat duhet të zgjasin edhe pasi të përfundojë projekti.
- Objektivat e tyre lypset të jenë të realizueshme, që kërkojnë shqyrtimin edhe të mjeteve financiare dhe infrastrukurore që janë në dispozicion.
- Ata kanë fillimin e mbarimin dhe zbatohen në një vend të caktuar dhe kontekst të caktuar. Përbëhen nga fazat të cilat mund të ndahen dhe të identifikohen qartë.
- Kërkojnë shkathtësi të ndryshme të planifikimit e zbatimit dhe nënkuptojnë përpjekje kolektive, punë ekipore, bashkëpunëtor të ndryshëm.
- Rezultojnë nga ndonjë ide e re, koncept i ri i zgjidhjes së problemit të vjetër.
- Secili projekt është edhe aventurë e llojit të vet – vazhdimisht ekziston pasiguria dhe rreziku i caktuar.
- Duhet të jenë të planifikuar me kujdes dhe të arsyetuar në tërësi matëse, të nënshtruar vlerësimit përfundimtar të suksesit.

Projektet gati gjithmonë i përfshijnë ekipet, ashtu që promovimi i punës së mirë ekipore është me rëndësi të madhe për suksesin. Raportet e mira, konstruktive e të pjekura, kontribuojnë në suksesin e projektit. Është treguar se stili më i suksesshëm i menaxhimit në ekipin e projektit, lypset të mbështetet në qasjen e përgjithshme demokratike, e cila nënkupton:

- **Barazinë** – në kuptimin e posedimit dhe zotërimit të drejtave dhe detyrimeve. Të drejtat dhe detyrat dalin nga roli i ekipit, kurse përgjegjësia brenda ekipit është personale.
- **Respektimin** –secili anëtar i ekipit e ndërton autoritetin në bazë të aftësive dhe dijeve të veta, ndërsa udhëheqësi krijon kushte që secili të mund të manifestojë dhe zhvillojë cilësitë e veta, si bazë e respektimit reciprok.
- **Autenticitetin** – krijimi i bazës për qasje individuale dhe manifestimi i secilit individ në harmoni me veçoritë dhe aftësitë e tija autentike.
- **Procedurën demokratike** – rregullat e sjelljes brenda ekipit janë publike, të sakta, logjikshme dhe të vlefshme për të gjithë.
- **Plotësimin** – dallimi midis anëtarëve është bazë e begatisë së lloj-llojshmërive, e jo e pabarazisë. Kjo mundëson plotësim mes-veti sipas profilit profesional, aftësive, vetive, kompetencave...
- **Fleksibilitetin** – nënkupton ndjeshmëri, lloj-llojshmëri dhe përshtatje si në qasjen ndaj njerëzve, ashtu edhe në reagimet ndaj situatave dhe problemeve.

Përmbajtja, forma dhe stili i promovimit të projektit varet nga fakti se kujt i janë destinuar, dhe cili a është qëllimi i promovimit të projektit – informimi, edukimi apo popullarizimi. Projekti mund të promovohet në mënyra të ndryshme:

- artikuj profesional;
- publikime;
- prezantime publike;
- raporte;

- seminare;
- mjetet e informimit publik ...

Mësimi me anë të projektit paraqet njëri nga metodat e mësimimit ku mësimdhënësi dhe nxënësit kanë rolet e veta specifike.

Mësimdhënësi është moderator i cili përcjellë, këshillon, inicon, ofron ndihmë, organizon dhe bashkërendon punën e nxënësve.

Nxënësit i shtrojnë objektivat, bashkëpunojnë, planifikojnë, organizojnë, diskutojnë, negociojnë, mbledhin të dhëna e materiale, shtrojnë pyetje, hulumtojnë, aplikojnë, eksperimentojnë, provojnë, ndryshojnë, konstruktojnë, modelojnë, prodhojnë, pyesin, gjykojnë.

Disa nga karakteristikat e mësimimit me anë të projekteve janë:

- ekziston interesi i përbashkët, objektivi i paraleles e përcakton zgjedhja e përmbajtjes dhe shtruarja e detyrave;
- pikënisje është problemi i njëmendët jetik;
- është i orientuar në epilog;
- futja e përvojave vetjake të nxënësve, orientimi i mësimimit të drejtë të praktikës jetësore;
- qëndrueshmëria me zhvillim tipik nëpër faza (iniciativa, vërtetimi i nevojave, shtrimi i objektivit, caktimi i kufirit për punë në projekt, skica e projektit, planifikimi, zbatimi, vështrimi dhe parashikimi, menaxhimi i aktiviteteve dhe optimizmi i tyre, notimi);
- procedimi mbështetet në ndarjen e punës, punën ekipore;
- futja e shenjave jashtëshkollore (prindërve dhe ekspertëve);
- mësim i pavarur, zbulues, me përvojë, praktikë, shoqëror;
- mësimi është i orientuar në aktivitete.

Përcjellja dhe notimi

Notimi i nxënësve është një nga komponentët e procesit mësimor e arsimor.

Notimit të nxënësve lypset të qaset si pjesë përbërëse të procesit mësimor, e kjo do të thotë se ai duhet të paraqitet në të gjitha fazat e mësimin, por se duhet të jetë i planifikuar e përgatitur seriozisht dhe me temel, i realizuar me kujdes, por edhe i nënshtruar vlerësimit dhe ndryshimit. Nëse dëshirojmë ta zhvillojmë mësimin dhe arsimimin, si procese të cilët lypset të çojnë drejt zhvillimit dhe përparimit të nxënësve, atëherë notimin mund ta shikojmë si proces të përcjelljes së punës dhe zhvillimit të nxënësve ku mund dhe duhet të shfrytëzohen metodat dhe teknikat e ndryshme. Disa nga ato ua kemi ofruar në fund të këtij teksti – mund ti shfrytëzoni të dhëna ashtu ose t’ua adaptoni nevojave tuaja.

Që ta përcjellim më lehtë përparimin e nxënësve, nevojitet të dimë cilët janë objektivat e programit dhe çfarë epilogu presim me përfundimin e procesit të mësimin.

Objektivi i përgjithshëm i lëndës Edukata qytetare VI, është aftësimi i nxënësve për pjesëmarrje aktive në jetën e bashkësisë lokale, përhapja e njohurive mbi demokracinë, principet dhe vlerat e saj.

Përmbajtjet programore do t’ia mundësojnë nxënësit lirinë e shprehjes së mendimeve, të nevojave, zhvillimin e shkathtësive komunikuese folëse, zhvillimin e mendimit kritik. Programi u siguron nxënësve të mësojnë të bëhen anëtarë aktivë e të përgjegjshëm të bashkësisë në të cilën jetojnë.

Nocionet kryesore të kësaj lënde, nxënësit do t’i përvetësojnë me anë të aksionit praktik dhe përvojave personale.

Objektivat	Epilogët
<p>Zhvillimi i gjykimit kritik dhe shkathtësia e argumentimit të qëndrimeve</p>	<p>Nxënësi do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - paraqesë qartë dhe direkt qëndrimet dhe mendimet e veta mbi çështjet e ndryshme nga jeta e bashkësisë - do të gjykojë aktivisht dhe me me argumente idetë e veta dhe të huaja, propozimet dhe zgjidhjet - do të mundet të arsyetojë dhe prezantojë me argumente propozimet e aksioneve për përmirësimin e jetës së përbashkët në bashkësinë lokale - do të mundet t’i rishikojë qëndrimet dhe mendimet e qytetarëve e të marrësve të vendimeve mbi problemet e bashkësisë lokale
<p>Njohjen e procedurës së vendimmarrjes dhe të institucioneve që janë me rëndësi për zgjidhjen e problemeve dhe avancimin e jetës në bashkësinë lokale</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të njihen mundësitë e ndikimit aktiv të qytetarëve në organe të ndryshme të pushtetit - të dijë me kë dhe si duhet të komunikojë lidhur me aksionet dhe zgjidhjet e propozuara për zgjidhjen e problemeve në bashkësinë lokale - të vërejë lidhshmërinë midis llojeve të problemeve në bashkësi dhe institucioneve kompetente për vendime mbi këtë problem - të kuptojë rëndësinë e respektimit të procedurave me të cilat rregullohet jeta në bashkësi

<p>Zhvillimi i shkathtësive komunikuese të domosdoshme për sjellje prej bashkëpunëtori dhe stërvitje në teknikat e punës grupore e ekipore</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të dihet dhe të aplikohen rregullat e komunikimit dhe të bashkëpunimit në punën grupore dhe ekipore - të shprehet me vetësiguri mendimi vetjak - të përqafohet ekzistimi i mendimit tjetër nga i veti - të njihen arsyet për konfliktin e mendimit në grupe dhe trysnia grupore - të dëgjohen aktivisht qëndrimet dhe mendimet e mësimdhënësve dhe të nxënësve tjerë nga grupi - të merret pjesë në këmbimin e argumentuar të mendimit me nxënësit e tjerë - të jepen propozime dhe të përqafohen propozimet e të tjerëve - të vlerësohen me kritikë propozimet e moshatarëve të vet - të aplikohen mënyrat e marrjes konstruktive të vendimeve në grup
<p>Vendimmarrje me përgjegjësi dhe pjesëmarrja aktive në jetën e bashkësisë lokale</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të shtrohen pyetje dhe të kërkohen aktivisht përgjigjet në pyetjet dhe problemet që i ka vërejtur në bashkësinë lokale - të kuptohen ndikimet pozitive të aktivitetit qytetar në mjedisin lokal - të merret pjesë në diskutim dhe qartë të shprehen propozimet lidhur me përmirësimin e jetës në bashkësinë lokale - të merren aksione përgjegjëse në bashkëpunim me nxënësit nga paralelet - të merret pjesë në miratimin e rregullave të sjelljes në aksionet e dakorduara bashkë - të merret pjesë në realizimin e aksioneve të dakorduara - të kuptohet nocioni “participimi qytetar” - të merret pjesë në jetën e bashkësisë lokale në përputhje me moshën e vet

Vetëvlerësimi i shkathhtësisë së diskutimit


Tema e diskutimit është.....

Kanë ndodhur në orë.....

E kam punuar mirë.....

Shkathhtësitë

Zgjidhe personin që i përshkruan të arriturat në secilën nga shkathhtësitë

 jo bash mirë

 shkëlqyeshëm

Planifikimi çfarë të thotë



Parashtrimi përpara të tjerëve



Parashtrimi pa leximin e shënimeve



Shtuarja e pyetjeve të tjerëve



Përcjellja e asaj që flasin të tjerët



Përgjigja në pyetjet e të tjerëve



Rezymeja në fund

Në cilat fusha duhet të punosh që t'i zhvillosh shkathhtësitë t'ua të diskutimit?

Fushat të cilat duhen përmirësuar.....

Çfarë do të orvaten të bëjnë.....

.....

.....

.....

.....

Lista për notimin e nxënësve

Emri dhe mbiemri i nxënësit.....

1=tepër mbi mesatare; 2=mbi mesatare; 3=mesatare; 4=nën mesatare; 5=tepër nën mesatare

Tregon dijen faktike të ndërlidhur për temën	1	2	3	4	5
Tregon kuptimin e ideve dhe pyetjeve kyçe	1	2	3	4	5
Vështron me kritikë përvojat e veta e të huajat	1	2	3	4	5
Mund të shprehë dhe arsyetojë mendimin e vet	1	2	3	4	5
Reagon si duhet ndaj mendimit të tjerëve	1	2	3	4	5
I kontribuon adekuat diskutimit në paralele	1	2	3	4	5
I kontribuon adekuat diskutimit në grupin e vogël	1	2	3	4	5
Tregon interesim për çështjet shoqërore, morale e politike	1	2	3	4	5
Bashkëpunon me tjerët	1	2	3	4	5
Inkuadrohet në aktivitetet e bashkësisë	1	2	3	4	5

Dikush, a e ka...?	Emrat:
Thyer akullin, hedhur topin, aktivizuar njerëzit ...	
ndihmuar grupin ta bëjë doemos atë që duhet bërë	
shtruar pyetje të dobishme, ka verifikuar çfarë është vërtetë detyra	
rezymuar ose shënjuar çka është detyra kryesore	
verifikuar nëse tjerët e kuptojnë çka po ndodh	
ndihmuar që grupi të arrijë vizionin e përbashkët të produktit të gatshëm	
ndihmuar që grupi të pajtohet me atë çfarë vërtetë do ta bënte të mirë/cilësor produktin	
rikujtuar grupin në kufizimin kohor apo ndonjë tjetër	
lexuar me zë informatat, ka siguruar të dhënat mbi detyrën	
propozuar se si duhet të punojë grupi	
propozuar si të përfundojë detyra	
propozuar si të merren vendimet	
ndihmuar që grupi ta vërejë problemin e mundshëm	
propozuar zgjidhje të mundshme	
shtuar diç, ose e ka përmirësuar propozimin e dikujt	
propozuar planin që gjërat të punohen me renditje të mirëfilltë	
ndihmuar të gjithëve të vendosin kush çfarë do të punojë	
shënuar planet grupore apo vendimet	
komentuar shkathtësitë e dikujt, ka inkurajuar e inkurajon dhe mbështetur	
anëtarët e tjerë të ekipit	

Botues

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Republikës së Serbisë

Për botuesin

Dr Zharko Obradović, ministër

Titulli i botimit

Edukata qytetare për klasën e gjashtë të shkollës fillore
Doracak për mësimdhënës

Tekstin e doracakut e kanë adaptuar

Iniciativat qytetare

Titulli i origjinalit

We the people...Project Citizen
Copyright 1996 Center for civic Education
Project Citizen for Civic Education, Calabasas, CA
Project Citizen, National Conference of State Legislatures, Denver, CO

Doracakun e kanë plotësuar

Tatjana Axhiq
Vesna Vujićiq
Aleksandra Danilloviq
Evgenija Jokanović
Lidija Mishkeljin
Olivera Neshiq
Mirjana Trkulja
Natasha Gjurićiq

Përktheu në gjuhën shqipe

Fahri Musliu

Lektura

Alma Lama

ISBN978-86-7408-049-8